# LIGJ Nr. 110/2016 Date 27.10.2016
# PËR FALIMENTIMIN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

V E N D O S I:

## PJESA E PARË
## PARIMET E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

## KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta për të lehtësuar zgjidhjen dhe shlyerjen kolektive të detyrimeve të debitorit në një procedurë falimentimi.

### Neni 2
### Qëllimi i procedurës së falimentimit

Procedura e falimentimit synon të shlyejë në mënyrë kolektive detyrimet e debitorit përmes riorganizimit të aktivitetit ose përmes likuidimit të të gjitha pasurive të debitorit dhe shpërndarjes të të ardhurave.

### Neni 3
### Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Administrator” i referohet: administratorit të përkohshëm, administratorit të mbikëqyrjes dhe administratorit të falimentimit.
2. “Administrator falimentimi” është administratori i caktuar nga gjykata e falimentimit në vendimin për fillimin e procedurës së falimentimit ose pas hapjes së saj kur zëvendëson debitorin në administrimin dhe drejtimin e veprimtarisë.
3. “Administrator i përkohshëm” është administratori, i cili caktohet nga gjykata e falimentimit para fillimit të procedurës së falimentimit dhe kryen funksionin e mbikëqyrjes ose të administratorit të falimentimit, sipas nenit 23 të këtij ligji.

4. “Administrator mbikëqyrës” është administratori i caktuar nga gjykata e falimentimit me vendimin e fillimit të procedurës së falimentimit ose më pas për mbikëqyrjen e debitorit dhe sipas parashikimeve të këtij ligji për autorizimin e akteve të administrimit dhe detyra të tjera.

5. “Agjencia Kombëtare e Falimentimit” është autoriteti shtetëror kompetent për mbikëqyrjen, trajnimin dhe licencimin e veprimtarisë së administratorëve, si dhe për çdo detyrë tjetër të parashikuar sipas këtij ligji.

6. “Debitor” është personi fizik ose juridik, i cili paraqet ose ndaj të cilit paraqitet kërkesa e fillimit të procedurës së falimentimit.

7. “Ditë” i referohet ditëve të punës, me përjashtim kur caktohet ndryshe në këtë ligj.

8. “Ekspert” është një profesionist i kualifikuar me njohuri të posaçme, të provuara në një fushë të caktuar, i pavarur nga palët dhe i regjistruar si i tillë në regjistrin e ekspertëve të mbajtur nga gjykata e falimentimit. Në rastet kur fusha e ekspertizës nuk mbulohet nga regjistri i ekspertëve të mbajtur nga gjykata e falimentimit, “Ekspert” do të kuptohet profesionisti i kualifikuar, me njohuri të posaçme të provuara në një fushë të caktuar, që paraqitet në një procedurë gjyqësore për të dhënë opinionin e tij të pavarur në atë fushë specializimi. Gjykata duhet të preferojë administratorët e falimentimit në funksionin e ekspertit.

9. “Gjykatë e falimentimit” është gjyqtari i vetëm i seksionit tregtar në gjykatën e rrethit gjyqësor, i ngarkuar me procedurat e falimentimit.

10. “Gjykatë e huaj” është autoriteti kompetent që kontrollon ose mbikëqyr një procedurë të huaj.

11. “Kreditor i falimentimit” është kreditori, pretendimi i të cilit ka lindur përpara fillimit të procedurës së falimentimit.

12. “Kreditor i procedurës së falimentimit” është kreditori, pretendimet e të cilit kanë lindur pas fillimit të procedurës së falimentimit, i cili shlyhet nga masa e falimentimit, sipas mënyrës dhe kufizimeve të përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji.

13. “Kreditor i siguruar” është kreditori me të drejta të vlefshme mbi pasuritë e siguruara, me peng, hipotekë ose ndonjë formë tjetër sigurimi të njohur nga Kodi Civil ose ligje të tjera të veçanta mbi pasurinë e debitorit.

14. “Kreditor me të drejtë përjashtuese” është pronari i një pasurie në posedim të debitorit, i cili ka të drejtë ligjore ta ndajë këtë pasuri nga masa e falimentimit, për shkak të kësaj të drejte pronësie.

15. “Kreditorë të pasiguruar” janë personat fizikë ose juridikë, që kanë pretendime falimentimi, të cilat nuk mund të klasifikohen si të siguruara, të preferueruara ose fundore.

16. “Kujdestar” është personi fizik i emëruar nga gjykata e falimentimit, me kërkesë të debitorit, person fizik, për të mbikëqyrur përmbushjen e një detyrimi, zbatimin e një kontrate,ekzekutimin ndaj pasurisë së debitorit dhe detyra të tjera të caktuara rast pas rasti me ligj ose me vendim të gjykatës së falimentimit.

17. “Kreditorë fundorë” janë kreditorët që kanë pretendime të parashikuara në nenin 40 të këtij ligji.

18. “Kreditorë të preferuar” janë kreditorët që kanë pretendime të parashikuara në nenin 38 të këtij ligji.

19. “Masa të përkohshme” janë masa parandaluese të miratuara nga gjykata e falimentimit për të shmangur përkeqësimin e masës së falimentimit, sipas kushteve të parashikuara në nenin 22 të këtij ligji.

20. “Masë e falimentimit” është tërësia e pasurive dhe të drejtave të debitorit në datën e fillimit të procedurës së falimentimit, si dhe pasurive dhe të drejtave të fituara gjatë kësaj procedure, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose jashtë tij, përveç pasurive që janë të përjashtuara nga ekzekutimi i detyrueshëm, siç parashikohet në Kodin e Procedurës Civile.

21. “Paaftësi paguese” është gjendja kur një debitor, pavarësisht nëse është person fizik ose juridik, nuk është në gjendje të paguajë borxhet e tij brenda afatit. Në rastin e një personi juridik, paaftësia paguese është gjithashtu situata financiare, në të cilën tërësia e detyrimeve të debitorit tejkalon vlerën totale të pasurive të tij.

22. “Palë pjesëmarrëse” është çdo person fizik ose juridik që bëhet pjesë e procedurës së falimentimit si debitor, kreditor, administrator ose ndonjë palë tjetër, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

23. “Person i lidhur me debitorin” nënkupton:

a) Kur debitori është person fizik:

i) bashkëshortin/en ose bashkëjetuesin/en e debitorit edhe nëse martesa ose bashkëjetesa ndodh pas veprimit juridik ose është zgjidhur apo anuluar gjatë vitit paraardhës kur kanë ndodhur veprimet përkatëse;

ii) paraardhësit ose pasardhësit e debitorit ose të bashkëshortit/es/bashkëjetuesit/es, vëllezërit, motrat dhe të afërmit e tjerë të debitorit deri në shkallën e dytë me lidhje gjaku dhe bashkëshortët/bashkëjetuesit e këtyre personave;

iii) bashkëshortët ose bashkëjetuesit e secilit prej personave të përmendur në nënparagrafin "ii", të shkronjës "a" të kësaj pike, edhe në qoftë se martesa ose bashkëjetesa ndodh pas veprimit juridik ose zgjidhet ose ndërpritet gjatë vitit paraardhës kur ka ndodhur veprimi juridik përkatës;

iv) persona të cilët, për shkak të ndonjë marrëdhënieje me debitorin, janë në dijeni të informacionit konfidencial mbi gjendjen financiare të debitorit.

b) Kur debitori është person juridik:

i) çdo subjekt juridik i kontrolluar nga debitori, sipas legjislacionit përkatës për shoqëritë tregtare;

ii) çdo subjekt juridik i të njëjtit grup shoqërish me debitorin;

iii) drejtori i përgjithshëm, administratori ose secili nga anëtarët e bordit drejtues ose bordit mbikëqyrës të debitorit;

iv) çdo person që zotëron më shumë se një të katërtën e kapitalit të debitorit;

v) çdo anëtar i debitorit me përgjegjësi të pakufizuar për detyrimet e debitorit;

vi) çdo person që ka dijeni për informacion konfidencial ose të dhëna për gjendjen financiare të debitorit, për shkak të pozitës së veçantë me debitorin.

24."Përfaqësues i huaj" është një person ose institucion, përfshirë edhe një të përkohshëm, i autorizuar nga një procedurë e huaj për të administruar riorganizimin ose likuidimin e pasurive a të veprimtarive të debitorit ose për të vepruar si përfaqësues në një procedurë të huaj.

25. "Pretendimi i kushtëzuar" është pretendimi, i cili është objekt i një kushti pezullues ose ndonjë lloji tjetër kufizimi që i pengon kreditorët për të gëzuar një status të plotë si kreditor falimentimi, për aq kohë sa ekziston kushti ose kufizimi.

26. "Procedurë dytësore e huaj" është një procedurë e huaj, e ndryshme nga procedura kryesore e huaj, që zhvillohet në një shtet të huaj, ku debitori ka një vendndodhje.

27. "Procedurë e huaj" është një procedurë kolektive, juridike ose administrative, në një shtet të huaj, duke përfshirë një procedurë të përkohshme, në bazë të një ligji falimentimi, në të cilin procedurat për pasuritë dhe veprimtaritë e debitorit për sa i përket riorganizimit ose likuidimit janë objekt kontrolli ose mbikëqyrjeje nga një gjykatë e huaj.

28. "Procedurë kryesore e huaj" është një procedurë e huaj që zhvillohet në një shtet të huaj, ku debitori ka qendrën kryesore të interesit.

29. "Qendër kryesore e interesit" është vendi ku debitori kryen administrimin e interesave të tij në mënyrë të rregullt dhe njihet si e tillë nga palët e treta. Në rastin e një tregtari, një shoqërie tregtare ose ndonjë subjekti tjetër juridik, vendi ku debitori është i regjistruar ose ka selinë e tij do të prezumohet të jetë qendra kryesore e interesit, përveçse kur provohet ndryshe.

30. "Shkarkimi i detyrimeve të pashlyera" është shuarja, me vendim të gjykatës së falimentimit, e detyrimeve të një debitori, person fizik, në kushtet e përcaktuara në pjesën VII të këtij ligji.

31. "Vendbanim" është vendi i regjistruar si i tillë nga personi fizik në zyrën përkatëse të gjendjes civile, në zbatim të legjislacionit për gjendjen civile.

32. "Vendndodhje" është çdo vend ku debitori kryen një veprimtari ekonomike me natyrë jo të përkohshme me burime njerëzore dhe mallra ose shërbime.

**Neni 4**
**Parimi i legjislacionit të zbatueshëm**

1. Procedura e falimentimit rregullohet nga ky ligj.

2. Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe të ligjeve të tjera zbatohen vetëm për çështje që nuk janë parashikuar në këtë ligj, për aq ato sa nuk bien në kundërshtim me të.

**Neni 5**
**Parimi i efiçencës**

1. Procedura e falimentimit duhet të ndjekë një proces të rregullt, brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme.

2. Procedura e falimentimit nuk pezullohet ose ndërpritet, përveçse kur është parashikuar shprehimisht ndryshe në këtë ligj.

3. Vendimet dhe urdhrat e gjykatës së falimentimit janë menjëherë të zbatueshëm, përveçse kur është parashikuar shprehimisht ndryshe në këtë ligj.

**Neni 6**
**Parimi i transparencës dhe informimit**

1. Procedura e falimentimit është publike, brenda kufijve të përcaktuar nga ky ligj.

2. Palët pjesëmarrëse në procesin e falimentimit kanë të drejtë të informohen mbi procedurën, sipas mënyrës së përcaktuar në këtë ligj.

**Neni 7**
**Debitori në procedurën e falimentimit**

1. Procedura e falimentimit mund të fillojë ndaj çdo debitori si person fizik ose juridik.

2. Procedura e falimentimit mund të fillojë edhe pas prishjes së personit juridik që ende nuk është likuiduar.

3. Procedura e falimentimit nuk mund të fillojë ndaj subjekteve publike, objekt i së drejtës administrative. Shoqëritë me kapital publik ose shtetëror, të organizuara si person juridik privat, janë objekt i këtij ligji.

4. Ligji nuk zbatohet për shoqëritë e sigurimit, bankat, fondet e pensioneve, fondet e investimeve të letrave me vlerë dhe institucione të tjera që grumbullojnë depozita nga publiku ose institucione të tjera financiare, për të cilat procedura e falimentimit rregullohet në një ligj të posaçëm. Ky ligj zbatohet për institucionet jobankare, sipas parashikimeve të legjislacionit për bankat në Republikën e Shqipërisë.

5. Në rast të paaftësisë paguese të një subjekti që ushtron veprimtarinë e tij në një sektor strategjik të përcaktuar me ligj të posaçëm, si dhe të një subjekti që kryen një shërbim publik, zbatohet ky ligj nëse nuk rregullohet me një ligj të posaçëm, ose kur rregullohet me një të tillë, por subjektit i është hequr licenca.

**Neni 8**
**E drejta e aksesit në informim**

1. Pas kërkesës me shkrim të paraqitur nga një palë pjesëmarrëse në procedurën e falimentimit, debitori, nëse mban të drejtën e administrimit gjatë procedurës së falimentimit, ose administratori duhet t'i sigurojë palës dokumentacionin e falimentimit brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të kërkesës.

2. Dhënia e një informacioni të kërkuar, sipas pikës 1, të këtij neni, mund të refuzohet me anë të një vendimi të arsyetuar, kur konstatohet se informacioni përmban të dhëna tregtare konfidenciale të debitorit dhe e vendos atë ose pasuritë e tij në një rrezik të lartë ose në raste të tjera të përcaktuara me ligj.

3. Pala pjesëmarrëse mund të paraqesë një ankim në gjykatën e falimentimit kundër vendimit për refuzimin e dhënë, sipas pikës 2 të këtij neni. Gjykata e falimentimit i cakton një afat 5-ditor debitorit ose administratorit për t'u shprehur në lidhje me këtë ankim. Gjykata e falimentimit jep vendim brenda 5 ditëve pas përgjigjes së debitorit ose administratorit.

**Neni 9**
**Juridiksioni i gjykatës së falimentimit**

1. Procedura e falimentimit administrohet nga gjykata e falimentimit. Gjykata e falimentimit disponon me vendime dhe urdhra.

2. Gjykata e falimentimit mund të hetojë me iniciativën e vet të gjitha aspektet e procedurës së falimentimit.

3. Gjykata e falimentimit është kompetente për gjykimin e të gjitha çështjeve që lidhen me procedurën e falimentimit dhe që ndikojnë në masën e falimentimit, duke përfshirë edhe:

a) çdo padi të administratorit në lidhje me pavlefshmërinë e veprimeve juridike të debitorit;

b) çdo padi në lidhje me përgjegjësinë e administrimit të debitorit;

c) çdo padi në lidhje me njohjen dhe/ose kundërshtimin e kërkesave të kreditorit;

ç) rastet që gjykata e falimentimit vepron sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 69, dhe pikës 3, të nenit 78, të këtij ligji.

4. Gjykata e falimentimit nuk është kompetente për të gjykuar për vazhdimin e rasteve, në të cilat debitori është në rolin e paditësit kundër palëve të treta.

5. Gjykata e falimentimit gjykon mbi prova shkresore në dhomë këshillimi. Përjashtimisht, ajo gjykon në seancë dëgjimore vetëm kur është e nevojshme që të merren prova të reja, përveç atyre shkresore të depozituara.

6. Kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit mbi kërkesën e kreditorit dhe paditë për kundërshtimin e veprimeve gjykohen në seancë dëgjimore.

**Neni 10**
**Juridiksioni i gjykatës së apelit**

1. Vendimet e gjykatës së falimentimit janë objekt ankimi vetëm në rastet e përcaktuara shprehimisht në këtë ligj. Çdo ankim nuk pezullon zbatimin e vendimeve ose urdhrave, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

2. Vendimet e gjykatës së falimentimit mund të ankimohen brenda 15 ditëve në gjykatën e apelit, me përjashtim të rasteve të ankimit të veçantë. Afati për ankimet e veçanta, sipas këtij ligji, është 5 ditë.

3. Afati i ankimit fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

4. gjykata e apelit shqyrton çështjen në dhomën e këshillimit brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit.

5. Nëse duhet të vërtetohen fakte të reja dhe/ose janë paraqitur prova të reja, si dhe në rastet e parashikuara në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç", të pikës 3, të nenit 9, të këtij ligji, gjykata e apelit mund të vendosë duke thirrur palët në seancë gjyqësore dëgjimore.

**Neni 11**
**Kompetenca territoriale**

1. Procedura e falimentimit shqyrtohet dhe administrohet në gjykatën e falimentimit, ku debitori ka qendrën kryesore të interesit, vendbanimin ose vendqëndrimin kur është person fizik. Gjykata e falimentimit shqyrton me iniciativën e vet nëse ka juridiksion.

2. Në qoftë se një procedurë falimentimi është deklaruar nën kompetencën territoriale të disa gjykatave të falimentimit, kompetencë të drejtpërdrejtë për shqyrtimin dhe administrimin e çështjes ka gjykata e falimentimit ku është paraqitur për herë të parë kërkesa për fillimin e procedurës së falimentimit.

3. Nëse janë paraqitur disa kërkesa për fillimin e procedurës së falimentimit në lidhje me të njëjtin debitor, këto kërkesa do të bashkohen me kërkesën që është paraqitur e para.

**Neni 12**
**Njoftimet dhe shpalljet**

1. Njoftimet e vendimeve të gjykatës së falimentimit për fillimin e procedurës së falimentimit bëhen nga kjo gjykatë me shërbimin postar të shpejtë ose me mjete të komunikimit elektronik, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

2. Përveç mënyrës së mësipërme të njoftimit, kur ky ligj ose gjykata e falimentimit kërkon një shpallje publike, kjo do të bëhet në Qendrën Kombëtare të Biznesit në mënyrën dhe në vendet e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, nëse nuk përcaktohet në këtë ligj. Këto shpallje publike do të konsiderohen njoftim për të gjitha palët që marrin pjesë në procedurën e falimentimit, përveçse kur ky ligj parashikon ndryshe.

3. Gjykata e falimentimit mund të kërkojë nga administratori që të kryejë të gjitha njoftimet dhe shpalljet e nevojshme, duke përfshirë, nëse është rasti, bërjen e tyre edhe në faqen zyrtare të internetit të debitorit.

4. Sekretaria e gjykatës njofton Agjencinë Kombëtare të Falimentimit për çdo kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit, jo më vonë se 5 ditë nga data e paraqitjes së një kërkese të tillë.

5. Sekretaria e gjykatës dërgon për publikim në Qendrën Kombëtare të Biznesit çdo vendim për fillimin, pezullimin dhe përfundimin e procedurës së falimentimit, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

6. Njoftimet dhe shpalljet përmbajnë informacion për debitorin dhe, në veçanti, adresën e vendbanimit ose vendin ku debitori ka qendrën kryesore të interesit, si dhe vendin ku ai ushtron veprimtarinë.

7. Gjykata e falimentimit mund të urdhërojë publikime të tjera të tilla, nëse e sheh të arsyeshme.

PJESA E DYTË

FILLIMI I PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT,
PALËT PJESËMARRËSE DHE MASA E FALIMENTIMIT

KREU I
FILLIMI I PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

**Neni 13**
**Kërkesa për fillimin e procedurës së falimentimit**

Fillimi i procedurës të falimentimit mund të kërkohet nga debitori ose kreditorët në formë të shkruar dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

**Neni 14**
**Kërkesa e debitorit**

1. Kërkesa e debitorit për hapjen e procedurës së falimentimit mbështetet në paaftësinë paguese ekzistuese të debitorit ose në paaftësinë paguese në një të ardhme të afërt. Së bashku me kërkesën, debitori paraqet edhe dokumentacionin dhe informacionin në vijim:

a) raportin e debitorit, ku përcaktohen shkaqet e paaftësisë paguese dhe analiza e tij për të ardhmen e biznesit;

b) ekstraktin historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për debitorin;

c) bilancin dhe pasqyrat financiare për tri vitet e fundit të aktivitetit të debitorit. Nëse debitori ka ushtruar veprimtari për një periudhë më të shkurtër kohe, për aq sa kjo periudhë është;

ç) listën e pronave të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë:

i) vlerën e çdo pasurie në momentin e blerjes;

ii) vlerën aktuale të tregut në rast se këto pasuri kanë qenë objekt i rivlerësimit;

iii) vendndodhjen e pasurive; dhe/ose

iv) të dhënat e regjistruara në regjistrat publikë nëse këto pasuri janë objekt i ndonjë procedure ligjore; dhe

v) nëse ndonjë nga këto pasuri është vendosur si garanci, ose është objekt i ndonjë barre dhe, nëse po, vlera e kredisë së siguruar;

d) listë të bilanceve aktuale të parave në gjendje dhe burimet e të ardhurave;

dh) listë të kreditorëve, të cilët janë persona fizikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, vlerën dhe burimin e detyrimeve;

e) listë të kreditorëve që janë persona juridikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, selitë, emrat e përfaqësuesve të tyre ligjorë, nëse është rasti, si dhe vlerat dhe burimin e detyrimeve;

ë) listë të debitorëve të debitorit, qoftë këta persona fizikë ose juridikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, selitë, vlerat dhe burimin e kredisë;

f) listë të të gjitha procedurave ligjore ku debitori është palë, si paditës ose i paditur.

2. Dokumentet, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të jenë origjinale, të nënshkruara dhe/ose të vulosura në çdo faqe dhe të shoqëruara nga një deklaratë, ku shprehet se përmbajtja e dokumenteve shoqëruese është e plotë dhe e saktë. Nëse ka arsye të bazuara se përmbajtja e dokumenteve nuk është e plotë ose e saktë, duhet të përcaktohet shprehimisht në tekstin e deklaratës.

3. Në rastin e një shoqërie të thjeshtë, ku anëtarët nuk janë individë, kërkesat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, do të zbatohen për anëtarët e organeve drejtuese të saj.

**Neni 15**
**Detyrimi për të paraqitur kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit**

1. Debitori ka për detyrë të paraqesë kërkesë për fillimin e procedurave të falimentimit, brenda 60 ditëve nga data në të cilën debitori dinte ose duhet të dinte që është bërë i paaftë të paguajë. Në rastin e subjekteve juridike, ky detyrim i takon çdo anëtari të organit drejtues. Nëse këta përfaqësues nuk paraqesin kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit, do të jenë përgjegjës personalisht për të kompensuar kreditorët për dëmet e pësuara për këtë shkak. Gjykata e falimentimit mund të vendosë edhe sanksion ndaj debitorit ose çdo anëtari të organit drejtues që nuk plotëson detyrimin, sipas këtij neni, duke i përjashtuar ata nga e drejta e ushtrimit të çdo veprimtarie për një periudhë nga 1 deri në 5 vjet, në varësi të rëndësisë së shkeljes.

2. Nëse një kërkesë e tillë nuk është paraqitur bashkërisht nga të gjithë anëtarët e organit drejtues ose të gjithë anëtarët e shoqërisë së thjeshtë, kërkesa do të lejohet nga gjykata e falimentimit nëse shkaqet e parashikuara për fillimin e procedurës së falimentimit janë të mjaftueshme dhe bindëse. Gjykata e falimentimit dëgjon anëtarët e tjerë të organit drejtues dhe anëtarët e shoqërisë së thjeshtë që nuk i janë bashkuar kërkesës, para se të marrë një vendim.

**Neni 16**
**Kërkesa e kreditorit**

1. Gjykata e falimentimit duhet të pranojë kërkesën e kreditorit, nëse kreditori provon se debitori është në gjendjen e paaftësisë paguese. Për të paraqitur këtë kërkesë, kreditori duhet të provojë ekzistencën e një detyrimi të maturuar dhe të papaguar.

2. Gjendja e paaftësisë paguese prezumohet në qoftë se kreditori ka dështuar në ekzekutimin e një detyrimi në një procedurë të ekzekutimit të detyrueshëm gjatë periudhës së ekzekutimit vullnetar, sipas parashikimeve të nenit 517, të Kodit të Procedurës Civile. Debitori, me anë të paraqitjes së provave, mund të kundërshtojë këtë prezumim nëse vërteton se ka aftësi paguese dhe se nuk ka një detyrim të maturuar e të papaguar ndaj kreditorit.

**Neni 17**
**Shqyrtimi i kërkesës së debitorit**

1. Nëse debitori paraqet kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit, gjykata e falimentimit shqyrton përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji. Në qoftë se, pas një rishikimi të përgjithshëm të dokumenteve, vërtetohet gjendja e paaftësisë paguese të debitorit, gjykata e falimentimit deklaron fillimin e procedurës brenda 5 ditëve, në përputhje me nenin 29 të këtij ligji. Nëse nuk vërtetohet gjendja e paaftësisë paguese, gjykata e falimentimit refuzon kërkesën.

2. Nëse dokumentet e përcaktuara në nenin 14, të këtij ligji, nuk janë të plota, debitori i plotëson ato brenda 5 ditëve. Nëse brenda kësaj periudhe debitori nuk plotëson kërkesën, atëherë kërkesa i kthehet e pashqyrtuar.

**Neni 18**
**Shqyrtimi i kërkesës së kreditorit**

1. Nëse kreditorët paraqesin kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit, gjykata e falimentimit shqyrton kërkesën dhe kontrollon përputhshmërinë e saj me nenin 16 të këtij ligji. Nëse kërkesa është në përputhje me nenin 16, gjykata e falimentimit njofton debitorin për kërkesën brenda 5 ditëve, duke i bashkëngjitur një kopje të plotë të saj dhe të dokumenteve shoqëruese.

2. Debitori ka të drejtë të kundërshtojë me shkrim fillimin e procedurave të falimentimit brenda 10 ditëve nga momenti kur është njoftuar për kërkesën, duke siguruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të mbështetur pretendimet e tij. Në qoftë se debitori nuk e kundërshton në kohë fillimin e procedurës së falimentimit dhe nëse plotësohen kërkesat formale, gjykata e falimentimit deklaron fillimin e saj brenda 3 ditëve, në përputhje me nenin 29 të këtij ligji.

**Neni 19**
**Procedura në rastin e kundërshtimit të kërkesës së kreditorit nga debitori**

1. Brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kundërshtimit për fillimin e procedurës së falimentimit nga debitori, gjykata e falimentimit:

a) vendos datën e seancës gjyqësore dëgjimore, e cila do të mbahet jo më vonë se 30 ditë;

b) thërret në seancë gjyqësore debitorin dhe kreditorin/ët kërkues për fillimin e procedurës së falimentimit;

c) nëse një nga palët kërkon caktimin e një eksperti, ose nëse gjykata e falimentimit konsideron të domosdoshme që të ketë një mendim nga ana e ekspertit për të vendosur mbi fillimin e procedurës së falimentimit, gjykata e falimentimit vendos që të caktojë një ekspert ose një administrator të përkohshëm:

i) për të verifikuar nëse ekzistojnë shkaqe për të filluar procedurën e falimentimit;

ii) për të verifikuar nëse pasuritë e debitorit mund të mbulojnë kostot e procedurave të falimentimit;

iii) për të mbikëqyrur veprimtaritë e debitorit;

iv) për të dhënë një opinion nëse është e nevojshme të vendosen masa të përkohshme për të siguruar pasuritë.

2. Gjykata e falimentimit mund t'i kërkojë ekspertit të sjellë mendime shtesë për aspekte të tjera të çështjes.

3. Gjatë gjykimit të çështjes, gjykata e falimentimit shqyrton nëse është e nevojshme vendosja e masave të përkohshme mbi pasuritë e debitorit, sipas nenit 22 të këtij ligji.

4. Gjykimi i çështjes nga gjykata e falimentimit duhet të përfundohet sa më shpejt të jetë e mundur dhe, në çdo rast, jo më vonë se 10 ditë nga data e seancës gjyqësore.

5. Gjykata e falimentimit mund të vendosë, brenda afateve kohore të përcaktuara në këtë ligj, për:

a) refuzimin e kërkesës për shkak të mungesës së shkaqeve ligjore për fillimin e procedurës së falimentimit;

b) refuzimin e kërkesën për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurive të debitorit për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit; ose

c) pranimin e kërkesës dhe fillimin e procedurës së falimentimit dhe, në këtë rast, gjykata e falimentimit vendos sipas nenit 29 të këtij ligji.

**Neni 20**
**Rastet e mungesës së pasurisë**

1. Në rastet kur masa e falimentimit nuk ka pasuri të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit, gjykata e falimentimit vendos për përfundimin e procedurës për shkak të mungesës së pasurive.

2. Përpara se të vendosë përfundimin e procedurës, gjykata e falimentimit informon kreditorët dhe bën shpallje publike të gjendjes në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe në të gjitha autoritetet publike që, sipas rastit, kërkohen nga ligji për të pasqyruar shënimet përkatëse. Kreditorët dhe palët e tjera të interesuara kanë të drejtë që brenda 60 ditëve nga ky njoftim të paraqiten në gjykatën e falimentimit dhe të kundërshtojnë përfundimin e procedurës për shkak të mungesës së pasurive për arsyet e mëposhtme:

a) nëse debitori ka pasuri;

b) nëse hetimi i mëtejshëm është i nevojshëm në lidhje me pasuritë që debitori ka transferuar dhe që mund të jetë subjekt i veprimit të shmangies, në përputhje me nenet 79 deri 81 të këtij ligji.

3. Gjykata e falimentimit, brenda 5 ditëve nga mbarimi i afatit të kundërshtimeve, i komunikon prokurorit çdo pretendim të palëve, të cilat kanë arsye të bazuara për nevojën e kryerjes së hetimeve të mëtejshme mbi veprimet e debitorit, dhe pezullon procedurën për 6 muaj për kryerjen e hetimit.

4. Gjykata e falimentimit vendos përfundimin e procedurës për shkak të mungesës së pasurive nëse:

a) nuk ka pasur kundërshtime për përfundimin e procedurës nga palët që mund të kundërshtojnë, pas kalimit të afatit 60-ditor;

b) prokurori vendos mosfillimin ose pushimin e çështjes penale;

c) kanë kaluar 6 muaj nga komunikimi që gjykata i bën prokurorit për pezullimin e procedurës.

**Neni 21**
**Detyrimi i debitorit për të siguruar dokumentet**

Kur procedura e falimentimit ka filluar me kërkesë të kreditorit, debitorit i jepet 10 ditë kohë për t'i siguruar gjykatës së falimentimit të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm, në përputhje me nenin 14 të këtij ligji.

**Neni 22**
**Vendosja e masave të përkohshme**

1. Derisa të merret një vendim nga gjykata e falimentimit në lidhje me kërkesën për fillimin e një procedure falimentimi, gjykata e falimentimit mund të caktojë si masë të veçantë, me kërkesë të palës ose kryesisht, vendosjen e çdo lloj mase mbi pasurinë e debitorit, që e sheh të arsyeshme, për të shmangur dëmtimin e masës së falimentimit.

2. Në veçanti, gjykata e falimentimit mund:

a) të caktojë një administrator të përkohshëm për të mbikëqyrur debitorin ose të zëvendësojë debitorin nga administrimi;

b) të vendosë ndalimin e debitorit për të disponuar pasurinë në çdo mënyrë që është jashtë veprimtarisë normale të aktivitetit;

c) të urdhërojë masa të tjera që gjykata e falimentimit i konsideron të nevojshme për të shmangur dëmtime të situatës ekonomike/financiare të debitorit në dëm të kreditorëve.

3. Masat e përkohshme mbi pasuritë e debitorit, sipas këtij neni, mund të vendosen nga gjykata e falimentimit për një afat prej 30 ditësh që mund të zgjatet nga ajo për një periudhë të mëtejshme prej 30 ditësh. Pas kalimit të afatit të sipërpërmendur, masat e përkohshme mbi pasurinë e debitorit humbasin efektin.

4. Në rastet kur masat e përkohshme ndikojnë të drejtën e një një kreditori të siguruar në ekzekutimin e garancisë së tij për pasurinë e debitorit, gjykata e falimentimit do të pranojë vetëm masën e përkohshme për sa kohë që:

a) gjykata e falimentimit përcakton se vlera e pasurisë së siguruar është më e lartë se vlera totale e kredisë, përfshirë të gjitha kostot e ekzekutimit;

b) gjykata ka organizuar paraprakisht një seancë gjyqësore dëgjimore me kreditorët e siguruar që ndikohen nga kërkesa për masën e përkohshme.

5. Gjykata e falimentimit vendos masat e përkohshme të parashikuara nga ky nen, jo më vonë se 10 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës për fillimin e një procedure falimentimi.

6. Çdo palë e prekur nga masa e përkohshme ka të drejtën e ankimit të veçantë kundër vendimit të gjykatës së falimentimit për të vendosur ose refuzuar një masë të përkohshme.

**Neni 23**
**Administratori i përkohshëm**

1. Përpara fillimit të procedurës, gjykata e falimentimit mund të caktojë si masë të përkohshme një administrator të përkohshëm falimentimi ose një administrator të përkohshëm mbikëqyrës.

2. Nëse gjykata e falimentimit cakton një administrator të përkohshëm falimentimi dhe nuk i lejon debitorit të disponojë pasurinë e tij, e drejta për të administruar dhe disponuar pasurinë e debitorit i jepet administratorit të përkohshëm të falimentimit. Në raste të tilla, administratori i përkohshëm i falimentimit:

a) garanton sigurinë dhe ruajtjen e pasurisë së debitorit;

b) vazhdon administrimin e përditshëm të veprimtarisë së debitorit derisa gjykata e falimentimit të vendosë për fillimin e një procedure falimentimi;

c) kryen, si ekspert, detyrat e përshkruara në pikën 1, të nenit 19, të këtij ligji, me kërkesë të gjykatës së falimentimit; dhe

ç) kryen detyra të tjera që gjykata e falimentimit mund të urdhërojë.

3. Nëse gjykata e falimentimit cakton një administrator të përkohshëm mbikëqyrës pa vendosur ndaj debitorit ndonjë ndalim të përgjithshëm mbi disponimin e pasurisë, gjykata e falimentimit kërkon që

administratori i përkohshëm të kontrollojë veprimet e debitorit dhe t'i raportojë asaj masa të mëtejshme, të cilat mund të konsiderohen të nevojshme për administratorin e falimentimit.

4. Administratori i përkohshëm ka të drejtë të hyjë dhe të hetojë në mjediset e debitorit. Debitori duhet të lejojë administratorin e përkohshëm që të kontrollojë librat dhe shënimet e tij dhe t'i vendosë në dispozicion të gjithë informacionin e nevojshëm.

5. Administratori i përkohshëm ka të drejtë të japë përparësi për kryerjen e pagesave si kreditorë të masës së falimentimit furnizuesve të mallrave të nevojshme, shërbimeve dhe kredive të domosdoshme menjëherë pas kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit.

6. Administratori duhet t'i kërkojë gjykatës së falimentimit miratimin për të bërë pagesa me përparësi. Miratimi i gjykatës së falimentimit jepet nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) përparësia është e nevojshme për vazhdimin e funksionimit të veprimtarisë;

b) furnizimi i këtyre mallrave, shërbimeve dhe kredive është i domosdoshëm;

c) është treguar se një veprim i tillë është në interesin më të mirë të kreditorëve dhe masës së falimentimit.

7. Në raste urgjente, kur furnizimi i këtyre mallrave, shërbimeve dhe kredive është i domosdoshëm dhe kur miratimi i gjykatës së falimentimit mund të vonojë, administratori i përkohshëm mund të lejojë pagesën me përparësi pa miratim paraprak.

8. Administratori i përkohshëm është përgjegjës për dëmet në të njëjtën mënyrë si administratori i falimentimit ose administratori mbikëqyrës.

**Neni 24**
**Shpallja publike për kufizimet në disponimin dhe administrimin e pasurisë**

1. Vendimi për të kufizuar disponimin dhe/ose administrimin e pasurisë së debitorit, siç përmendet në nenin 22, të këtij ligji, si dhe caktimi i një administratori të përkohshëm falimentimi, shpallet publikisht. Përveç shpalljes publike, vendimi i njoftohet drejtpërdrejt debitorit dhe administratorit të përkohshëm të falimentimit kur vendimi është marrë në mungesë të tyre.

2. Vendimi për çdolloj kufizimi, që ka lidhje me disponimin dhe/ose administrimin e pasurisë, depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe në të gjitha autoritetet publike që, sipas rastit, kërkohen nga ligji për të pasqyruar shënimet përkatëse.

**Neni 25**
**Pasojat që rrjedhin nga kufizimet e disponimit të pasurisë**

1. Çdo veprim i debitorit në kundërshtim me kufizimet e vendosura në disponimin e pasurisë, sipas parashikimeve të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 22, të këtij ligji, është i pavlefshëm dhe palët e përfshira kthejnë në favor të masës së falimentimit përfitimet e tyre.

2. Nëse në kundërshtim me kufizimet e vendosura për disponimin e pasurive, shuma e detyruar ndaj debitorit merret nga debitori në vend të administratorit të përkohshëm të falimentimit, paguesit do t'i hiqet detyrimi vetëm nëse provon se në momentin e pagesës nuk ishte dhe as nuk është vënë në dijeni të kufizimeve të vendosura mbi disponimin e pasurive të debitorit.

**Neni 26**
**Shfuqizimi i masave të përkohshme dhe njoftimi i tyre**

1. Kur masat e përkohshme shfuqizohen, njoftimi dhe shpallja publike bëhen në të njëjtën mënyrë si në rastin e vendosjes së tyre.

2. Detyrimet e lindura gjatë periudhës së administrimit të përkohshëm konsiderohen shpenzime administrative.

**Neni 27**
**Shpërblimi i administratorit të përkohshëm të falimentimit**

1. Gjykata e falimentimit përcakton shpërblimin e administratorit të përkohshëm të falimentimit, pas caktimit të tij dhe, nëse procedura ka filluar, i kërkon debitorit ta paguajë atë, si dhe të rimbursojë

të gjitha shpenzimet. Gjykata e falimentimit, nëse refuzohet hapja e procedurës, mund t'ia ngarkojë shpenzimet e procedurës kërkuesit të fillimit të procedurës së falimentimit. Vendimi i komunikohet administratorit të përkohshëm të falimentimit, kërkuesit dhe debitorit.

2. Kundër vendimit për caktimin e shpërblimit të administratorit të përkohshëm të falimentimit dhe shpenzimeve, kanë të drejtën e ankimit të veçantë administratori i përkohshëm i falimentimit ose debitori dhe kreditori që kanë kërkuar fillimin e procedurës, kur shpenzimet i janë caktuar atyre.

3. Kriteret e caktimit të shpërblimit të administratorit të përkohshëm të falimentimit vendosen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## Neni 28
## Caktimi i ekspertit

1. Nëse për konstatimin ose sqarimin e fakteve kërkohen njohuri të posaçme në fushat e shkencës, teknikës ose të artit, të cilat nuk mbulohen nga njohuritë specifike të administratorit, gjykata e falimentimit mund të thërrasë, në çdo fazë të procedurës së falimentimit, një ose më shumë ekspertë në rast se kërkohet nga palët ose në rast se vlerësohet e arsyeshme nga gjykata e falimentimit.

2. Gjykata e falimentimit zgjedh njërin prej ekspertëve nga lista e gjykatës dhe përcakton detyrat e ekspertit, si dhe periudhën kohore për përgatitjen e raportit. Afati i përgatitjes së tij, si rregull, nuk duhet të kalojë 20 ditë, me përjashtim të rastit kur gjykata e falimentimit urdhëron ndryshe. Ekspertit i jepen të gjitha informacionet e çështjes dhe nuk mund të refuzojë detyrën e caktuar, pa një arsye të ligjshme.

3. Vendimi për të caktuar një ekspert i njoftohet menjëherë palëve pjesëmarrëse dhe ekspertit. Në të njëjtën kohë, gjykata e falimentimit i kërkon ekspertit të plotësojë dhe të nënshkruajë një deklaratë personale për marrjen dijeni për përgjegjësinë penale në rast ekspertimi të rremë dhe e fton të bëjë betimin se do të kryejë mirë e me nder detyrat që i janë besuar, me të vetmin qëllim që t'ia bëjë të ditur të vërtetën gjykatës së falimentimit. Kjo deklaratë dorëzohet në gjykatën e falimentimit së bashku me aktin e ekspertimit. Forma dhe përmbajtja e deklaratës miratohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

4. Brenda tri ditëve nga data e njoftimit të vendimit të gjykatës së falimentimit për caktimin e ekspertit, palët kanë të drejtë të bëjnë parashtrime me shkrim në lidhje me paanshmërinë ose njohuritë specifike të ekspertit në fushën përkatëse. Palët kanë të drejtë të kërkojnë përjashtimin e ekspertit nëse konstatojnë se ekzistojnë kushtet e përcaktuara në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile. Gjykata e falimentimit vendos pas kalimit të afatit 5- ditor që i jepet ekspertit për t'u përgjigjur. Ky vendim nuk është objekt ankimi.

5. Raporti i ekspertit paraqitet prej tij në sekretarinë e gjykatës së falimentimit brenda afatit të përcaktuar nga kjo gjykatë. Palëve u sigurohet mundësia për të marrë kopje të raportit para seancës gjyqësore.

## Neni 29
## Vendimi për fillimin e procedurës së falimentimit

1. Gjykata e falimentimit vendos për fillimin e një procedure falimentimi kur plotësohen kushtet e parashikuara në këtë ligj.

2. Vendimi për fillimin e procedurës së falimentimit përmban:

a) në rastin e një personi fizik, emrin, mbiemrin, atësinë, datën e lindjes, numrin personal të identifikimit dhe vendbanimin e debitorit ose, në rastin e personit juridik, emrin, llojin e veprimtarisë, numrin e identifikimit të personit të tatueshëm dhe vendbanimin;

b) caktimin e administratorit të falimentimit ose administratorit mbikëqyrës në rastet kur gjykata e falimentimit vendos regjimin e specifikuar në pikën 1, të nenit 61, të këtij ligji. Vendimi përmban emrin, mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal të identifikimit, numrin e licencës dhe adresën e administratorit të caktuar, duke treguar nëse është një administrator falimentimi ose një administrator mbikëqyrës;

c) urdhrin që siguron botimin e një kopjeje të shkurtuar të vendimit në faqen zyrtare të gjykatës, të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Fletoren Zyrtare;

ç) kërkesën ndaj çdo personi ose subjekti që pretendon të jetë kreditor i debitorit, për të paraqitur pretendimet e tij ndaj administratorit të falimentimit ose administratorit mbikëqyrës brenda 45 ditëve nga publikimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

d) datën në të cilën do të mbahet mbledhja mbi raportimin, e cila caktohet jo më vonë se 120 ditë nga data e vendimit;

dh) në rastet kur lista e kreditorëve, që është bashkëlidhur nga debitori në bazë të nenit 14, të këtij ligji, është e disponueshme, gjykata e falimentimit cakton një komitet të përkohshëm të kreditorëve, përveç rastit kur për shkak të veprimtarisë së vogël të biznesit ose faktorëve të tjerë, caktimi i këtij është i papërshtatshëm. Gjykata e falimentimit cakton 3 anëtarë, përfshirë

2 kreditorët më të mëdhenj të pasiguruar dhe kreditorin më të madh të preferuar. Nëse njëra prej kategorive nuk është e disponueshme ose nëse kreditorët refuzojnë t'i bashkohen komitetit të kreditorëve, gjykata e falimentimit cakton shumën vijuese më të madhe për secilën kategori, përveç asaj të kreditorëve fundorë. Në rast të paraqitjes së kërkesës nga kreditori/ët, gjykata e falimentimit cakton një komitet të përkohshëm të kreditorëve nëse debitori ka paraqitur listën e kreditorëve, në përputhje me nenin 21 të këtij ligji.

3. Kur vendimi merret për të caktuar një administrator falimentimi, parashikon në mënyrë specifike se çdo person fizik ose juridik, i cili ka detyrime ndaj debitorit, i paguan këto detyrime ndaj administratorit të falimentimit.

4. Ky vendim i njoftohet debitorit, administratorit të caktuar dhe kreditorit që ka bërë kërkesën e fillimit të procedurës së falimentimit. Administratori i paraqet një kopje të përmbledhur të vendimit secilit prej kreditorëve të njohur të debitorit, pavarësisht nga fakti që

kreditorët dhe çdo palë tjetër e interesuar konsiderohen të njoftuar si pasojë e shpalljes publike.

Neni 30

**Urdhri për masat e financimit**

1. Me miratimin paraprak të komitetit të kreditorëve, nëse është caktuar një i tillë, dhe me miratim të gjykatës së falimentimit, administratori i falimentimit ose administratori mbikëqyrës bashkë me debitorin, në rastet e parashikuara në pikën 1, të nenit 60, të këtij ligji, mund të marrin hua në çdo kohë pas fillimit të procedurës së falimentimit në rastet kur është e domosdoshme të ruhet vazhdimësia e veprimtarisë tregtare dhe kur kjo është në interesin më të mirë të kreditorëve. Çdo kredi e tillë do të trajtohet si shpenzim administrativ, sipas nenit 35 të këtij ligji.
2. Në marrjen e vendimit, gjykata e falimentimit konsideron ndër të tjera:
a) kohëzgjatjen e kryerjes së procedurës së falimentimit;
b) mënyrën se si debitori do të administrohet gjatë procedurës së falimentimit;
c) mundësinë e debitorit për t’u ristrukturuar me sukses dhe nëse huat do ta rritin këtë mundësi;
ç) nëse marrja e huave është mënyra e vetme e mundshme për ristrukturimin e kompanisë;
d) natyrën dhe vlerën e pasurisë në lidhje me shumën e marrë hua.
3. Përpara se gjykata e falimentimit të miratojë marrjen e huas, duhet të njoftojë kreditorët e siguruar, duke u caktuar një afat 5-ditor për të paraqitur pretendimet e tyre, nëse vlera e pasurisë së siguruar mund të ndikohet negativisht.
4. Nëse një procedurë riorganizimi është shndërruar në likuidim, çdo përparësi që i është dhënë këtyre huave në riorganizim do të vazhdojë të njihet edhe gjatë likuidimit.
5. Pas marrjes së vendimit për marrjen e huas, çdo kreditor ka të drejtën e ankimit të veçantë nëse pretendon se kostot e huave tejkalojnë çdo përfitim prej huamarrjeve të tilla.

Neni 31

**Regjistrat tregtarë dhe të pronës**

Në qoftë se debitori është i regjistruar në një regjistër tregtar, gjykata e falimentimit paraqet menjëherë në organin e regjistrimit një kopje të vendimit për fillimin e procedurës së falimentimit. Gjykata e falimentimit mund të delegojë këtë detyrë tek administratori i falimentimit ose administratori mbikëqyrës.

Neni 32

**Regjistrimi i vendimit të fillimit**

1. Administratori ia komunikon vendimin e fillimit të procedurës së falimentimit regjistrit të pasurive të paluajtshme duke bërë shënimet përkatëse:
a) për çdo pasuri të paluajtshme ku debitori është regjistruar si pronar;
b) për të gjitha të drejtat e tjera ligjore të debitorit, të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme.
2. Nëse gjykata e falimentimit vihet në dijeni për pasuri të paluajtshme të zotëruara nga

debitori ose nëse debitori ka të drejta të tjera të regjistruara, gjykata e falimentimit duhet të

urdhërojë administratorin të kërkojë këto regjistrime në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

3. Procedurat e përcaktuara në këtë nen duhet të zbatohen njëlloj me regjistrimin e vendimit të fillimit të procedurës së falimentimit në të gjithë regjistrat e tjerë publikë, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në regjistrin e barrëve siguruese dhe regjistrat e autoriteteve të tjera publike që janë përgjegjëse për regjistrimin e pasurive ose të të drejtave të tjera të debitorit mbi pasuritë që përbëjnë masën e falimentimit.

Neni 33

**Ankimi ndaj vendimit të fillimit**

1. Kundër vendimit për të pranuar ose refuzuar kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit nga gjykata e falimentimit, debitori ose kreditori, i cili ka kërkuar fillimin e procedurës të falimentimit, ka të drejtën e ankimit.

2. Nëse gjykata e apelit vendos prishjen e vendimit të gjykatës së falimentimit që lejon fillimin e procedurës së falimentimit, ky vendim shpallet publikisht.

3. Përfundimi i procedurës së falimentimit, në përputhje me çdo vendim të tillë, nuk cenon veprimet e kryera nga administratori i falimentimit ose palët e treta.

KREU II

KLASIFIKIMI I KREDITORËVE DHE I TË DREJTAVE TË TYRE Neni 34

**Kategoritë e kreditorëve**

1. Për qëllime të këtij ligji, kreditorët kategorizohen në kreditorë të procedurës së falimentimit dhe kreditorë të falimentimit.

2. Kreditorët e falimentimit kategorizohen në kreditorë të siguruar, kreditorë të preferuar, kreditorë të pasiguruar dhe kreditorë fundorë.

Neni 35

**Kreditorët e procedurës së falimentimit**

1. Janë kreditorë të procedurës së falimentimit ata që kanë të drejta që rrjedhin nga detyrimet e parashikuara në këtë nen dhe pretendimet e të cilëve lidhen me shpenzime të procedurës së falimentimit dhe shpenzime administrative të procedurës së falimentimit. Pretendimet e kreditorëve të procedurës së falimentimit paguhen kur bëhen të maturueshme dhe likuidohen përpara të gjithë kreditorëve të tjerë.

2. Janë shpenzime të procedurës së falimentimit:

a) shpenzimet gjyqësore;

b) shpërblimi i administratorit të përkohshëm të falimentimit, administratorit të falimentimit dhe administratorit mbikëqyrës;

c) shpenzimet e miratuara për anëtarët të komitetit të kreditorëve.

3. Janë shpenzime administrative të procedurës së falimentimit:

a) shpenzimet që rrjedhin nga veprimtaritë e administratorit të falimentimit ose administratorit mbikëqyrës në ekzekutimin e detyrave të përcaktuara në këtë ligj;

b) detyrimet e mbështetjes dhe mirëmbajtjes që rrjedhin pas fillimit të procedurave të

falimentimit, kur debitori është individ;

c) kreditë financiare ose tregtare që i janë dhënë debitorit me kërkesë të debitorit, me pëlqimin e administratorit mbikëqyrës ose me kërkesë të administratorit të falimentimit, në përputhje me këtë ligj, pasi të ketë filluar procedura e falimentimit;

ç) shumat që detyrohet debitori përmes kontratave të dyanshme që janë kryer ose miratuar nga administratori i falimentimit ose administratori mbikëqyrës pas fillimit të procedurës së falimentimit;

d) detyrimet që rrjedhin pas fillimit të procedurës së falimentimit, si rrjedhojë e pasurimit të padrejtë;

dh) çdo gjë tjetër e specifikuar si shpenzim administrimi në këtë ligj.

Neni 36

**Pretendimet me të drejtë përjashtimi**

1. Çdo individ, që ka të drejtën e pronësisë, të njohur nga ligji, mbi një pasuri në posedim të debitorit, ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e kësaj pasurie nga masa e falimentimit.

2. Në qoftë se debitori ka shitur një pasuri, për të cilën përjashtimi është pretenduar para fillimit të procedurës së falimentimit, pa marrë parasysh të drejtën e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, kreditori me të drejtë përjashtimi duhet të provojë pretendimin e tij si kreditor falimentimi, në mënyrë të pavarur nga të gjitha procedimet penale, të cilat mund të jenë në proces.

3. Nëse pasuria shitet pasi ka nisur procedura e falimentimit, kreditori me të drejtë përjashtimi do të konsiderohet si kreditor i procedurës së falimentimit.

Neni 37

**Kreditorët e siguruar**

1. Kreditorët me të drejta të vlefshme mbi pasuritë e siguruara, me peng, hipotekë ose ndonjë formë tjetër sigurimi të njohur nga Kodi Civil ose ligje të tjera të veçanta mbi pasurinë e debitorit të përfshirë në masën e falimentimit kanë të drejtë të vlerësojnë pasurinë e siguruar, në përputhje me kushtet e saj, duke iu nënshtruar përjashtimeve të përfshira në pjesën VI, kreu II, të këtij ligji.

2. Kreditorët e siguruar konsiderohen të pasiguruar për pjesën që mbetet e pashlyer nga pagesat e shitjes së pasurisë së siguruar. Ata janë të pasiguruar nëse heqin dorë nga e drejta e tyre e sigurimit.

Neni 38

**Kreditorët e preferuar**

Janë kreditorë të preferuar ata që paraqesin pretendimet e mëposhtme:

a) pretendimet, që rrjedhin nga ndërprerja e kontratës së punësimit deri në 3 muaj përpara paraqitjes së kërkesës për falimentim, duke përfshirë pagën dhe rimbursimet shëndetësore, pagesat e lejes së lindjes, të cilat nuk kalojnë shumën 500 mijë lekë në total për çdo kreditor;

b) pretendimet për shpenzimet e jetesës, që lindin përpara fillimit të procedurës së falimentimit, kur debitori është një person fizik;

c) pretendimet e punonjësve të debitorit për dëme ndaj shëndetit, të shkaktuara gjatë punës;

ç) pretendimet për shpërblimin e dëmit ndaj jetës ose shëndetit, të shkaktuar nga veprimet e padrejta të debitorit përpara fillimit të procedurës së falimentimit;

d) pretendimet për detyrimet e lindura nga taksat dhe tatimet një vit përpara paraqitjes së kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit.

Neni 39

**Kreditorët e pasiguruar**

Kreditorët e pasiguruar janë personat fizikë ose juridikë, që kanë pretendime të ngritura gjatë procedurës së falimentimit, të cilat nuk mund të klasifikohen si të siguruara, të preferuara ose fundore.

Neni 40

**Kreditorët fundorë**

1. Kreditorë fundorë janë kreditorët që kanë pretendime për:

a) sanksionet për pagesa të vonuara, të llogaritura mbi pretendimet e kreditorëve të falimentimit para fillimit të procedurës së falimentimit;

b) sanksionet, sipas Kodit Civil, legjislacionit administrativ dhe Kodit Penal, të cilat janë të detyrueshme për debitorin;

c) shlyerjen e kredive nga personat e lidhur me debitorin, nëse huadhënësi ishte një person i lidhur me debitorin në momentin e veprimit;

ç) kredi, për të cilat kreditori dhe debitori kanë rënë dakord të klasifikohen si fundorë.

2. Interesi i përllogaritur mbi pretendimet e kreditorëve fundorë renditet me status të njëjtë si pretendimet e tyre.

Neni 41

**Pretendimet e kushtëzuara dhe pretendimet me debitorë të ndryshëm**

1. Pretendimet, që i nënshtrohen një kushti pezullues, konsiderohen si të kushtëzuara, për aq kohë sa nuk është përmbushur kushti. Pretendimet e kushtëzuara duhet të përmenden në listën e kreditorëve sipas klasifikimit të tyre, por pa përfshirë shumat e tyre. Kreditorët nuk kanë të drejtë të votojnë në mbledhje ose të tërheqin pagesa, por, në qoftë se kushti përmbushet, administratori i falimentimit mund të kërkojë nga gjykata e falimentimit që të caktohet një shumë e veçantë përkohësisht për pagesat e tyre. E njëjta gjë do të jetë e zbatueshme në rastin e kërkesave kundër debitorit, të cilat janë objekt i një procesi gjyqësor në një gjykatë tjetër.

2. Një kreditor në procedurën e falimentimit, që ka pretendime ndaj disa personave, mund të paraqesë një kërkesë të vetme për shumën totale përkundrejt çdo debitori, njësoj sikur ai të kishte një kërkesë për shumën e përgjithshme në datën e fillimit të procedurës së falimentimit derisa kërkesa të jetë plotësuar tërësisht. Kreditorët që marrin pagesën e plotë ose të pjesshme nga debitorët e tjerë janë të detyruar të informojnë administratorin e falimentimit jo më vonë se 5 ditë pas kryerjes së pagesës.

## KREU III

## ADMINISTRATORI I FALIMENTIMIT ORGANET E PËRFAQËSIMIT TË KREDITORËVE

## SEKSIONI I

## ADMINISTRATORËT NË PROCEDURËN E FALIMENTIMIT Neni 42

**Kriteret për t'u caktuar si administrator në procedurën e falimentimit**

1. Caktohet si administrator falimentimi, administrator mbikëqyrës ose administrator i përkohshëm shtetasi shqiptar, i cili zotëron një diplomë të nivelit "Master" ose të njësuar me të, në shkencat ekonomike ose drejtësi, me të paktën pesë vite përvojë pune në këto fusha dhe që është i licencuar nga Agjencia Kombëtare e Falimentimit.

2. Kërkesat për të vepruar si administrator, procedura për dhënien dhe heqjen e licencës, si dhe kriteret e përzgjedhjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### Neni 43

**Caktimi i administratorëve në falimentim**

1. Gjykata e falimentimit është kompetente për të caktuar administrator të falimentimit, administrator mbikëqyrës dhe administrator të përkohshëm kandidatin që është i përshtatshëm për çështjen dhe i pavarur nga kreditorët dhe debitorët.

2. Nuk mund të caktohet si administrator, sipas pikës 1, të këtij neni, personi që:

a) ka marrëdhënie familjare ose biznesi me debitorin ose zyrtarët, drejtorët, stafin, aksionarët ose kreditorët e tij;

b) ka marrëdhënie familjare ose biznesi me gjykatën e falimentimit;

c) shërben si zyrtar, drejtor, është staf ose aksionar i konkurrentëve të drejtpërdrejtë të aktivitetit të debitorit;

ç) ka falimentuar në momentin e caktimit;

d) nuk mund të caktohet si drejtues i një shoqërie tregtare, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) ka dhënë paraprakisht këshilla profesionale ndaj debitorit.

### Neni 44

**Mbikëqyrja nga gjykata e falimentimit**

1. Gjykata e falimentimit mund t'i kërkojë administratorit, në çdo kohë, të japë informacione specifike ose të paraqesë një raport mbi ecurinë e procedurës së falimentimit dhe administrimin e masës së falimentimit.

2. Gjykata e falimentimit njofton Agjencinë Kombëtare të Falimentimit për mospërmbushjen e detyrimeve të administratorit, me qëllim që Agjencia të jetë në gjendje të përmbushë detyrat e veta dhe, nëse një hap i tillë është i pamundur, të zbatojë sanksione administrative ndaj administratorit.

Neni 45

**Shkarkimi dhe dorëheqja e administratorit të falimentimit**

1. Gjykata e falimentimit mund të shkarkojë administratorin, i cili nuk ka përmbushur detyrimet. Shkarkimi mund të urdhërohet nga gjykata e falimentimit me kërkesën e komitetit të kreditorëve, kreditorëve që zotërojnë së paku 10 për qind të shumës totale të pretendimeve ose debitorit. Gjykata e falimentimit dëgjon administratorin e falimentimit para se të marrë një vendim dhe, nëse kërkesa është paraqitur nga debitori, gjykata e falimentimit dëgjon komitetin e kreditorëve. Vendimi miratohet brenda 10 ditëve nga përgjigjja e administratorit ose me përfundimin e afatit për t'u përgjigjur.

2. Administratori mund të japë dorëheqjen nga detyrat e tij nëse ka arsye objektive dhe qëndrimi i tij në detyrë nuk do ishte në interesin më të mirë të kreditorëve. Kërkesa e tij e dorëheqjes vlerësohet nga gjykata e falimentimit. Dorëheqjet e pajustifikuara mund të ndëshkohen me gjobë administrative ose masa të tjera të parashikuara me akte nënligjore në zbatim të këtij ligji.

3. Administratori dhe pala që kërkon largimin e tij kanë të drejtë të paraqesin një ankim të veçantë në lidhje me çdo vendim të gjykatës së falimentimit lidhur me shkarkimin e administratorit.

Neni 46

**Zëvendësimi i administratorit të falimentimit**

1. Gjykata e falimentimit cakton menjëherë një administrator të ri, në rast të shkarkimit, dorëheqjes ose çdo shkaku tjetër që e bën të pamundur ushtrimin e detyrës së administratorit.

2. Administratori aktual vazhdon të kryejë detyrat deri në momentin që ia transferon administratorit zëvendësues.

Neni 47

**Përgjegjësitë e administratorit të falimentimit**

1. Administratori i falimentimit duhet të jetë i kujdesshëm në kryerjen e detyrave.

2. Administratori i falimentimit, në rastet e kryerjes së veprimeve ose mosveprimeve, në kundërshtim me detyrat e përcaktuara në këtë ligj, është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga pakujdesia ndaj masës së falimentimit ose drejtpërdrejt ndaj palëve pjesëmarrëse në procedurën e falimentimit.

3. E drejta për të pretenduar shpërblimin e dëmit ndaj administratorit të falimentimit parashkruhet pas tri viteve nga data kur pala e dëmtuar merr dijeni për dëmin dhe për rrethanat që tregojnë përgjegjësinë e administratorit për dëmin e shkaktuar, ose pas tri viteve nga data kur procedura e falimentimit ka përfunduar.

Neni 48

**Shpërblimi i administratorit të falimentimit**

1. Gjykata e falimentimit cakton shpërblimin që paguhet për administratorin e falimentimit, në përputhje me masën e parashikuar në pikën 3, të këtij neni, pavarësisht nga pozita në të cilën është caktuar administratori i falimentimit.

2. Rregullat për shpërblimin e administratorit të falimentimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

3. Në përcaktimin e shumës së shpërblimit që duhet paguar për administratorin e falimentimit, mbahet në konsideratë sa më poshtë:

a) vlera e pasurisë;

b) ndërlikimi ose jo i çështjeve të debitorit;

c) koha që administratori i falimentimit i ka kushtuar administrimit të pasurisë;

ç) çdo vendim i komitetit të kreditorëve ose të kreditorëve të asamblesë në lidhje me shpërblimin e administratorit të falimentimit, përfshirë caktimin e një tarife suksesi.

4. Administratori i falimentimit, debitori dhe kreditori i falimentimit kanë të drejtë të paraqesin ankim të veçantë ndaj vendimit të gjykatës së falimentimit mbi shpërblimin e administratorit, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Neni 49

**Paraqitja e llogarive**

1. Në përfundim të detyrës së tij, administratori i falimentimit paraqet llogaritë e tij pranë komitetit të kreditorëve. Ky i fundit mund të paraqesë komente brenda 10 ditëve nga paraqitja e tyre.

2. Llogaritë, së bashku me komentet e komitetit të kreditorëve, nëse ka të tilla, depozitohen në gjykatën e falimentimit. Debitori dhe kreditorët duhet të kenë akses dhe të marrin informacionin përkatës për këto llogari dhe komentet e komitetit të kreditorëve. Llogaritë publikohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në faqen e internetit të gjykatës, nëse ka të tillë.

3. Debitori dhe kreditorët e tij mund të kundërshtojnë llogaritë brenda një periudhe prej 10 ditësh nga momenti kur llogaritë janë depozituar në gjykatën e falimentimit. Nëse nuk ka kundërshtime, gjykata e falimentimit miraton llogaritë pa ndërmarrë veprime të mëtejshme.

4. Nëse ndonjëra nga palët paraqet ndonjë kundërshtim, teksti i kundërshtimit dhe çdo dokument për të mbështetur argumentet e parashikuara i njoftohen administratorit të falimentimit. Administratori i falimentit përgatit pretendimet e tij në formë të shkruar brenda 10 ditëve nga njoftimi.

5. Gjykata e falimentimit thërret administratorin dhe palën kundërshtuese në seancë gjyqësore brenda 10 ditëve nga data e përgjigjes së administratorit ose përfundimit të afatit të saj dhe merr vendim për çështjen.

SEKSIONI II KOMITETI I KREDITORËVE

Neni 50

**Caktimi dhe përbërja e komitetit të kreditorëve**

1. Pas caktimit të komitetit të përkohshëm të kreditorëve, sipas shkronjës “dh”, të nenit 29, të këtij ligji, mbledhja e kreditorëve, në çdo moment, mund të zëvendësojë ose të caktojë një komitet të ri kreditorësh.

2. Komiteti i kreditorëve duhet të përbëhet prej të paktën 3 anëtarësh dhe jo më shumë se 5 anëtarë, me të drejtë vote. Çdo anëtar, pavarësisht nga shuma e pretenduar, ka një votë.

3. Komiteti i kreditorëve është përfaqësues i kreditorëve të falimentimit, pa përfshirë kreditorët fundorë. Nëse është e mundur, komiteti i kreditorëve përfshin një kreditor të preferuar dhe një ose më shumë kreditorë të pasiguruar. Kreditorët e siguruar mund të caktohen, për aq kohë sa ata nuk formojnë shumicën e votave në komitet. Në qoftë se debitori ka të paktën 20 të punësuar, të paktën një përfaqësues nga punëmarrësit ka të drejtën për të marrë pjesë në komitetin e kreditorëve. Përfaqësuesi i të punëmarrësve nuk ka të drejtë vote për çështjet që trajtohen nga komiteti i kreditorëve, përveç rastit kur punëmarrësi është kreditor i debitorit dhe ka kreditorë të tjerë si ai.

Neni 51

**Funksionet dhe detyrat e komitetit të kreditorëve**

1. Anëtarët e komitetit të kreditorëve duhet të mbështetin dhe të mbikëqyrin aktivitetet e administratorit të falimentimit. Në veçanti, anëtarët e komitetit të kreditorëve mbikëqyrin drejtimin e veprimtarisë së debitorit.

2. Në mënyrë që të ushtrojë detyrën e vet, komiteti i kreditorëve mund të shqyrtojë librat dhe regjistrat e debitorit. Anëtarët e komitetit të kreditorëve kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin nga administratori informacion mbi vazhdimësinë e veprimtarive gjatë procedurës së falimentimit.

3. Një anëtar i komitetit të kreditorëve mund të përfaqësohet nga një person tjetër i autorizuar me shkrim për çështje të trajtuara nga ana e komitetit. Asnjë person nuk mund të veprojë njëkohësisht si anëtar i komitetit dhe si përfaqësues i një anëtari tjetër.

4. Administratorit mund t’i kërkohet pjesëmarrja në çdo mbledhje të komitetit të kreditorëve.

5. Komiteti i kreditorëve është një organ kolegjial. Mbledhja është e vlefshme nëse marrin pjesë shumica e anëtarëve të tij. Vendimi miratohet nga shumica absolute e anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

Neni 52

**Shkarkimi dhe përgjegjësia e anëtarëve të komitetit të kreditorëve**

1. Gjykata e falimentimit mund të shkarkojë një anëtar të komitetit të kreditorëve, për një arsye të justifikuar pas një kërkese me shkrim nga një palë pjesëmarrëse. Para marrjes së vendimit, gjykata e falimentimit dëgjon pretendimet e anëtarëve të komitetit të kreditorëve, palës kërkuese, si dhe anëtarit në fjalë.

2. Anëtarët e komitetit të kreditorëve mbajnë përgjegjësi për mospërmbushjen e detyrave të tyre.

Neni 53

**Shpenzimet e anëtarëve të komitetit të kreditorëve**

Anëtarët e komitetit të kreditorëve kanë të drejtë të shpërblehen për shpenzimet e tyre, për aq kohë sa ato janë të arsyeshme dhe të miratuara paraprakisht nga gjykata.

SEKSIONI III

MBLEDHJA E KREDITORËVE Neni 54

**Mbledhja e kreditorëve**

1. Mbledhja e kreditorëve thirret nga gjykata e falimentimit ose administratori i falimentimit apo ai mbikëqyrës. Administratori mund të thërrasë mbledhjen e kreditorëve sa herë që e gjykon të nevojshme për mirëfunksionimin e procedurës së falimentimit. Më tej, administratori duhet të thërrasë mbledhjen në rastet e mëposhtme:

a) për miratimin e vendimeve të parashikuara në këtë ligj për mbledhjen e kreditorëve;

b) në rast se kërkohet nga:

i) komiteti i kreditorëve;

ii) të paktën pesë kreditorë të falimentimit, përveç kreditorëve fundorë, që përfaqësojnë të paktën një të pestën e vlerës së përgjithshme të pretendimeve, përveç pretendimeve fundore;

iii) një ose më shumë kreditorë të falimentimit, me përjashtim të kreditorëve fundorë, pretendimi i të cilëve përfaqëson dy të pestat e vlerës së përgjithshme të pretendimeve, përveç pretendimeve fundore.

2. Në qoftë se administratori i falimentimit ose administratori mbikëqyrës nuk thërret mbledhjen e kreditorëve, sipas shkronjave "a" dhe "b", të pikës 1, të këtij neni, palët mund të paraqesin një kërkesë në gjykatën e falimentimit. Gjykata e falimentimit vendos për kërkesën për të thirrur mbledhjen e kreditorëve brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së saj. Periudha midis marrjes së vendimit të gjykatës së falimentimit dhe datës së mbledhjes së kreditorëve nuk duhet të jetë më shumë se 20 ditë.

3. Të gjithë kreditorët e falimentimit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjen e kreditorëve.

4. Data, koha, vendi dhe rendi i ditës i mbledhjes së kreditorëve duhet të shpallen publikisht. Vendimi për thirrjen e mbledhjes së kreditorëve publikohet në Fletoren Zyrtare dhe pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 55

**Ligjshmëria e mbledhjes së kreditorëve**

1. Mbledhja e kreditorëve kryesohet nga administratori i falimentimit ose administratori mbikëqyrës.

2. Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm të paktën 50 për qind e totalit të pretendimeve në thirrjen e parë dhe 35 për qind në të dytën.

Neni 56

**Përcaktimi i së drejtës së votës**

1. E drejta e votës përcaktohet në bazë të listës së kreditorëve. Në të gjitha mbledhjet e mbajtura para formimit të listës së kreditorëve, e drejta e votës korrespondon me kërkesat e parashtruara nga kreditorët e falimentimit që nuk janë të diskutueshme nga administratori i falimentimit ose nga ndonjë kreditor me të drejtë vote. Kreditorët fundorë nuk kanë të drejtë vote.

2. Kreditorët me pretendime të diskutueshme kanë të drejtë vote vetëm në masën e pretendimit të pranuar nga gjykata e falimentimit, pas dëgjimit të administratorit dhe çdo

personi tjetër që gjykata e falimentimit e mendon të arsyeshme.

Neni 57

**Vendimet e mbledhjes së kreditorëve**

1. Vendimi i mbledhjes së kreditorëve konsiderohet i vlefshëm nëse shumica në vlerën e pretendimeve të kreditorëve të falimentimit me të drejtë vote, të pranishëm personalisht ose përmes përfaqësimit, votojnë në favor të vendimit.

2. Vendimi për të miratuar një plan rehabilitimi dhe riorganizimi të përshpejtuar mbështetet në rregullat e parashikuara në nenet e krerëve II dhe IV të pjesës së pestë, të këtij ligji, si dhe të neneve të kësaj pjese, në rastin kur nuk është rregulluar shprehimisht në krerët e sipërpërmendur të pjesës së pestë.

Neni 58

**Kundërshtimi i vendimit të mbledhjes së kreditorëve**

1. Administratori i falimentimit dhe ai mbikëqyrës, kreditorët, me përjashtim të kreditorëve fundorë, kanë të drejtë për të kundërshtuar një vendim të mbledhjes së kreditorëve brenda 5 ditëve nga bërja publike e vendimit.

2. Vendimi mund të kundërshtohet në gjykatën e falimentimit vetëm për shkak të shkeljes së procedurave dhe formaliteteve të parashikuara në këtë ligj për thirrjen, zhvillimin dhe vendimmarrjen e mbledhjes.

3. Gjykata e falimentimit dëgjon administratorin, debitorin, komitetin e kreditorëve dhe çdo palë tjetër që e konsideron të rëndësishme dhe jep vendim brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kundërshtimeve të paraqitura me shkrim për vendimin e mbledhjes.

4. Vendimi i gjykatës së falimentimit për shfuqizimin e plotë ose të pjesshëm të vendimit të anuluar ose të ndryshuar të mbledhjes së kreditorëve shpallet publikisht.

5. Kundër vendimit të gjykatës së falimentimit për shfuqizimin e vendimit ka të drejtë të bëjë ankim të veçantë çdo kreditor që ka marrë pjesë në votim.

6. Ky nen zbatohet vetëm për vendimet në lidhje me miratimin ose refuzimin e një plani rehabilitimi ose riorganizimi, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në seksionet përkatëse.

Neni 59

**Informimi i mbledhjes së kreditorëve**

Mbledhja e kreditorëve mund t'i kërkojë administratorit të falimentimit të sigurojë informacione të nevojshme, si dhe të raportojë për ecurinë e procedurës së falimentimit dhe administrimin e masës së falimentimit.

PJESA E TRETË

EFEKTET E FILLIMIT TË PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT KREU I

EFEKTET E PËRGJITHSHME

Neni 60

**Efektet mbi të drejtat e debitorëve në administrimin dhe disponimin e pasurive të falimentuara**

1. Kur procedura e falimentimit nis me kërkesë të debitorit, automatikisht të drejtat e administrimit e të disponimit të masës së falimentimit do të vazhdojnë të jenë nën autoritetin e debitorit me kufizimet e mëposhtme:

a) të drejtat e debitorit do të jenë të kufizuara në veprime të administrimit të zakonshëm dhe janë objekt i kontrollit të përgjithshëm nga administratori mbikëqyrës;

b) administratori mbikëqyrës autorizon paraprakisht të gjitha veprimet e disponimit që janë jashtë fushës së veprimtarisë së zakonshme të biznesit ose që nuk përbëjnë vepra të ruajtjes së thjeshtë të pasurisë. Çdo posedim i pasurive, që janë objekt i të drejtave të siguruara, konsiderohet si një veprim jashtë veprimtarisë së zakonshme të aktivitetit të debitorit;

c) debitori nuk mund të kryejë veprime që janë brenda veprimtarisë normale të biznesit, të cilat në mënyrë të qartë janë kundërshtuar nga administratori mbikëqyrës;

ç) administratori mbikëqyrës ose çdo kreditor mund të kërkojë në çdo kohë nga gjykata e falimentimit heqjen tërësisht ose pjesërisht të të drejtave të administrimit e të disponimit të debitorit. Kjo kërkesë duhet të justifikohet sipas rregullave dhe të bazohet në ekzistencën e rrezikut ndaj pasurisë dhe interesit të kreditorëve.

2. Kur procedura e falimentimit nis me kërkesë të kreditorit, automatikisht të drejtat e debitorit për të menaxhuar dhe disponuar pasuritë e tij do të jenë nën autoritetin e administratorit të falimentimit.

3. Në vendimin për fillimin e procedurës së falimentimit dhe sipas vlerësimit të rrethanave, gjykata e falimentimit mund të ndryshojë efektin e të drejtave të debitorit që vijnë automatikisht nga identiteti i kërkuesit siç është parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 61

**Vazhdimi i aktivitetit ose veprimtarisë profesionale të debitorit**

1. Aktiviteti ose veprimtaria profesionale e debitorit vazhdon edhe pas fillimit të procedurës së falimentimit, pavarësisht nëse të drejtat e menaxhimit do të vazhdojnë të jenë nën autoritetin e debitorit ose të administratorit të falimentimit.

2. Nëse për shkak të mungesës së qëndrueshmërisë ose shkaqeve të tjera justifikuese, pezullimi i aktivitetit ose veprimtarisë profesionale është në të mirë të kreditorëve, gjykata e falimentimit e autorizon këtë, pas një kërkese nga administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës, debitori, ose komiteti i kreditorëve. Përpara miratimit të vendimit, gjykata e falimentimit në çdo rast duhet të dëgjojë administratorin e falimentimit ose atë mbikëqyrës.

Neni 62

**Disponimi nga ana e debitorit**

1. Nëse pas fillimit të procedurës së falimentimit, debitori ndërmerr veprime në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në nenin 60, të këtij ligji, këto veprime juridike mund të kundërshtohen në gjykatën e falimentimit me kërkesë të administratorit të falimentimit ose atij mbikëqyrës. Administratori kërkon anulimin e veprimit sa herë që prej tij i vjen një dëm masës së falimentimit ose kreditorëve. Efekti i pavlefshmërisë është

pezullimi i veprimit dhe anulimi i pasojave të tij. Pala tjetër kontraktore, që ka marrë pjesë në veprimin e mësipërm, është e detyruar të rikthejë çdo pasuri ose të drejtë të marrë dhe ka të drejtë të kërkojë kthimin e plotë të pasurisë ose të së drejtës së dhënë debitorit, përveç rastit kur ai ishte në dijeni të paaftësisë paguese të debitorit dhe ka vepruar në keqbesim për të fituar përparësi ndaj kreditorëve të falimentimit.

2. Pavlefshmëria e veprimit të zbatuar në kundërshtim me nenin 60, të këtij ligji, vendoset nga gjykata e falimentimit pas padisë së administratorit ose secilit prej kreditorëve ose grupi kreditorësh që mbajnë më shumë se 10 për qind të pretendimit të përgjithshëm. Gjykata e falimentimit njofton debitorin dhe palën tjetër pjesëmarrëse në veprim, e cila mund të paraqesë prapësime brenda 10 ditëve nga data e marrjes së njoftimit. Gjykata e falimentimit vendos për çështjen jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së padisë.

3. Në qoftë se debitori ka kryer transferta në ditën e fillimit të procedurës së falimentimit, këto transferta do të supozohen se kanë pasur efekt pas fillimit të procedurës së falimentimit.

Neni 63

**Përmbushja e detyrimit në favor të debitorit**

1. Në qoftë se debitori merr pagesa të një detyrimi pas fillimit të procedurës së falimentimit pa pasur të drejtë për të vepruar në këtë mënyrë, pala paguese shkarkohet nga detyrimi në qoftë se nuk kishte dijeni për fillimin e procedurës së falimentimit në kohën e kryerjes së pagesës.

2. Nëse pala paguese paguan detyrimin e vet pas publikimit të vendimit për fillimin e procedurës së falimentimit, atëherë prezumohet se ka pasur dijeni për fillimin e procedurës.

Neni 64

**Përgjegjësia e pakufizuar e ortakëve**

1. Nëse procedura e falimentimit fillon për pasurinë në pronësi të një shoqërie të thjeshtë ose një shoqërie me përgjegjësi të pakufizuar, administratori i falimentimit ose administratori mbikëqyrës mund të pretendojnë përgjegjësinë personale të ortakëve ndaj detyrimeve të kompanisë gjatë procesit të falimentimit.

2. Padia paraqitet në gjykatën e falimentimit dhe çdo pasuri ose mjet monetar i marrë nga gjykimi i saj do të jetë pjesë e masës së falimentimit.

Neni 65

**Detyrimi i debitorit për të dhënë informacion dhe për të bashkëpunuar**

1. Debitori dhe anëtarët e organit drejtues, në rastet e personave juridikë, si dhe anëtarët, ortakët dhe aksionarët e shoqërisë, për të cilën procedura e falimentimit ka filluar, nëse janë urdhëruar nga gjykata e falimentimit, kanë si detyrim kryesor të bëjnë publike çdo situatë që ka lidhje me procedurën e falimentimit pranë gjykatës së falimentimit, administratorit të falimentimit ose atij mbikëqyrës, komitetit të kreditorëve dhe mbledhjes së kreditorëve.

2. Debitori, anëtarët e organit drejtues, si dhe anëtarët, ortakët dhe aksionarët e shoqërisë, të cilët kanë filluar procedurën e falimentimit, duhet të mbështetin administratorin e falimentimit në përmbushjen e detyrave të tij.

3. Gjykata e falimentimit mund të nxjerrë urdhër ku përcaktohet që anëtarët e organit drejtues, si dhe anëtarët, ortakët dhe aksionarët e shoqërisë, për të cilët ka filluar procedura e

falimentimit, të jenë të disponueshëm në çdo kohë për të përmbushur detyrimet e tyre për të dhënë informacion dhe për të bashkëpunuar. Anëtarët e organit drejtues, si dhe anëtarët, ortakët dhe aksionarët e kompanisë, për të cilën procesi i falimentimit ka filluar, e kanë të ndaluar të ushtrojnë çdo veprimtari që pengon përmbushjen e këtyre detyrimeve.

4. Debitori mund të urdhërohet nga gjykata e falimentimit që të përmbushë detyrimin e tij për të bashkëpunuar dhe të ndalojë ushtrimin e çdo veprimtarie që është në kundërshtim me përmbushjen e detyrimit të tij.

5. Detyrimet e parashikuara në këtë nen mund të aplikohen njëlloj për punëmarrësit e debitorit dhe për punëmarrësit e mëparshëm që janë larguar brenda 2 viteve para fillimit të procedurës së falimentimit.

6. Mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë nen mund të sjellë përgjegjësi për dëmet e shkaktuara dhe, në rastin e debitorit, përbën kundërvajtje administrative. Vendimi i gjykatës për dhënien e masës administrative publikohet edhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 66

**Ekzekutimi i detyrimeve të debitorit**

1. Në qoftë se është e nevojshme për të dhënë deklarime të vërtetuara, gjykata e falimentimit urdhëron debitorin të paraqesë një deklaratë të shkruar, ku të përmendet se të gjitha provat e paraqitura prej tij përmbajnë të dhëna të vërteta, të sakta dhe të plota për faktet e kërkuara.

2. Pas marrjes në pyetje, gjykata e falimentimit mund t'i kërkojë debitorit të jetë i pranishëm dhe të mos largohet nga vendbanimi ose selia në rastet kur:

a) debitori, përfshirë drejtorët, zyrtarët, anëtarët ose aksionarët kontrollues të një shoqërie, për të cilën procedura e falimentimit ka filluar, nuk pranon të japë informacion ose deklaratë të shkruar ose të ndihmojë në përmbushjen e detyrimeve të administratorit të falimentimit;

b) debitori tenton të shmangë ekzekutimin e detyrimeve të tij për të dhënë informacion dhe për të bashkëpunuar, në veçanti, duke përgatitur largimin e tij jashtë territorit të Shqipërisë; ose

c) kufizimi i lëvizjes është i nevojshëm për të shmangur veprimet e debitorit që janë në kundërshtim me ekzekutimin e detyrimeve të tij për të dhënë informacion dhe për të bashkëpunuar dhe, në veçanti, të sigurojë pasurinë e përfshirë në procedurën e falimentimit.

3. Vendimi i gjykatës së falimentimit për marrjen e masave kufizuese, sipas pikës 2, të këtij neni, mund të anulohet nga vetë gjykata e falimentimit me kërkesë të administratorit të falimentimit, nëse shkaqet për të zbatuar urdhrin nuk ekzistojnë më. Kundër vendimit për të kufizuar lëvizjen dhe vendimit që refuzon kërkesën për të hequr këtë kufizim mund të bëhet një ankim i veçantë.

Neni 67

**Mbikëqyrja e postës së debitorit**

1. Gjykata e falimentimit, në bazë të kërkesës së administratorit të falimentimit ose atij mbikëqyrës dhe për shkaqe të arsyeshme, mund të urdhërojë subjektet e referuara në urdhër që të ridërgojnë tek administratori pjesë ose të gjitha korrespondencat dhe adresat e debitorit që mund të kenë lidhje me procedurën e falimentimit, në qoftë se konsiderohet e nevojshme për të hetuar ose parandaluar veprime të debitorit që shkaktojnë dëme ndaj kreditorëve. Vendimi shpallet pasi debitori është thirrur dhe deklarata e tij është dëgjuar nga gjykata e

falimentimit, përveç rasteve kur, për shkak të rrethanave të veçanta, kjo rrezikon qëllimin për të cilin është dhënë vendimi. Në qoftë se debitori nuk dëgjohet paraprakisht, vendimi i gjykatës së falimentimit duhet të shpjegojë arsyet për mospërmbushjen e këtij veprimi dhe seanca e dëgjimit të debitorit mbahet menjëherë.

2. Administratori ka të drejtë të lexojë korrespondencën e debitorit drejtuar atij. Posta që nuk lidhet me masën e falimentimit i dërgohet menjëherë debitorit. Posta tjetër mund të kontrollohet nga debitori.

3. Debitori mund të bëjë një ankim të veçantë për urdhrin e mbikëqyrjes së postës së tij. Në qoftë se shkaku për mbikëqyrjen e postës ka pushuar së ekzistuari, gjykata e falimentimit pezullon ekzekutimin e vendimit të mbikëqyrjes së postës, pasi ka dëgjuar deklaratën e administratorit të falimentimit ose atij të mbikëqyrjes.

Neni 68

**Pagesat për shpenzimet e jetesës ndaj debitorëve persona fizikë**

1. Debitori, person fizik, ka të drejtë të marrë nga masa e falimentimit minimumin e shpenzimeve të jetesës. Kjo vlerë përcaktohet nga administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës, pas konsultimit me komitetin e kreditorëve ose, kur ky komitet nuk ekziston, me gjykatën e falimentimit.

2. Shpenzimet e jetesës duhet të përmbushin nevojat bazë të debitorit, fëmijëve të mitur nën përgjegjësinë prindërore ose kujdestarinë e debitorit, përfshirë edhe ata që ndjekin shkollën deri në moshën 25 vjeç, bashkëshorten dhe ish-bashkëshorten, sipas detyrimeve që burojnë nga legjislacioni në fuqi.

3. Shpenzimet e jetesës nuk mund të jenë më pak se minimumi i përcaktuar nga legjislacioni i përkrahjes sociale.

4. Kundër vendimit të administratorit të falimentimit ose të atij mbikëqyrës, në lidhje me pagesat e shpenzimeve të jetesës, mund të bëhet ankim në gjykatën e falimentimit.

Neni 69

**Pezullimi i procedurës**

1. Pasi ka filluar procedura e falimentimit, nuk mund të kërkohen pretendime me përmbajtje ekonomike ndaj debitorit. Të gjitha pretendimet e kërkuara duhet të dokumentohen në procedurën e falimentimit, në përputhje me procedurat e rregulluara në këtë ligj.

2. Pas fillimit të procedurës së falimentimit, nuk mund të paraqiten ekzekutime të reja mbi pasurinë e debitorit dhe, ato që kanë filluar, duhet të pezullohen.

3. Pezullimi, referuar pikave 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohet për pretendime të bëra nga kreditorë të siguruar deri në sigurimin e pasurisë që është e nevojshme për vazhdimësinë e biznesit ose veprimtarisë profesionale të debitorit. Pezullimi aplikohet vetëm për një periudhë
6-mujore ose derisa të miratohet plani i riorganizimit, në varësi të situatës që do të ndodhë e para.

4. Gjykimi i padive kundër debitorit duhet të vazhdojë derisa vendimi të marrë formë të prerë. Vendimi, sidoqoftë, nuk mund të ekzekutohet dhe kreditori duhet të ndjekë procedurat e përshkruara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

5. Përjashtimisht, kur çështja në diskutim ka lidhje, në veçanti, me masën e falimentimit ose qëndrueshmërinë e biznesit, administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës mund të kërkojë nga gjykata kompetente transferimin e çështjes që ishte në proces në momentin e fillimit të procedurave të falimentimit në gjykatën e falimentimit.

6. Pezullimi nuk mund të zbatohet për pretendime me të drejtë përjashtimore.

Neni 70

**Kryerja e ekzekutimit përpara fillimit të procedurës së falimentimit**

Çdo pasuri e debitorit, e marrë nga përmbaruesi para fillimit të procedurës së falimentimit, dhe çdo e ardhur që përmbaruesi merr nga shitja e pasurisë përpara fillimit të procedurës së

falimentimit bëhet pjesë e masës së falimentimit dhe i dorëzohet administratorit të falimentimit 5 ditë pas njoftimit publik të fillimit të procedurës së falimentimit. Në qoftë se të ardhurat nga shitja e këtyre pasurive i janë paguar kreditorit që ka kërkuar ekzekutimin përpara fillimit të procedurës së falimentimit, kreditori mund t'i mbajë të ardhurat. Ky veprim mund të kundërshtohet sipas rregullave të parashikuara në dispozitat e kreut III të kësaj pjese.

Neni 71

**Kompensimi**

1. Nëse gjatë zbatimit të ligjit ose të një marrëveshjeje, kreditorit i ka lindur e drejta e kompensimit, sipas së cilës një detyrim i tij ndaj debitorit kompensohet me një detyrim që debitori kishte kundrejt tij deri në datën kur fillon procedura e falimentimit, atëherë kjo e drejtë nuk ndikohet nga procedura e falimentimit.

2. Kompensimi nuk ndodh nëse:

a) detyrimi i kreditorit të falimentuar në favor të masës së falimentimit lind vetëm pas fillimit të procedurës së falimentimit;

b) një kreditor i falimentimit e ka marrë të drejtën e kompensimit nga një kreditor tjetër, vetëm pas fillimit të procedurës së falimentimit;

c) masa e falimentimit ka një pretendim kundrejt një kreditori të siguruar. Asnjë kreditor i siguruar nuk ka të drejtë të kompensojë pretendimin e tij kundrejt një pretendimi të drejtpërdrejtë nga masa e falimentimit.

KREU II

PËRMBUSHJA E VEPRIMEVE JURIDIKE Neni 72

**Efektet në kontrata**

1. Në momentin e fillimit të procedurës së falimentimit, kur debitori ka ekzekutuar plotësisht detyrimet e tij sipas kontratës, por pala tjetër nuk e ka bërë këtë, debitori ka të drejtë të pretendojë ekzekutimin e plotë. Nëse pala tjetër ka ekzekutuar plotësisht detyrimet e saj, por debitori nuk e ka bërë këtë, pala tjetër ka një pretendim si kreditor falimentimi.

2. Si rregull, fillimi i procedurës së falimentimit nuk ka ndikim në vazhdimësinë e kontratës që nuk është ekzekutuar plotësisht nga debitori dhe pala tjetër e kontratës. Përjashtimet nga ky rregull janë përcaktuar në këtë ligj.

3. Administratori i falimentimit ose debitori, nën drejtimin e administratorit mbikëqyrës, mund të ekzekutojë kontratën dhe të pretendojë pagesën nga pala tjetër ose përmbushjen e detyrimit.

4. Administratori i falimentimit ose debitori, me autorizim të administratorit mbikëqyrës, ka të drejtë të përfundojë kontratën nëse është në dobi të procedurave të falimentimit. Nëse kontrata ka përfunduar, secilës palë i ndërpritet detyrimi i ekzekutimit të pjesës së mbetur sipas kontratës, dhe pala tjetër ka të drejtë të ngrejë pretendime për dëmet. Pretendimi i dëmeve trajtohet si një pretendim i pasiguruar i falimentimit.

5. Pala tjetër e kontratës mund t'i kërkojë administratorit të falimentimit ose debitorit nën drejtimin e administratorit mbikëqyrës të vendosë nëse kontrata do të ekzekutohet plotësisht dhe të njoftojë atë brenda 5 ditëve. Nëse administratori i falimentimit ose debitori nën drejtimin e administratorit mbikëqyrës nuk përgjigjet brenda kohës së specifikuar, atij i hiqet e drejta për të pretenduar ekzekutim të kontratës.

6. Rregullat e mësipërme nuk zbatohen për dispozita të veçanta dhe në kontrata sipas neneve të mëposhtme të këtij kreu.

Neni 73

**Marrëveshjet e ndaluara**

Është i pavlefshëm çdo kusht i kontratës ku debitori është palë, që parashikon zgjidhjen e parakohshme të saj ekskluzivisht për shkak të fillimit të procedurës së falimentimit.

Neni 74

**Veprimet në data fikse**
**Titujt financiarë**

1. Në qoftë se është rënë dakord që dorëzimi i mallrave të kryhet në një afat të caktuar dhe në rast se ky afat përfundon pas fillimit të procedurës së falimentimit, nuk mund të kërkohet përmbushja në natyrë e detyrimit, por mund të ngrihet vetëm pretendimi për dëmin e shkaktuar nga mospërmbushja e tij.

2. Nëse është rënë dakord që ekzekutimi i një veprimi të natyrës financiare me çmim tregu ose burse të kryhet në një afat të caktuar dhe në rast se ky afat kohor përfundon pas fillimit të procedurës së falimentimit, zbatohet njëlloj pika 1 e këtij neni. Konsiderohen veprime me natyrë financiare veçanërisht:
a) dorëzimi i metaleve të çmuara;
b) dorëzimi i titujve ose i të drejtave të ngjashme, me kusht që të mos jetë si qëllim pjesëmarrja në një shoqëri ose veprimtari për vendosjen e një pjesëmarrjeje afatgjatë;
c) përmbushja e detyrimeve në gjini, që duhet të ekzekutohen në monedhë të huaj ose njësi matëse përkatëse, sipas kursit të këmbimit;
ç) të drejta të tjera për furnizime ose zbatime kontrate, në kuptimin e shkronjave “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike;
d) sigurimet financiare, sipas legjislacionit financiar.

3. Nëse veprimet financiare janë të përfshira në një kontratë tip ose model, për të cilën është arritur një marrëveshje që në rast të falimentimit kontrata mund të përfundojë vetëm në tërësi, tërësia e këtyre veprimeve do të shihet si një kontratë e dyanshme.

4. Pretendimi për dëmin që vjen nga mospërmbushja e detyrimit llogaritet si diferenca midis çmimit për të cilin është rënë dakord me çmimin mbizotërues të tregut ose të bursës në vendin dhe kohën për të cilën është rënë dakord nga palët, por, megjithatë, jo më vonë se dita e pestë e punës pasi ka filluar procedura e falimentimit për një kontratë ku përcaktohet periudha e përmbushjes. Nëse palët nuk arrijnë të bien dakord, kjo datë do të jetë dita e dytë e punës pas hapjes së procedurës së falimentimit. Pala tjetër ka të drejtë të ngrejë pretendime për moszbatim kontrate vetëm si kreditor falimentimi.

Neni 75

**Ndalimi i ndërprerjes së kontratës së qirasë**

1. Kontrata e qirasë, e lidhur mes debitorit si qiramarrës dhe një pale tjetër, nuk mund të zgjidhet nga qiradhënësi pasi të jetë kërkuar fillimi i procedurës së falimentimit për shkak të:
a) mospagimit të qirasë para fillimit të procedurës së falimentimit;
b) përkeqësimit të gjendjes pasurore të debitorit.

2. Çdo shumë monetare, që është detyrim sipas kontratës deri në kohën e fillimit të procedurës së falimentimit, konsiderohet pretendim falimentimi. Detyrimi i qirasë, i lindur pas fillimit të procedurës së falimentimit, konsiderohet shpenzim administrativ. Mospërmbushja e detyrimit të qirasë pas fillimit të procedurës së falimentimit i jep të drejtë qiradhënësit për të zgjidhur kontratën.

Neni 76

**Mbarimi i porosisë**

1. Çdo kontratë porosie, që i është dhënë debitorit ose që është dhënë nga debitori dhe që i referohet masës së falimentimit, përfundon me fillimin e procedurës së falimentimit.

2. Nëse mbarimi i porosisë mund të shkaktojë dëme për interesat e procedurës së falimentimit, i porosituri vazhdon të kryejë veprimet e caktuara derisa administratori i falimentimit të ketë mundësinë të kujdeset vetë për këto veprime. I porosituri mund të pretendojë rimbursim të shpenzimeve të kryera për vazhdimin e punës, si kreditor i masës së falimentimit.

Neni 77

**Efektet në kontratat publike**

1. Efektet e fillimit të procedurës së falimentimit në kontratat administrative rregullohen nga ligji përkatës i sektorit publik. Në qoftë se këto rregullime specifike nuk ekzistojnë, aplikohet pika 2 e këtij neni.

2. Fillimi i procesit të falimentimit nuk sjell ndërprerjen e menjëhershme të kontratave publike dhe të të drejtave të koncesioneve. Administrata publike ka të drejtë të ndërpresë kontratat ose të drejtat e koncesioneve kur ekzistojnë arsye objektive për të besuar se rrezikohet përmbushja e zbatimit të kontratës. Ekzistenca e procedurës së falimentimit nuk konsiderohet e mjaftueshme për të ndërprerë kontratën për aq kohë sa aktiviteti ose veprimtaria profesionale vijon.

3. Kur kontrata i referohet ekzekutimit të një shërbimi publik bazë, administrata publike përkatëse ka të drejtë të marrë çdo masë të nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit.

Neni 78

**Efektet në kontratat e punësimit**

1. Si rregull i përgjithshëm, fillimi i procedurës së falimentimit nuk ndikon në vazhdimin e kontratave të punës.

2. Administratori i falimentimit ose ai i mbikëqyrjes mund të sugjerojë përfundimin ose ndryshimin e kontratave të punës. Ndikimi i përfundimit ose ndryshimit të kontratave të punës në përgjithësi rregullohet nga legjislacioni i punës. Në çdo rast, falimentimi konsiderohet si një shkak ekonomik objektiv për të përfunduar ose për të ndryshuar kontratat e punës.

3. Gjykata e falimentimit është kompetente për të vendosur në çdo çështje që lind si pasojë e përfundimit ose ndryshimit të kontratave të punës.

KREU III

KUNDËRSHTIMET E VEPRIMEVE TË DËMSHME NË PROCEDURËN E FALIMENTIMIT

Neni 79

**Veprimet që kundërshtohen**

1. Si rregull i përgjithshëm, të gjitha veprimet e debitorëve, të kryera brenda një periudhe prej 2 vitesh përpara fillimit të procedurës së falimentimit, mund të kundërshtohen në qoftë se i kanë shkaktuar një dëm pasuror debitorit ose i kanë dhënë preferencë të pajustifikuar një kreditori të caktuar.

2. Një dëm pasuror ekziston në ato raste kur debitori kryen veprime për të cilat vlera e marrë, në para ose ekuivalente me ato, është në mënyrë të konsiderueshme më e ulët se vlera në para ose ekuivalente me ato, e dhënë nga pala tjetër ndaj debitorit.

3. Ekzistenca e dëmit pasuror nevojitet të provohet nga personi që kundërshton veprimin, me përjashtimet e mëposhtme:

a) dëmi pasuror ndaj debitorit ekziston nëse:

i) debitori ka bërë një dhuratë ose ka kryer veprime me kushte që nuk i japin debitorit asnjë përfitim;

ii) debitori përmbush një detyrim të pasiguruar, i cili nuk ishte maturuar përpara fillimit të procedurës së falimentimit;

b) dëmi pasuror prezumohet, nëse nuk provohet e kundërta, kur:

i) janë kryer veprime me persona të lidhur me debitorin, siç është përcaktuar në pikën 24, të nenit 3, të këtij ligji;

ii) është dhënë një garanci për të siguruar një detyrim ekzistues ose një detyrim të ri që zëvendëson detyrimin e mëparshëm, kur detyrimi i mëparshëm nuk ishte i siguruar ose kishte një sigurim me vlerë me të ulët;

iii) është përmbushur një detyrim i siguruar që nuk ishte shlyer para fillimit të procedurës së falimentimit.

4. Në gjykimet për kundërshtimin e veprimeve të dëmshme, përveç ekzistencës së dëmit pasuror, gjykata e falimentimit vlerëson edhe veprimet e mëposhtme:

a) kur debitori ka hyrë në një veprim me mirëbesim për qëllime të vazhdimit të aktivitetit dhe kur, në të njëjtën kohë, ka baza të arsyeshme për të besuar se nga veprimi do të përfitojë edhe ai;

b) veprimet e ndërmarra nga debitori në kuptim të veprimtarisë normale të aktivitetit ose veprimtarisë profesionale, me kushte dhe afate të zakonshme;

c) garancitë dhe të drejtat që sigurojnë kontratat financiare;

ç) marrëveshjet e riorganizimit të përshpejtuar të lidhura jashtë gjykatës midis debitorit dhe kreditorëve duhet të mbështeten në rregulloren për marrëveshjen jashtëgjyqësore të riorganizimit të përshpejtuar. Kjo rregullore miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 80

**E drejta për kundërshtimin e veprimeve**

1. Administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës ka përgjegjësinë për të filluar kryesisht veprimet e kundërshtimit në procedurën e falimentimit.

2. Kreditorët, të cilët identifikojnë veprime të kundërshtueshme të debitorëve, mund t'ia komunikojnë këto administratorit të falimentimit ose atij mbikëqyrës. Në qoftë se administratori nuk fillon kundërshtimin e veprimeve brenda një periudhe prej 2 muajsh nga data e komunikimit, kreditori që ka njoftuar veprimin ka të drejtë të kundërshtojë veprimin, duke marrë përsipër shpenzimet dhe pasojat. Kreditori që paraqet kundërshtimin njofton administratorin për këtë veprim.

3. Kërkesa për kundërshtimin e veprimeve mund të paraqitet brenda 3 viteve nga data e fillimit të procedurës së falimentimit, përveç rasteve kur ka qenë objektivisht e pamundur për të marrë dijeni për shkakun e kundërshtimit të veprimit.

4. Kundërshtimi paraqitet kundër debitorit dhe palëve të tjera pjesëmarrëse në veprimin, objekt kundërshtimi. Në qoftë se pasuria, objekt i kundërshtimit, i është transferuar një pale të tretë, kundërshtimi duhet gjithashtu t'i drejtohet edhe palës së tretë nëse kundërshtohet e drejta e kësaj pale mbi këtë pasuri.

5. Gjykata e falimentimit është kompetente për të gjykuar paditë për kundërshtim duke zbatuar rregullat e përgjithshme procedurale.

Neni 81

**Efektet e kundërshtimit**

1. Vendimi i kundërshtimit të një veprimi përfshin të gjitha masat e nevojshme për të mos prekur masën e falimentimit nga veprimi. Në veçanti, vendimi mund:

a) të vendosë të rikthejë në masën e falimentimit çdo pronë të transferuar me veprimin e kundërshtuar;

b) të kërkojë çdo pronë të fituar nga çdo person, e cila mund të përfaqësojë shumën në të holla nga shitja e pasurisë së transferuar ose vetë transferimin e të hollave; ose

c) të heqë garancinë e vënë nga debitori për të siguruar pasurinë.

2. Nëse pasuritë ose të drejtat, objekt i veprimeve të shmangura, tashmë janë transferuar te një palë e tretë që është blerës në mirëbesim, gjykata e falimentimit urdhëron palën e tretë të dorëzojë, në masën e falimentimit, vlerën e pasurisë ose të drejtën në kohën e kryerjes së veprimit, së bashku me interesat. Në rast veprimi me keqbesim, kjo palë është përgjegjëse për të gjitha dëmet e shkaktuara ndaj masës së falimentimit.

3. E drejta e palës së tretë për të rimarrë përsëri atë që dorëzoi, konsiderohet si pretendim kundër procedurave të falimentimit, përveçse kur ka vepruar me keqbesim. Në këtë rast, pretendimi do të konsiderohet si fundor.

PJESA E KATËRT

ADMINISTRIMI DHE POSEDIMI I MASËS SË FALIMENTIMIT, PËRCAKTIMI I PRETENDIMEVE DHE VENDIMI PËR RIORGANIZIM OSE LIKUIDIM

KREU I

SIGURIMI I MASËS SË FALIMENTIMIT

**Neni 82**

**Posedimi i masës së falimentimit**

1. Nëse, në përputhje me pikën 1, të nenit 60, të këtij ligji, debitori vazhdon të ketë të drejtën e administrimit e të disponimit mbi masën e falimentimit nën drejtimin e administratorit mbikëqyrës, debitori posedon të gjithë pasurinë, përveç rastit kur administratori mbikëqyrës kërkon të marrë posedimin e një ose më shumë pasurive specifike. Marrja në posedim nga administratori mbikëqyrës konsiderohet e veçantë dhe kufizohet në rastet kur vlerësohet se është e nevojshme për të ruajtur vlerën e pasurisë.

2. Nëse, në përputhje me pikën 2, të nenit 60, të këtij ligji, të drejtat e debitorit për administrimin dhe disponimin e pasurisë pezullohen, administratori i falimentimit menjëherë merr posedimin dhe administrimin e të gjithë pasurisë që është pjesë e masës së falimentimit.

3. Në rastin e rregulluar nga pika 2, e këtij neni, debitori është i detyruar t'i japë administratorit të falimentimit të gjitha pasuritë, të cilat janë vendosur në ruajtje ose në përdorim nga ai dhe që janë pjesë e masës së falimentimit.

4. Administratori i falimentimit, për të marrë posedimin e pasurive të mbajtura në ruajtje ose në përdorim nga debitori, të cilat ende nuk janë dorëzuar, vepron brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit për fillimin e procedurës së falimentimit, në bazë të dispozitave të pjesës së katërt, të Kodit të Procedurës Civile, në lidhje me ekzekutimin e detyrueshëm.

Neni 83

**Inventari i masës së falimentimit**

1. Me fillimin e procedurës së falimentimit, administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës përpilon një inventar të detajuar të të gjithë pasurisë që përbën masën e falimentimit, brenda jo më shumë se 30 ditëve nga data e fillimit të procedurës së falimentimit. Debitori mund të jetë i pranishëm gjatë hartimit të këtij inventari, për aq kohë sa kjo nuk shkakton vonesa të panevojshme që dëmtojnë procedurën e falimentimit.

2. Vlera e çdo pasurie dhe të drejte duhet të përcaktohet. Nëse vlera e pasurisë ose e të drejtave varet nga fakti nëse aktiviteti ose veprimtaria profesionale e debitorit do të vazhdojë ose do të mbyllet, duhet të tregohen të dyja shumat përkatëse të mundshme. Për përcaktimin e vlerës së pasurive me rëndësi të veçantë, vlerësimi i të cilave paraqet vështirësi, mund të caktohet një ekspert.

3. Me kërkesë të arsyetuar me shkrim të administratorit të falimentimit ose të atij mbikëqyrës, gjykata e falimentimit mund të sigurojë një afat shtesë deri në 15 ditë për hartimin e inventarit.

Neni 84

**Mbajtja e llogarive sipas ligjeve tregtare dhe atyre fiskale**

1. Administratori i falimentimit mban llogaritë në përputhje me legjislacionin tregtar dhe fiskal. Në rastin e emërimit të një administratori mbikëqyrës, ato vazhdojnë të mbeten detyrë e debitorit që është nën mbikëqyrje.

2. Viti i ri financiar për palët në falimentim nis me fillimin e procedurës së falimentimit.

3. Nëse një auditues ligjor caktohet për vitin financiar para fillimit të procedurës së falimentimit, ky auditues nuk ndryshohet edhe pas fillimit të procedurës së falimentimit.

Neni 85

**Veprimet me rëndësi të veçantë**

1. Veprime me rëndësi të veçantë janë ato të cilat kanë për qëllim:

a) mbylljen ose tjetërsimin e të gjithë ose të një pjese të konsiderueshme të veprimtarisë profesionale të debitorit ose të pasurive të tij; ose

b) fillimin a mosfillimin, ose rënien dakord për një procedurë ligjore, në të cilën pasojat financiare për pasurinë e debitorit janë të konsiderueshme.

2. Nëse në çdo kohë gjatë procedurës së falimentimit, administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës ka për qëllim të mbyllë ose të shesë aktivitetin e debitorit ose të kryejë veprime të tjera me rëndësi të veçantë për procedurën e falimentimit, për këtë merr miratimin e gjykatës së falimentimit. Vendimi i gjykatës së falimentimit për miratimin ose jo të këtyre veprimeve merret pasi të jetë kërkuar mendimi i debitorit dhe i komitetit të kreditorëve, nëse është caktuar.

KREU II PËRCAKTIMI I PRETENDIMEVE

Neni 86

**Paraqitja e pretendimeve**

1. Kushdo, që pretendon të jetë kreditor në një procedurë falimentimi, paraqet me shkrim pretendimet e tij tek administratori i falimentimit ose ai i mbikëqyrjes brenda afatit të përcaktuar në vendimin për fillimin e procedurës së falimentimit. Kjo paraqitje shoqërohet me kopje të të gjitha dokumenteve që vërtetojnë pretendimin.

2. Paraqitja e pretendimit përmban burimin e lindjes së pretendimit, shumën e pretendimit dhe, kur është rasti, përcakton nëse pretenduesi është kreditor i siguruar ose i preferuar.

3. Me pëlqimin ose autorizimin e administratorit të falimentimit ose atij mbikëqyrës, pretendimi mund të paraqitet në mënyrë elektronike. Në një rast të tillë, dokumentet origjinale që vërtetojnë këtë pretendim do të paraqiten më pas me kërkesë të administratorit.

4. Për qëllimin e vetëm të vërtetimit të pretendimeve të tyre, pretendimet e kreditorëve për detyrimet që nuk janë maturuar ende, për shkak të procedurës së falimentimit, konsiderohen të maturuara.

Neni 87

**Lista e kreditorëve**

1. Administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës duhet të shqyrtojë, të kontrollojë vërtetësinë, të klasifikojë dhe të regjistrojë të gjitha pretendimet e kreditorëve në një listë. Lista përfshin identitetin e kreditorit, shumën dhe klasifikimin e padisë si të siguruar, të preferuar, të pasiguruar ose fundorë. Pretendimet që administratori sugjeron të refuzohen reflektohen në një listë të veçantë, me një përshkrim të shkurtër të arsyes së refuzimit.

2. Administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës e paraqet listën 20 ditë pas përfundimit të afatit për paraqitjen e kërkesave. Ky afat nuk mund të zgjatet.

3. Lista e kreditorëve paraqitet dhe depozitohet në gjykatën e falimentimit së bashku me parashtrimet dhe dokumentet shtesë për inspektim nga palët. Përfundimi dhe depozitimi i listës bëhen publike me njoftim në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare.

Neni 88

**Rregullat për përfshirjen e pretendimeve të njohura**

Administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës përfshin detyrimisht në listën e kreditorëve rastet e mëposhtme:

a) pretendimet, të njohura shprehimisht me vendim gjykate ose arbitrazhi;

b) pretendimet, të njohura nga një certifikatë zyrtare e lëshuar nga autoriteti përkatës publik;

c) pretendimet e siguruara nga një e drejtë sigurimi e regjistruar në një regjistër publik.

Neni 89

**Pretendimet e pakundërshtuara**

Pretendimet e kreditorëve të falimentimit, që janë përfshirë në listë nga administratori dhe nuk janë kundërshtuar nga debitori ose nga çdo kreditor tjetër, njihen dhe konsiderohen të verifikuara nga gjykata e falimentimit.

Neni 90

**Kundërshtimi i pretendimeve në listën e kreditorëve**

1. Të gjitha pretendimet e përfshira në listën e kreditorëve mund të kundërshtohen nga debitori ose kreditorët e falimentimit brenda 10 ditëve nga data e publikimit të depozitimit të listës së përcaktuar në nenin 87 të këtij ligji. Mund të kundërshtojnë listën e kreditorëve kreditorët, të cilët kanë kërkuar njohjen e pretendimeve të tyre nga administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës si edhe ata, pretendimi i të cilëve është sugjeruar për t'u refuzuar.

2. Kundërshtimi mund t'i referohet përfshirjes ose mungesës së përfshirjes së një pretendimi në listë, shumës së njohur ose klasifikimit të pretendimit. Kundërshtimi dorëzohet me shkrim dhe shoqërohet me dokumente që provojnë këto kundërshtime. Pala, që kundërshton listën, mund të kërkojë që të thirret një seancë për të dhënë dëshmi me gojë vetëm nëse është e domosdoshme. Gjykata e falimentimit mund të pranojë ose të mohojë këtë kërkesë bazuar në provat e çështjes.

3. Pala, e cila kundërshton një pretendim të përfshirë në listën e kreditorëve, dorëzon parashtrimin në gjykatën e falimentimit. Gjykata e falimentimit njofton administratorin e falimentimit ose atë mbikëqyrës dhe kreditorin përkatës që kundërshton listën. Administratori dhe kreditori kanë 10 ditë afat nga data e njoftimit për t'iu kundërpërgjigjur argumentimeve të bëra në kundërshtimin përkatës. Administratori ka për detyrë t'i përgjigjet çdo kundërshtimi. Nëse administratori bie dakord me kundërshtimin, këtë e komunikon zyrtarisht në gjykatën e falimentimit dhe ndryshon listën e kreditorëve rast pas rasti.

4. Gjykata e falimentimit vendos për të gjitha kundërshtimet brenda 15 ditëve nga momenti i marrjes së përgjigjes së administratorit.

5. Si rregull i përgjithshëm, kundërshtimi i një kërkesë nuk pezullon zhvillimin normal të procedurës së falimentimit. Nëse pretendimet e kundërshtuara ndikojnë në më shumë se 25 për qind të totalit të pretendimeve të përfshira në listën fillestare të kreditorëve, gjykata e falimentimit mund të pezullojë përkohësisht të gjithë ose një pjese të procedurës, për kohën që është e nevojshme për të zgjidhur kundërshtimet.

Neni 91

**Pretendimet jomonetare dhe pretendimet në monedhë të huaj**

Një pretendimi, i cili nuk është shprehur në terma të një vlere monetare të veçantë, i jepet vlera e llogaritur në datën e fillimit të procedurës së falimentimit. Pretendimet e shprehura në monedhë të huaj ose në një njësi matëse konvertohen në monedhën shqiptare, sipas kursit zyrtar të këmbimit në fuqi në

kohën e fillimit të procedurës së falimentimit për qëllime verifikimi dhe rillogariten në kohën e pagesës për të gjitha qëllimet e tjera.

Neni 92

**Paraqitja me vonesë e pretendimeve**

1. Pretendimet e paraqitura pas periudhës së caktuar në nenin 87, të këtij ligji, konsiderohen të vonuara. Pretendimi i supozuar i mungesës së informacionit për falimentimin e debitorit nuk konsiderohet i mjaftueshëm që kërkesa të trajtohet sikur të ishte paraqitur në kohën e duhur. Vonesa në vërtetimin e pretendimit nuk konsiderohet në asnjë rast pasi të ketë kaluar 1 vit nga fillimi i procedurës së falimentimit.

2. Pretendimet e vonuara humbasin të drejtën për t'u shqyrtuar në çdo vendim ose të përfitojnë çdo shpërndarje që ka ndodhur në procedurën e falimentimit para se pretendimi të ishte ngritur.

3. Pretendimet, ekzistenca e të cilave në periudhën e paraqitjes varej nga një hetim i kryer nga administrata publike, konsiderohen si kërkesa të vonuara, me përjashtim të rastit kur administrata publike përkatëse paraqet një pretendim si të kushtëzuar.

4. Nëse ka ndonjë kosto shtesë për shkak të pretendimit të vonuar, ato i ngarkohen kreditorit të vonuar.

KREU III

VENDIMI PËR RIORGANIZIMIN OSE LIKUIDIMIN

Neni 93

**Mbledhja e raportimit**

1. Mbledhja e raportimit kryesohet nga gjykata e falimentimit dhe ka si objektiv kryesor të vendosë nëse procedura e falimentimit do të vazhdojë me riorganizim ose me likuidim. Mbledhja merr vendim sipas shumicës së përcaktuar nga neni 108 i këtij ligji.

2. Në mbledhjen e raportimit, administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës duhet të raportojë për gjendjen financiare të debitorit dhe për faktorët që kanë shkaktuar paaftësinë paguese. Administratori analizon në perspektivë mirëmbajtjen e veprimtarisë së debitorit në tërësi ose në mënyrë të pjesshme, të tregojë çdo mundësi të hartimit të një plani riorganizimi dhe të përshkruajë se si secila prej zgjidhjeve mund të ndikojë te kreditorët.

3. Administratori dorëzon raportin me shkrim në gjykatën e falimentimit të paktën 10 ditë para mbledhjes së raportimit. Ky raportim do të jetë në dispozicion për të gjitha palët pjesëmarrëse.

4. Debitorit, kreditorëve të falimentimit, komitetit të kreditorëve dhe organit përfaqësues të punonjësve u jepet mundësia për të bërë komente për raportin e administratorit në mbledhjen e raportimit.

5. Me kërkesë të administratorit ose të një të tretës së mbledhjes së kreditorëve, mbledhja e raportimit mund shtyhet jo më shumë se 10 ditë, vetëm për një herë.

Neni 94

**Vendimi për riorganizim**

1. Nëse mbledhja e raportimit vendos riorganizim, mund t'i kërkohen administratorit hartimi i një plani riorganizimi, depozitimi i tij në gjykatën e falimentimit dhe bërja publike jo më vonë se 1 muaj përpara datës së mbledhjes së diskutimit dhe votimit të planit, të parashikuar në pikën 2 të këtij neni.

2. Me marrjen e vendimit për riorganizim gjatë mbledhjes së raportimit, gjykata e falimentimit vendos datën për mbledhjen e diskutimit e të votimit të planit. Kjo mbledhje mbahet jo më vonë se 60 ditë pas mbledhjes së raportimit.

Neni 95

**Vendimi për të filluar likuidimin**

Nëse në vendimin e mbledhjes së raportimit është caktuar fillimi i likuidimit të masës së falimentimit, gjykata e falimentimit i kërkon administratorit të falimentimit të hartojë një plan për likuidimin e masës së falimentimit të debitorit me përmbajtje dhe afate kohore siç është rregulluar në këtë ligj, në pjesën mbi likuidimin. Plani i likuidimit përfshin shitjen e aktivitetit ose të një apo më shumë aktiviteteve, duke ruajtur vazhdimësinë e tyre, për aq sa është e mundur.

PJESA E PESTË

RIORGANIZIMI DHE REHABILITIMI I PËRSHPEJTUAR KREU I

RIORGANIZIMI

Neni 96

**Dorëzimi i planit të riorganizimit**

1. Administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës, dhe kreditorët që kanë pretendime që përfaqësojnë 20 për qind ose më shumë të shumës totale të pretendimeve, kanë të drejtë të paraqesin një plan riorganizimi në gjykatën e falimentimit brenda 1 muaji nga data e mbledhjes së raportimit, e cila vendosi për riorganizimin e debitorit.

2. Debitori mund të paraqesë, menjëherë ose në çdo kohë, një plan riorganizimi së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit, brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Në qoftë se mbledhja e kreditorëve, sipas nenit 94, të këtij ligji, i ka kërkuar administratorit të falimentimit ose atij mbikëqyrës për të zhvilluar një plan riorganizimi gjatë përgatitjes së planit, administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës duhet të shqyrtojë rekomandimet nga kreditorët dhe debitori, në rast se ka të tilla.

4. Nëse debitori ka paraqitur një plan brenda 12 muajve të mëparshëm, i cili është refuzuar nga palët ose është tërhequr nga vetë debitori pas publikimit të datës së diskutimit në mbledhje, gjykata e falimentimit refuzon pranimin e një plani të ri nga debitori nëse një refuzim i tillë kërkohet nga administratori i falimentimit ose nga komiteti i kreditorëve, nëse është caktuar një i tillë.

Neni 97

**Informacioni mbi planin e riorganizimit**

1. Plani i riorganizimit i paraqitet gjykatës së falimentimit.

2. Gjykata e falimentimit ia paraqet menjëherë planin për komente:

a) komitetit të kreditorëve, nëse është caktuar, dhe organit përfaqësues të punonjësve, nëse ka;

b) debitorit, kur plani është paraqitur nga administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës ose kreditorët;

c) administratorit të falimentimit ose atij mbikëqyrës, kur plani është paraqitur nga debitori ose kreditorët.

3. Gjykata e falimentimit cakton një afat prej 10 ditësh nga momenti i njoftimit për paraqitjen e komenteve nga subjektet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

4. Paraqitja e komenteve për planin është e detyrueshme për komitetin e kreditorëve dhe administratorin e falimentimit ose atë mbikëqyrës. Administratori i falimentimit ose

administratori mbikëqyrës paraqet opinionin e tij për qëndrueshmërinë e aktivitetit si pasojë e zbatimit të planit, si dhe për mundësinë e zbatimit efektiv të tij.

Neni 98

**Përmbajtja e planit të riorganizimit**

Plani i riorganizimit, me qëllim që gjithë kreditorët me të drejtë vote të votojnë në mënyrë të informuar, përmban gjithë informacionin e nevojshëm në masën e mundshme dhe të zbatueshme, duke përfshirë:

a) një shpjegim të përgjithshëm, të përmbledhur, të veprimtarisë së debitorit e të rrethanave që sollën vështirësi financiare;

b) një listë dhe shpjegime të detajuara të masave për zbatimin e planit;

c) një listë të detajuar të kreditorëve të ndarë sipas klasave;

ç) të dhënat për shumat ose pasuritë që do të përdoren për zgjidhjen e plotë ose të pjesshme për çdo klasë të kreditorëve, pasuritë e rezervuara për kreditorët, pretendimet e të cilëve janë kundërshtuar, procedurat për zgjidhjen e pretendimeve, si dhe afatet kohore për këto zgjidhje;

d) përshkrimin e procedurave të shitjes së pasurisë, nëse ka, së bashku me një listë të pasurive për t'u shitur me ose pa interes sigurie dhe përdorimin e të ardhurave nga këto shitje;

dh) datën e fillimit dhe afatet për zbatimin e planit;

e) një deklaratë të qartë se miratimi i planit do të sjellë ripërcaktimin e të drejtave të të gjithë kreditorëve, në përputhje me planin, duke përfshirë situatat ku plani nuk zbatohet plotësisht ose kur zbatimi i tij pezullohet dhe detajet e mënyrës se si këto të drejta do të ripërcaktohen;

ë) një listë e të gjithë anëtarëve të organit drejtues të debitorit dhe shpërblimet e tyre;

f) të dhëna për mënyrën dhe afatet kohore, sipas të cilave debitori do të përmbushë pretendimet e kreditorëve, që vijnë nga shitja e të gjitha pasurive ose të të gjithë aktivitetit ose të një pjese të tij, nga marrja e kredive ose kapitalit nga palët e treta, nga reduktimi i borxhit, nga falja e borxheve ose shtyrja e afatit të tyre, nga konvertimi i borxhit ndaj kapitalit ose nga strategji të tjera të lejuara nga ligji;

g) emrin e administratorit mbikëqyrës të propozuar, nëse ka, dhe raportimin e detyrimeve ndaj kreditorëve nga ana e tij;

gj) parashikimet financiare, përfshirë llogarinë e humbjeve e të fitimeve të parashikuara, raportin e pasqyrave ekonomike e financiare gjatë periudhës së zbatimit të planit;

h) parashikimin e të ardhurave e të shpenzimeve të përgjithshme në rast likuidimi, në qoftë se likuidimi do të ishte kryer në kohën kur është dorëzuar plani.

Neni 99

**Klasat e kreditorëve**

1. Për qëllim të votimit të planit, kreditorët klasifikohen sipas klasave të parashikuara nga neni 144 i këtij ligji. Klasat formohen për secilën prej nënndarjeve të pretendimeve të preferuara.

2. Hartuesi i planit mund të propozojë krijimin e klasave brenda secilës kategori, në varësi të shkaqeve të ndryshme nga vlera ekonomike e pretendimeve. Krijimi i klasave mbahet parasysh në veçanti, në rastin e kategorisë së pretendimeve të pasiguruara.

3. Kreditorët fundorë, anëtarët, aksionarët ose ortakët e personit juridik nuk do të kenë të drejtë vote përveçse në rastin kur plani parashikon një ndryshim në strukturën e kapitalit të debitorit. Rregulli i mëparshëm nuk zbatohet për anëtarët/aksionarët/ortakët që janë edhe kreditorë dhe janë persona të lidhur me debitorin.

Neni 100

**Trajtimi i barabartë i pjesëtarëve brenda klasës**

1. Të gjithë pjesëtarët brenda së njëjtës klasë kanë të drejta të barabarta. Trajtimi i ndryshëm i pjesëtarëve brenda një klase lejohet vetëm me miratimin e të gjithë pjesëtarëve, rast në të cilin plani i riorganizimit do të shoqërohet nga një deklaratë e miratimit të secilit prej tyre.

2. Çdo marrëveshje e arritur mes administratorit të falimentimit ose atij mbikëqyrës dhe debitorit ose personave të tjerë që sigurojnë përfitime në kundërshtim me planin është e pavlefshme.

Neni 101

**Të drejtat e kreditorëve të siguruar**

1. Si rregull, plani i riorganizimit nuk cenon të drejtat e kreditorëve të siguruar.

2. Nëse plani synon të ndryshojë ose të reduktojë të drejtat e kreditorëve të siguruar në çfarëdo mënyre, plani duhet të caktojë mënyrën dhe masën në të cilën këto të drejta do të ndryshohen ose do të reduktohen, si dhe kohëzgjatjen e çdo vonese të propozuar që do të aplikohet për zbatimin ose realizimin e kërkesave të tyre të siguruara.

3. Në rastet kur plani cenon të drejtat e kreditorëve të siguruar, administratori i falimentimit merr miratimin e veçantë nga çdo kreditor i siguruar.

4. Kreditorët e siguruar, që votojnë planin deri në masën që ndikohen prej tij, janë të detyruar të njohin pasojat e planit të miratuar, pavarësisht nëse kanë votuar pjesërisht në favor të tij.

Neni 102

**Të drejtat e kreditorëve të preferuar**

1. Të drejtat e kreditorëve të preferuar cenohen vetëm nëse klasa, së cilës i përkasin, arrin shumicën e votave, siç parashikohet në nenin 108, të këtij ligji, ose nëse gjykata e falimentimit vendos në përputhje me nenin 112 këtij ligji.

2. Pavarësisht nga parashikimet e pikës 1, të këtij neni, kreditorët e preferuar bien dakord, siç parashikohet në nenin 108, të këtij ligji, për masat e parashikuara në përmbajtjen e planit të riorganizimit.

Neni 103

**Të drejtat e kreditorëve fundorë**

Pretendimet e kreditorëve fundorë konsiderohen të përjashtuara për qëllime votimi, përveçse kur parashikohet ndryshe në plan. Në rast se plani përfshin një ulje të vlerës të pretendimeve të kreditorëve të preferuar ose kreditorëve të pasiguruar, pretendimet fundore do të konsiderohen plotësisht joekzistente. Nëse plani parashikon vetëm një shtyrje të pagesës së plotë të pretendimeve të preferuara dhe atyre të pasiguruara, pretendimet fundore do të plotësohen, në mënyrën e parashikuar në plan, pasi të jenë përmbushur plotësisht pretendimet e preferuara dhe ato të pasiguruara.

KREU II

MIRATIMI I PLANIT TË RIORGANIZIMIT

Neni 104

**Mbledhja për të diskutuar dhe votuar planin**

1. Data e mbledhjes për diskutimin dhe votimin e planit caktohet nga gjykata e falimentimit, në përputhje me nenin 93, të këtij ligji, në mbledhjen që miratoi vendimin për riorganizimin e debitorit.

2. Mbledhja e diskutimit dhe votimit të planit zhvillohet në vendin, datën dhe orën e caktuar në vendimin e thirrjes së mbledhjes së gjykatës së falimentimit.

3. Mbledhja e diskutimit dhe votimit kryesohet nga gjykata e falimentimit, përveçse kur kjo e delegon tek administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës. Nëse mbledhja kryesohet nga gjykata e falimentimit, administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës vepron si sekretar. Nëse e kryeson administratori, ky emëron një sekretar.

4. Kryesuesi mund ta shtyjë mbledhjen për një ose disa ditë kur konsiderohet e nevojshme.

5. Mbledhja konsiderohet e vlefshme kur kreditorët pjesëmarrës ose të përfaqësuar zotërojnë të paktën 50 për qind të shumës totale të pretendimeve. Gjithashtu, mbledhja konsiderohet e vlefshme, kur marrin pjesë kreditorët që zotërojnë ose që përfaqësojnë 50 për qind të totalit të pretendimeve minus pretendimet e siguruara dhe ato fundore.

6. Pala, që parashtron planin e riorganizimit, duhet ta paraqesë atë të paktën 1 muaj përpara kësaj mbledhjeje.

7. Nëse askush nuk paraqet në kohë një plan riorganizimi, gjykata e falimentimit automatikisht fillon procedurat e likuidimit, përveçse kur administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës është porositur për të paraqitur një të tillë. Në këtë rast, gjykata e falimentimit thërret administratorin për të dëgjuar arsyet e vonesës dhe/ose miraton një kohë shtesë jo më shumë se 5 ditë për dorëzimin ose zëvendëson administratorin. Në rastin e zëvendësimit, administratori i ri do të ketë 10 ditë për të paraqitur një propozim.

8. Administratori, i cili në mënyrë të pajustifikuar vonon paraqitjen e një propozimi, mund të jetë subjekt i sanksioneve administrative.

Neni 105

**Pjesëmarrësit në mbledhjen e diskutimit dhe votimit**

1. Në mbledhjen e diskutimit dhe të votimit mund të marrin pjesë vetëm kreditorët e njohur rregullisht dhe që janë pjesë e listës së kreditorëve. Administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës përgatit një listë të kreditorëve që kanë të drejta vote në mbledhje.

2. Kreditorët mund të marrin pjesë personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të emëruar rregullisht. Përfaqësuesi mund të mos jetë kreditor. Debitori ose personat e lidhur me debitorin nuk mund të jenë përfaqësues. Deklarimi i përfaqësimit mund të bëhet gojarisht në gjykatën e falimentimit përpara sekretarit të gjykatës së falimentimit ose me prokurë noteriale.

3. Sekretari i mbledhjes përpilon një listë të pjesëmarrësve, duke përfshirë ata që marrin pjesë dhe ata që janë të përfaqësuar. Kjo listë i bashkëlidhet procesverbalit të mbledhjes pas miratimit të vendimeve.

Neni 106

**Mbyllja e mbledhjes së diskutimit dhe votimit**

1. Seanca deklarohet e hapur nga kryesuesi i mbledhjes, i cili është përgjegjës për shqyrtimin dhe për të vendosur për çështjet e ngritura nga pjesëmarrësit lidhur me organizimin e mbledhjes, nëse ka të tilla.

2. Çdo propozim për një plan riorganizimi shpjegohet publikisht nga propozuesi i tij. Të paktën 2 pjesëmarrësve u jepet mundësia e fjalës për të mbështetur ose kundërshtuar propozimin, nëse ka kërkesa të tilla. Kryesuesi ka të drejtën të kërkojë çdo sqarim që e konsideron të nevojshëm për t'i ofruar informacionin e duhur kreditorëve të pranishëm.

3. Propozimi i parë që diskutohet dhe votohet është propozimi i debitorit, nëse ka një të tillë. Propozimi i radhës është ai i hartuar nga administratori mbikëqyrës ose ai i falimentimit. Propozimet e mëtejshme që shqyrtohen janë ato të dorëzuara nga kreditorët, duke filluar nga ai që përmban shumën më lartë të pretendimeve. Në qoftë se një propozim miratohet, propozimet e tjera në vijim nuk do të konsiderohen.

Neni 107

**Ndryshimi i planit të riorganizimit**

Pala propozuese është përgjegjëse për ndryshimin e përmbajtjes së planit, në përputhje me vendimet e mbledhjes së diskutimit. Plani i ndryshuar mund të votohet në të njëjtën mbledhje, nëse ndryshimet e propozuara nuk janë të rëndësishme. Votimi duhet të bëhet në një mbledhje të mëvonshme dhe mbledhja e votimit duhet të zhvillohet brenda 15 ditëve në vijim, nëse ndryshimet janë të rëndësishme dhe ndikojnë mbi:

a) aspektet kryesore të vazhdimësisë së aktivitetit;

b) reduktimin e shumave të pretendimeve me më shumë se 5 për qind;

c) shtyrjen e kohës më shumë se 1 vit tjetër;

ç) çdo lloj përmbajtjeje tjetër që kryesuesi e konsideron të rëndësishme.

Neni 108

**Shumica e nevojshme**

1. Si rregull, pranimi i planit nga kreditorët kërkon që, në çdo klasë, shumica e vlerës së pretendimeve të kreditorëve të pranishëm ose të përfaqësuar me prokurë të votojë në favor të planit të riorganizimit.

2. Nëse plani parashikon reduktimin e më shumë se 50 për qind të pretendimeve ose një riplanifikim të tyre për më shumë se 5 vjet, klasa e prekur e miraton me të paktën 65 për qind të pretendimeve.

3. Nëse plani parashikon se një grup i kreditorëve brenda së njëjtës klasë do të trajtohet ndryshe, ata që konsiderohen të privilegjuar nga trajtimi i veçantë duhet të pranojnë një votim të veçantë nga shumica.

Neni 109

**Pëlqimi i debitorit**

1. Pëlqimi i debitorit për planin konsiderohet i dhënë në qoftë se ai nuk e kundërshton planin deri në datën e mbledhjes së votimit.

2. Në rastin e personave juridikë, çdo kundërshtim nga debitori konsiderohet i pavlefshëm nëse:

a) debitori, sipas planit, nuk vendoset në një situatë më të keqe në krahasim me gjendjen e tij në likuidim;

b) asnjë kreditor nuk merr një vlerë ekonomike që tejkalon shumën e plotë të pretendimeve të tij.

3. Pëlqimi i debitorit që është person juridik, jepet në mënyrën e parashikuar nga ligjet që rregullojnë personin juridik, si dhe në përputhje me aktin e themelimit të tij.

Neni 110

**Kundërshtimi i planit të riorganizimit**

1. Pas miratimit të planit, në përputhje me kërkesat dhe shumicën e parashikuar në këtë ligj, sekretari i mbledhjes harton procesverbalin, duke përfshirë një përmbledhje të diskutimit e të ndërhyrjeve publike të pjesëmarrësve në mbledhjen e diskutimit e të votimit, propozimin e pranuar dhe të gjithë informacionin në lidhje me votat e marra, duke përfshirë identitetin dhe klasifikimin e votuesve sipas klasave. Procesverbali, së bashku me versionin përfundimtar të planit të miratuar dhe listën e pjesëmarrësve e të pretendimeve të përfaqësuara, depozitohet në gjykatën e falimentimit.

2. Palëve u vihet në dispozicion procesverbali dhe dokumentet e bashkëngjitura në të, në përputhje me pikën 1 të këtij neni. Debitori, administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës, kreditorët, të

cilët votuan kundër planit ose kreditorët që nuk morën pjesë në mbledhje kanë të drejtë të kundërshtojnë ndaj miratimit përfundimtar të planit, brenda 10 ditëve nga data e depozitimit në gjykatën e falimentimit.

3. Kundërshtimi mund të bëhet vetëm për shkeljet e dispozitave të këtij ligji lidhur me përmbajtjen e planit, me formimin e shumicës ose për ndonjë nga kërkesat formale procedurale të parashikuara në këtë ligj për finalizimin e mbledhjes.

4. Plani mund të kundërshtohet edhe për shkak të pamundësisë së zbatueshmërisë së tij nga debitori, administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës ose prej kreditorëve që mbajnë të paktën 15 për qind të pretendimeve.

5. Kundërshtimi i planit duhet të bëhet në formë të shkruar dhe të paraqitet në gjykatën e falimentimit brenda periudhës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, së bashku me të gjitha dokumentet dhe materialet argumentuese.

6. Gjykata e falimentimit njofton debitorin, administratorin e falimentimit ose atë mbikëqyrës dhe kreditorët që morën pjesë në mbledhjen për kundërshtimin, duke iu dhënë atyre një afat 10-ditor për paraqitjen e prapësimeve. Në rast se kundërshtimi është bazuar në pamundësinë e zbatueshmërisë së planit, administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës dhe komiteti i kreditorëve, në qoftë se është formuar, do të dëgjohen nga gjykata e falimentimit. Nëse është e nevojshme, gjykata e falimentimit mund të caktojë përjashtimisht një ekspert për të vlerësuar pamundësinë e zbatueshmërisë së planit.

7. Gjykata e falimentimit vendos në lidhje me kundërshtimin/et e planit brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të periudhës së paraqitjes së kundërshtimit/ve të parashikuara në pikën 6 të këtij neni.

Neni 111

## Miratimi automatik i planit nga gjykata e falimentimit

Nëse brenda 10 ditëve, nuk është depozituar asnjë ankim, sipas nenit 110, të këtij ligji, gjykata e falimentimit shpall miratimin e planit pa ndonjë veprim të mëtejshëm.

Neni 112

## Rregulli i veçantë për miratimin e planit të riorganizimit

1. Kur në mbledhjen e diskutimit e të votimit të planit, një klasë nuk ka arritur shumicën e nevojshme, të parashikuar në nenin 108, të këtij ligji, plani konsiderohet gjithsesi i miratuar, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) kreditorët e klasës në fjalë nuk vendosen në situatë më të keqe me ekzekutimin e plotë të planit sa do të ishin në gjendjen e likuidimit të debitorit;

b) pjesëtarët e klasës nuk janë të diskriminuar padrejtësisht në krahasim me pjesëtarët e klasave të tjera brenda së njëjtës nënndarje;

c) asnjë pjesëtar i ndonjë klase tjetër nuk merr një kompensim më të lartë se shuma e pretendimeve të tij.

2. Gjykata e falimentimit shqyrton përmbushjen e kushteve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, së bashku me kundërshtimet e paraqitura ndaj planit, me kërkesë të palëve kundërshtuese.

Neni 113

## Shpallja e miratimit të planit të riorganizimit nga gjykata e falimentimit

1. Vendimi i gjykatës së falimentimit që miraton ose refuzon planin e riorganizimit bëhet publik sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 3 ditë.

2. Nëse plani miratohet, një kopje e planit, një përmbledhje e përmbajtjes thelbësore të tij dhe vendimi i miratimit u komunikohen kreditorëve të falimentimit, kreditorëve të procedurës së falimentimit dhe aksionarëve ose zotëruesve të tjerë në kapitalin e debitorit.

Neni 114

**Ankimi**

1. Kundër vendimit të gjykatës së falimentimit për miratimin ose refuzimin e planit të riorganizimit mund të bëjnë ankim kreditorët që kundërshtuan planin ose debitori.

2. Ankimi duhet të paraqitet me shkrim brenda 10 ditëve nga momenti i njoftimit publik të vendimit të gjykatës së falimentimit për procedurën e ankimit.

3. Ankimi nuk pezullon zbatueshmërinë e planit të riorganizimit, përveçse kur gjykata e apelit vendos ndryshe, mbështetur në shkaqe që cenojnë rëndë interesat e kreditorëve ose interesat publikë.

KREU III

EFEKTET E PLANIT TË MIRATUAR. MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË PLANIT

Neni 115

**Efektet e përgjithshme të planit**

1. Nëse gjykata e falimentimit nxjerr vendimin për miratimin e planit të riorganizimit, përmbajtja e planit është detyruese për të gjithë kreditorët, në përputhje me kushtet e tij dhe dispozitat e këtij ligji.

2. Plani nuk duhet të cenojë të drejtat e kreditorëve të falimentimit kundrejt bashkëdebitorëve ose garantuesve të debitorit apo të drejtat e këtyre kreditorëve mbi pasuritë që nuk janë pjesë e masës së falimentimit a që rrjedhin nga një e drejtë e siguruar që mbulon këto pasuri. Megjithatë, debitori shkarkohet nga detyrimet e bashkëdebitorëve, garantuesve ose palëve të tjera që pretendojnë kundrejt tij në të njëjtën mënyrë sikurse shkarkohet në lidhje me detyrimet e tij ndaj kreditorëve të falimentimit.

Neni 116

**Të drejtat mbi pasuritë e luajtshme**

1. Pëlqimi i palëve konsiderohet si i dhënë në formën e kërkuar nga ligji nëse në plan janë përcaktuar, vendosur ose revokuar të drejtat mbi pasuritë e luajtshme ose është përcaktuar se kapitali ose kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar janë transferuar.

2. Çdo marrëveshje e ortakëve ose aksionarëve të debitorit dhe çdo pëlqim që kërkohet nga këto palë konsiderohet si i dhënë në formën e kërkuar nga ligji nëse pjesëmarrja, kuotat, kapitali ose të drejtat e një personi ndaj debitorit preken nga plani. Administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës është përgjegjës për depozitimin në Regjistrin Tregtar Kombëtar të dokumenteve të nevojshme.

Neni 117

**Efektet e verifikimit të planit nga gjykata**

1. Detyrat e administratorit të falimentimit ose atij mbikëqyrës konsiderohen të plotësuara me publikimin e miratimit të planit nga gjykata e falimentimit. Administratori mbikëqyrës mbetet në detyrë për të mbikëqyrur zbatimin e planit, nëse plani e parashikon shprehimisht këtë me kompetencat e detyrat e tij. Për sa nuk parashikohet në këtë plan, do të zbatohen dispozitat e këtij kreu.

2. Debitori, në përputhje me kushtet e planit të riorganizimit dhe nëse nuk caktohet ndryshe, rimerr të drejtën për të vendosur për masën e falimentimit, si dhe të drejtën e përfaqësimit në marrëdhënie me të tretët dhe gjykatën.

3. Nëse kufizimet lidhur me administrimin dhe për të vendosur mbi pasuritë vazhdojnë të mbeten ose shtohen të tjera, ato duhet të regjistrohen në regjistrat publikë.

Neni 118

## Zbatimi i planit

1. Me publikimin e vendimit të gjykatës së falimentimit për miratimin e planit, të gjitha kërkesat për ekzekutim, që rrjedhin nga pretendimet para falimentimit kundër debitorit, pezullohen gjatë kohëzgjatjes së parashikuar për zbatimin e planit ose do të pushohen nëse parashikohet shprehimisht në plan.

2. Gjykata e falimentimit, si përjashtim, mund të lejojë ekzekutime të caktuara, të cilat nuk do të pengojnë zbatimin e planit, me kërkesë të palës zbatuese dhe pas dëgjimit të administratorit mbikëqyrës.

Neni 119

## Monitorimi i zbatimit të planit dhe mbikëqyrjes së shpenzimeve

1. Nëse nuk përcaktohet ndryshe, administratori mbikëqyrës harton një raport vjetor për progresin e zbatimit të planit dhe e depoziton atë në gjykatën e falimentimit për t'u konsultuar me kreditorët.

2. Nëse nuk ka administrator mbikëqyrës, kjo detyrë i ngarkohet debitorit.

3. Kreditorët dhe gjykata e falimentimit kanë të drejtë të kërkojnë, në çdo kohë, informacion shtesë mbi ecurinë e planit.

Neni 120

## Mospërmbushja e planit të riorganizimit

1. Nëse administratori mbikëqyrës konstaton se pretendimet nuk janë paguar ose nuk mund të paguhen apo nëse ka ndodhur ndonjë mospërmbushje tjetër, ai informon menjëherë gjykatën e falimentimit dhe bën një deklaratë për mospërmbushjen sipas planit.

2. Çdo kreditor, i cili është në dijeni për një mospërmbushje të rëndësishme të kushteve të planit, mund të depozitojë në gjykatë një deklaratë lidhur me të. Sipas këtij rregulli, konsiderohet mospërmbushje e rëndësishme mospagesa e një kësti të parashikuar në plan.

3. Gjykata e falimentimit njofton debitorin, të cilit i jep 5 ditë në dispozicion për të dhënë shpjegime.

4. Konstatimi nga gjykata e falimentimit i ekzistencës së mospërmbushjes sjell fillimin e procedurave të likuidimit.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë.

Neni 121

## Përfundimi i zbatimit të planit të riorganizimit

1. Administratori mbikëqyrës ose debitori informon gjykatën e falimentimit për plotësimin e zbatimit të planit të riorganizimit, duke paraqitur vërtetime ose dëftesa për përmbushjen e plotë të të gjitha kushteve për të cilat është rënë dakord në planin e riorganizimit.

2. Gjykata e falimentimit shprehet me vendim për përmbushjen, në përputhje me planin. Vendimi i gjykatës së falimentimit në këtë rast do të shpallet publikisht.

3. Çdo palë e interesuar do të ketë në dispozicion 10 ditë nga data e shpalljes për ankim, duke siguruar prova për mospërmbushjen.

4. Në rast ankimi, gjykata e falimentimit dëgjon debitorin dhe administratorin mbikëqyrës dhe merr një vendim brenda 5 ditëve, me anë të të cilit vendos ose miratimin e zbatimit të plotë ose fillon procedurën e likuidimit.

## KREU IV RIORGANIZIMI I PËRSHPEJTUAR

### Neni 122

### **Qëllimi i riorganizimit të përshpejtuar**

Qëllimi i këtij kreu është t'i japë debitorit mundësinë për të kapërcyer një situatë të pashmangshme të paaftësisë paguese me anë të një marrëveshjeje ndërmjet debitorit dhe kreditorëve të tij, të hartuar jashtë gjykatës së falimentimit dhe të miratuar nga kjo gjykatë me procedurë të shpejtë.

### Neni 123

### **Fillimi i riorganizimit të përshpejtuar**

1. Debitori që e gjen veten në një situatë të pashmangshme paaftësie paguese mund të kërkojë fillimin e procedurës së përshpejtuar të riorganizimit, sipas dispozitave të këtij kreu.

2. Një debitor konsiderohet në një situatë të pashmangshme paaftësie paguese, kur është objektivisht e parashikueshme që nuk do të jetë në gjendje për të shlyer në kohë detyrimet në një periudhë prej 6 muajsh ose më pak.

3. Debitori paraqet kërkesën duke përfshirë:

a) të gjitha dokumentet e renditura në shkronjat "a" deri në "e", të pikës 1, të nenit 14, të këtij ligji, përshtatur me situatën e pashmangshme të paaftësisë paguese;

b) një propozim të planit të riorganizimit, duke përfshirë detyrimisht përmbajtjen e përshkruar në nenin 98 të këtij ligji;

c) deklaratë noteriale për gatishmërinë e mbështetjes së kreditorit/ëve, që përfaqësojnë 30 për qind ose më shumë të vlerës totale të pretendimeve të regjistruara në llogaritë e debitorit.

4. Kërkesa dorëzohet në gjykatën e falimentimit ku debitori ka qendrën kryesore të interesit.

### Neni 124

### **Vendimi për fillimin e procedurës së riorganizimit të përshpejtuar**

1. Gjykata e falimentimit shqyrton nëse kërkesa është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 123 të këtij ligji. Nëse pas shqyrtimit të përgjithshëm të dokumenteve konstaton paaftësinë paguese të pashmangshme të debitorit në mënyrë të justifikuar, gjykata e falimentimit deklaron menjëherë fillimin e procedurës së riorganizimit të përshpejtuar.

2. Vendimi për fillimin e procedurës së riorganizimit të përshpejtuar përfshin:

a) identifikimin e debitorit, sipas parashikimeve të nenit 29 të këtij ligji;

b) caktimin e një administratori mbikëqyrës, sipas parashikimeve të nenit 29, të këtij ligji, si dhe një adresë për komunikimin me kreditorët dhe për t'i komunikuar veprime të tjera të rregulluara në këtë kre;

c) kërkesën ndaj çdo personi që pretendon të jetë kreditor i debitorit për të paraqitur pretendimin e tyre brenda 30 ditëve nga data e publikimit të vendimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare, si dhe në adresën e dhënë nga administratori mbikëqyrës;

ç) paralajmërimin për kreditorët që, brenda 7 ditëve nga momenti i depozitimit të listës së kreditorëve në gjykatën e falimentimit, të paraqesin kundërshtimet lidhur me të;

d) informacionin se është propozuar një plan riorganizimi i përshpejtuar, i cili është në dispozicion të kreditorëve për t'u njohur me të;

dh) dhënien e informacionit që nga momenti i publikimit të vendimit, për t'u bërë të ditur kreditorëve të drejtën që të shprehin mbështetjen e tyre për planin e propozuar;

e) caktimin e një mbledhjeje të kreditorëve për një datë që nuk mund të jetë më vonë se 45 ditë nga momenti i publikimit të vendimit.

3. Kundër vendimit për fillimin e procedurës së përshpejtuar të riorganizimit mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga data e shpalljes. Ankimi nuk pezullon zbatueshmërinë e planit të

riorganizimit, përveçse kur gjykata e apelit vendos ndryshe, mbështetur në shkaqe që cenojnë rëndë interesat e kreditorëve ose interesat publikë.

Neni 125

**Efektet e riorganizimit të përshpejtuar te debitori**

1. Fillimi i procedurës së përshpejtuar të riorganizimit nuk ndikon në mundësinë e debitorit për të administruar dhe vendosur për pasuritë e tij në rrjedhën normale të veprimtarisë të tij.

2. Çdo veprim i administrimit të jashtëzakonshëm ose çdo veprim jashtë veprimtarisë së zakonshme tregtare miratohet nga administratori mbikëqyrës.

Neni 126

**Efektet e riorganizimit të përshpejtuar te kreditorët dhe kontratat**

1. Fillimi i procedurës së riorganizimit të përshpejtuar pezullon të gjitha ekzekutimet mbi pasuritë e debitorit që janë të nevojshme për vazhdimin e veprimtarisë tregtare. Kontratat ekzistuese mund të vijojnë të zbatohen dhe kontrata të reja mund të lidhen, por asnjë pronë e debitorit nuk mund të shtohet ose të hiqet gjatë procedurës.

2. Fillimi i procedurës së riorganizimit të përshpejtuar nuk pezullon akumulimin e interesave.

3. Kontratat ekzistuese që vijojnë të zbatohen nuk ndikohen nga fillimi i procedurës së riorganizimit të përshpejtuar.

Neni 127

**Informacioni mbi planin e riorganizimit të përshpejtuar**

1. Kreditorët mund të vihen në dijeni të përmbajtjes së planit të riorganizimit të përshpejtuar në adresën që i kanë dhënë administratorit mbikëqyrës.

2. Administratori mbikëqyrës jep informacion për planin e riorganizimit të përshpejtuar vetëm kur ka të dhëna objektive që personi që e ka kërkuar këtë informacion ka një pretendim të bazuar ndaj debitorit. Në çdo rast, personit të cilit i njoftohet plani, i kërkohet të nënshkruajë një marrëveshje konfidencialiteti kundrejt paraqitjes së një dokumenti identifikimi.

Neni 128

**Raportimi mbi planin e riorganizimit të përshpejtuar**

1. Administratori mbikëqyrës harton dhe depoziton në gjykatën e falimentimit një raport të ndërmjetëm për përmbajtjen e planit të riorganizimit të përshpejtuar brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së detyrës.

2. Raporti përfshin një vlerësim fillestar të shkaqeve që çuan në vështirësitë financiare të debitorit, si edhe një opinion mbi qëndrueshmërinë e veprimtarisë tregtare në rast se plani i riorganizimit të përshpejtuar miratohet.

3. Raporti përfundimtar për planin e riorganizimit të përshpejtuar depozitohet në gjykatën e falimentimit jo më vonë se 1 javë përpara mbajtjes së mbledhjes së kreditorëve që vendos për këtë plan.

4. Për hartimin e raportit, administratori mbikëqyrës mund të kërkojë nga debitori çdo informacion dhe sqarim që gjykon të arsyeshëm. Administratori mund të kërkojë informacion edhe nga kreditorët që fillimisht mbështetën planin.

5. Nëse është e nevojshme, administratori mbikëqyrës mund t’i kërkojë gjykatës së falimentimit të caktojë një ekspert. Kërkesa duhet të jetë e arsyetuar dhe të identifikojë elementet e sakta të analizës që i kërkohet ekspertit.

Neni 129

**Shprehjet e mbështetjes për planin e riorganizimit të përshpejtuar**

1. Kreditorët mund të mbështetin formalisht planin e riorganizimit të përshpejtuar, në çdo kohë, nga fillimi i kësaj procedure deri 3 ditë para mbajtjes së mbledhjes.

2. Mbështetja për planin mund të realizohet me anë të një deklarate noteriale ose me anë të një deklarate me shkrim ose verbalisht, të bëra para sekretarit të gjykatës së falimentimit.

Neni 130

**Lista e kreditorëve në procedurën e riorganizimit të përshpejtuar**

1. Hartimi i listës së kreditorëve u nënshtrohet rregullave të përgjithshme në rastin e procedurës së riorganizimit të përshpejtuar, për aq kohë sa nuk rregullohet shprehimisht në këtë nen.

2. Administratori mbikëqyrës ka 5 ditë kohë për të përfunduar listën e kreditorëve, duke filluar numërimin nga dita e fundit e verifikimit të pretendimeve të paraqitura. Lista depozitohet në gjykatën e falimentimit dhe bëhet publike në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe përmes shpalljes në gjykatë.

3. Brenda 15 ditëve nga data e publikimit të vendimit për fillimin e procedurës së riorganizimit të përshpejtuar, çdo kreditor mund të kundërshtojë tek administratori mbikëqyrës në lidhje me pretendimet që kanë mbështetur propozimin në kërkesën e debitorit. Administratori mund të marrë në konsideratë kundërshtimet gjatë mbikëqyrjes së tij lidhur me vërtetësinë dhe vlefshmërinë e pretendimeve në fjalë.

4. Brenda 7 ditëve nga depozitimi i listës, debitori dhe kreditorët e tij kanë të drejtë të kundërshtojnë listën e kreditorëve. Kundërshtimi mund t’i referohet përfshirjes ose mospërfshirjes së një pretendimi për vlerën ose për klasifikimin e pretendimit.

5. Kundërshtimet ndaj listës së kreditorëve zgjidhen sipas procedurës së përgjithshme të këtij ligji. Në çdo rast, këto kundërshtime nuk pezullojnë procedurën e riorganizimit të përshpejtuar.

Neni 131

**Mbledhja e votimit të planit të riorganizimit të përshpejtuar**

1. Mbledhja e votimit të planit të riorganizimit të përshpejtuar kryesohet nga gjykata e falimentimit dhe administratori mbikëqyrës vepron si sekretar. Në këtë rast nuk lejohet delegimi.

2. Lista e kreditorëve shërben si bazë për listën e pjesëmarrësve në mbledhjen e votimit të planit të riorganizimit të përshpejtuar. Administratori mbikëqyrës reflekton në listë ato pretendime që janë kundërshtuar. Pretendimet e kundërshtuara trajtohen si të kushtëzuara dhe nuk numërohen për formimin e kuorumit dhe as për qëllime votimi. Gjykata e falimentimit mund të lejojë përfshirjen paraprake të pretendimit të kundërshtuar dhe të efekteve të tij, kur ka elemente objektive që vërtetojnë vlefshmërinë. Nëse vota e pretendimit në fjalë rezulton të jetë vendimtare në rezultatin përfundimtar, miratimi ose refuzimi konsiderohet si i ndërmjetëm dhe do të jetë objekt i vendimit përfundimtar mbi pretendimin e kundërshtuar.

3. Për llogaritjen e kuorumit, administratori mbikëqyrës përfshin pretendimet që kanë mbështetur planin e riorganizimit të përshpejtuar gjatë kërkesës së debitorit dhe të gjitha pretendimet e tjera që kanë mbështetur më pas këtë plan.

4. Formimi i klasave dhe llogaritja e shumicës për miratimin e planit të riorganizimit të përshpejtuar do të jenë të njëjta si ato të parashikuara për planin e riorganizimit.

5. Kreditorët e përmendur në pikën 4, të këtij neni, konsiderohen se kanë votuar në favor të planit, përveçse kur marrin pjesë në mbledhjen e votimit të planit të riorganizimit të përshpejtuar dhe votojnë ndryshe.

6. Për çdo aspekt që nuk është parashikuar në këtë nen, ligjshmëria dhe finalizimi i mbledhjes së votimit të planit të riorganizimit të përshpejtuar rregullohen në përputhje me nenin 104 të këtij ligji.

Neni 132

**Miratimi i planit të riorganizimit të përshpejtuar**

1. Vendimi për të miratuar planin e riorganizimit të përshpejtuar bazohet në dispozitat e kreut II të kësaj pjese.

2. Në rastin e kundërshtimit të një pretendimi, siç është parashikuar në pikën 2, të nenit 131, të këtij ligji, kundërshtuesit nuk i duhet të paraqesë kundërshtimin ndaj planit të riorganizimit të përshpejtuar, duke u bazuar vetëm në shkelje të shumicës së kërkuar.

Neni 133

**Efektet e miratimit të planit të riorganizimit të përshpejtuar**

E drejta e debitorit për të disponuar dhe administruar pasuritë e tij, vazhdimi i detyrës së administratorit mbikëqyrës ose çështje të tjera, në lidhje me zbatimin e planit dhe mbikëqyrjen e tij, rregullohen në përmbajtjen e planit.

Neni 134

**Efektet e refuzimit të planit të riorganizimit të përshpejtuar**

1. Nëse plani i riorganizimit të përshpejtuar nuk miratohet, gjykata e falimentimit shpall fillimin e procedurës së zakonshme të falimentimit, përveçse nëse debitori provon se ai nuk është në gjendjen e paaftësisë paguese dhe gjendja e pashmangshme e paaftësisë paguese nuk ekziston më.

2. Administratori mbikëqyrës vazhdon detyrën, përveç rastit kur ekzistojnë arsye objektive për të kundërtën.

3. Gjatë procedurës së zakonshme të falimentimit, debitori vazhdon të kryejë veprimtarinë e zakonshme tregtare, objekt i kufizimeve të parashikuara në nenet 60 e 61 të këtij ligji. Gjykata e falimentimit, kryesisht ose me kërkesë të administratorit mbikëqyrës ose kreditorit, mund t'ia heqë debitorit të drejtën e administrimit të veprimtarisë tregtare, nëse vlerëson se rrethanat e kërkojnë.

4. Në lidhje me efektet mbi pretendimet dhe kontratat zbatohen rregullat e përgjithshme.

PJESA E GJASHTË LIKUIDIMI DHE SHPËRNDARJA

KREU I

LIKUDIMI DHE SHPËRNDARJA RREGULLA TË PËRGJITHSHME TË LIKUIDIMIT

Neni 135

**Fillimi i likuidimit**

1. Debitori mund të kërkojë fillimin e likuidimit në çdo moment gjatë procedurës së falimentimit.

2. Debitori duhet të paraqesë kërkesë për fillimin e likuidimit menjëherë pasi konstaton se plani i riorganizimit nuk mund të realizohet. Mosparaqitja e kërkesës sjell të njëjtat pasoja si ato të kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit, sipas nenit 15 të këtij ligji.

3. Në rastet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, gjykata e falimentimit dëgjon administratorin e falimentimit ose atë mbikëqyrës dhe komitetin e kreditorëve, nëse ka një të tillë, para miratimit të vendimit.

4. Në rast se veprimtaria tregtare është ndërprerë, administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës mund të kërkojë fillimin e likuidimit. Para miratimit të vendimit, debitori dëgjohet nga gjykata e falimentimit.

Neni 136

**Efektet e fillimit të likuidimit**

1. Fillimi i likuidimit sjell si pasojë heqjen e mundësisë së debitorit për të administruar dhe disponuar pasurinë e tij, si dhe emërimin e administratorit të falimentimit. Nëse gjykata e falimentimit vendos kështu, administrator falimentimi është personi i emëruar më parë si administrator mbikëqyrës.

2. Të gjitha borxhet dhe detyrimet që i nënshtrohen një afati konsiderohen automatikisht të maturuara.

Neni 137

**Rregulla të përgjithshme për veprimet e likuidimit të pasurisë**

1. Veprimtaria tregtare transferohet duke ruajtur vazhdimësinë, sipas rastit, në tërësi ose në njësi të veçanta, për aq sa është e mundur.

2. Në rast të transferimit të veprimtarisë tregtare në tërësi ose të njësive, kontratat në të cilat debitori është palë transferohen së bashku me veprimtarinë, pa pasur nevojë për pëlqimin e palës tjetër kontraktore. Edhe transferimi i licencave dhe lejeve administrative bëhet pa ndonjë veprim ose pëlqim të mëtejshëm, për sa kohë që nuk parashikohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi.

3. Në rast të likuidimit me pjesë, shitja e pasurive kryhet me ankand, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile.

4. Kalimi i pasurive të veçanta, në vend të pagesës së një ose më shumë kreditorëve, lejohet me autorizimin e gjykatës së falimentimit.

5. Në çdo rast, blerja e veprimtarisë tregtare në tërësi, e njësive ose e pasurive vetjake nga persona të lidhur me debitorin bëhet me autorizim nga gjykata e falimentimit.

Neni 138

**Plani i likuidimit**

1. Likuidimi i masës së falimentimit bëhet në përputhje me planin e likuidimit.

2. Plani i likuidimit hartohet nga administratori i falimentimit brenda 20 ditëve nga dita kur mbledhja ka vendosur për likuidimin e debitorit.

3. Plani i likuidimit depozitohet për konsultim në gjykatën e falimentimit. Debitori, kreditorët e tij dhe punonjësit e debitorit mund të paraqesin komente dhe vërejtje për planin e likuidimit, brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të tij në gjykatën e falimentimit.

4. Administratori i falimentimit mund të marrë në konsideratë brenda 5 ditëve, komentet dhe vërejtjet dhe të riformulojë planin e likuidimit tërësisht ose pjesërisht, ose mund ta lërë atë të pandryshuar. Gjykata e falimentimit vendos mbi përmbajtjen përfundimtare të planit të likuidimit brenda 5 ditëve pas dorëzimit përfundimtar të tij.

Neni 139

**Pagesa e kreditorëve të falimentimit**

1. Pagesa e kreditorëve të falimentimit mund të fillohet vetëm pasi lista e kreditorëve është bërë përfundimtare dhe mbledhja e raportimit, e parashikuar në pikën 1, të nenit 93, të këtij ligji, ka vendosur likuidimin e debitorit.

2. Përjashtimisht, administratori i falimentimit mund të ngrejë një fond rezervë me një shumë të mjaftueshme për të paguar pretendime të caktuara, të regjistruara me vonesë nga kreditori, objekt i përfshirjes në listën përfundimtare të kreditorëve në kohën e ndonjë shpërndarjeje të propozuar.

3. Fondet mund të shpërndahen mes kreditorëve të falimentimit ose bëhen të disponueshme fonde të mjaftueshme. Shpërndarjet duhet të kryhen nga administratori i falimentimit sipas radhës së përparësive të parashikuara në këtë ligj.

4. Para çdo shpërndarjeje, administratori i falimentimit duhet të marrë pëlqimin e gjykatës së falimentimit.

Neni 140

**Koha për zbatimin e planit**

1. Plani i likuidimit ekzekutohet brenda 3 muajve nga fillimi i likuidimit.
2. Në raste të veçanta, gjykata e falimentimit mund të zgjatë procesin me 3 muaj të tjerë nëse administratori i falimentimit jep shpjegime objektive dhe të mjaftueshme.
3. Çdo 2 muaj, administratori i falimentimit harton dhe vë në dispozicion të palëve një raport mbi ecurinë e likuidimit.
4. Gjykata e falimentimit, në varësi të mospërmbushjes së detyrimeve dhe afateve të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni, vendos heqjen e plotë ose të pjesshme të shpërblimit për administratorin e falimentimit ose kthimin e shpërblimeve të marra.

KREU II

SHLYERJA E KREDITORËVE TË SIGURUAR Neni 141

**E drejta për të disponuar pasurinë**

1. Administratori i falimentimit ose debitori, me autorizimin e administratorit mbikëqyrës, ka të drejtë të disponojë çdo pasuri që është objekt i një të drejte të siguruar, në qoftë se vlera e kolateralit është më e madhe se shuma që i detyrohet kreditorit të siguruar, së bashku me shpenzimet e bëra për ekzekutimin e tij.
2. Nëse vlera e kolateralit është më e vogël ose e barabartë me totalin e vlerës së kredisë së pretenduar nga kreditori i siguruar dhe shpenzimet e bëra për ekzekutimin e saj, administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës, rast pas rasti, vendos nëse do të lejojë që kreditori i siguruar të ushtrojë të drejtën për ta ndarë objektin në përputhje me këtë ligj.
3. Përpara se administratori i falimentimit të shesë një pasuri në posedim të tij te një palë e tretë, ai njofton kreditorin e siguruar për shitjen e propozuar. Kreditorit të siguruar i jepet jo më pak se 1 javë kohë përpara datës së shitjes për të propozuar një mënyrë alternative më të favorshme për shitjen e pasurisë, përfshirë dhe shitjen e pasurisë nga vetë kreditori.
4. Në përputhje me pikat 1 dhe 2, të këtij neni, pas periudhës 6-mujore të pezullimit, të parashikuar në nenin 69, të këtij ligji, kreditori i siguruar mund të fillojë ose të vazhdojë ekzekutimin. Nga fillimi i procedurës së falimentimit ose në vijim të saj, nëse kolaterali nuk është i nevojshëm për vazhdimin e veprimtarisë tregtare ose profesionale, kreditori i siguruar mund të kërkojë ekzekutimin e garancisë. Nëse administratori nuk fillon ekzekutimin brenda
15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, gjykata e falimentimit mund të shkarkojë administratorin ose të vendosë një sanksion ndaj tij.
5. Nëse pas periudhës 6-mujore të pezullimit të ekzekutimeve të parashikuara në nenin 69, të këtij ligji, kur kreditori i siguruar fillon ose vazhdon ekzekutimin e pasurisë së siguruar, administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës mund të kërkojë që pasuria, e cila është objekt i së drejtës së siguruar, të mund të mbahet, me qëllim shitjen e mëvonshme të saj ose ruajtjen e saj për vazhdimësinë e veprimtarisë tregtare. Në këtë rast, administratori i paguan kreditorit të siguruar vlerën e pasurisë së llogaritur në inventar, pasi të ketë zbritur kostot e parashikuara të ekzekutimit.

Neni 142

**Mbrojtja e kreditorit të siguruar nga shitja e vonuar**

1. Nëse gjykata e falimentimit ka marrë një masë të përkohshme, sipas nenit 22, të këtij ligji, duke i ndaluar çdo kreditori të siguruar për të shitur një pasuri përpara fillimit të procedurës së falimentimit, i paguhet kreditorit çdo interes i akumuluar mbi vlerën e borxhit, që i detyrohet kreditorit ,

duke filluar që nga data e kërkesës, por jo më pak se 3 muaj pas fillimit të procedurës së falimentimit. Kjo dispozitë nuk zbatohet nëse shuma dhe vlera e pretendimit të kreditorit dhe çdo detyrim tjetër në bazë të vlerës së pasurisë nuk mund të mbulohen nga të ardhurat e përfituara nga shitja për shlyerjen e kreditorëve.

2. Në çdo kohë përgjatë periudhës 3-mujore, gjykata e falimentimit heq kufizimet dhe urdhëron masa të tjera të sigurisë në qoftë se kreditori i siguruar provon se vlera e kolateralit nuk po mbrohet në mënyrën e duhur.

Neni 143

**Shpërndarja e të ardhurave**

1. Kur një pasuri, objekt i një të drejte të siguruar, është shitur për shkak kësaj të drejte, të ardhurat nga shitja, pasi janë zbritur kostot e shkaktuara prej shitjes së pasurisë, përdoren pa vonesë për të shlyer nevojat e kreditorit të siguruar.

2. Nëse administratori i falimentimit i transferon kreditorit të siguruar një pasuri, të cilën administratori ka të drejtë ta shesë, sipas nenit 141, të këtij ligji, me qëllim që pasuria të shitet nga kreditori i siguruar, ky i fundit i parapaguan administratorit të falimentimit kostot e vlerësuara të shitjes dhe, nëse është rasti, detyrimet fiskale paguhen nga të ardhurat e shitjes së pasurisë.

KREU III

RADHA E PRETENDIMEVE NË LIKUIDIM DHE SHPËRNDARJE Neni 144

**Radha e përparësive në shpërndarje**

1. Pas përmbushjes së detyrimeve në përputhje me këtë ligj, në të gjitha rastet e likuidimit procedura vazhdon me përmbushjen e pretendimeve të kreditorëve sipas kësaj radhe:

a) pretendimet e siguruara deri në vlerën e pronës që shërben si kolateral;

b) pretendimet e kreditorëve të preferuar, sipas nenit 38, të këtij ligji;

c) pretendimet e kreditorëve të pasiguruar;

ç) pretendimet e kreditorëve fundorë, sipas nenit 40, të këtij ligji;

d) pretendimet e anëtarëve të shoqërisë së thjeshtë, aksionarëve dhe ortakëve të shoqërive tregtare, në cilësinë e tyre si të tillë.

2. Pagesa e kreditorëve të procedurës së falimentimit kryhet pasi pretendimet të jenë maturuar. Pagesa e kreditorëve të falimentimit bëhet duke marrë parasysh nevojën për të paguar në radhë të parë kreditorët e procedurës së falimentimit. Në rast dyshimi, administratori i falimentimit ndan një shumë monetare përpara se të fillojë pagesën e kreditorëve të përmendur në pikën 1 të këtij neni.

Neni 145

**Rregulli i përparësisë absolute**

1. Pretendimet paguhen sipas radhës së përparësisë, në përputhje me nenin 144 të këtij ligji.

2. Pagesa e pretendimeve të kreditorëve të një radhe përparësie më të ulët mund të bëhet vetëm pas pagesës në mënyrë të plotë të pretendimeve të të gjithë kreditorëve të një radhe me përparësi më të lartë.

3. Brenda çdo radhe, pagesat e çdo nënndarjeje bëhen vetëm pasi nënndarja më e lartë është paguar plotësisht.

4. Kur burimet janë të pamjaftueshme për të përmbushur plotësisht të gjitha pretendimet e një nënndarjeje, pretendimet e kësaj nënndarjeje plotësohen në mënyrë proporcionale.

Neni 146

**Lista e shpërndarjes**

Përpara çdo shpërndarjeje, administratori i falimentimit përgatit një listë të pretendimeve e të vlerave të tyre, të cilat duhet të shqyrtohen për t'u shpërndarë, si dhe vlerën e disponueshme për shpërndarje nga masa e falimentimit. Lista tregon se sa do të shpërndahet për secilin kreditor. Lista depozitohet në regjistrin e gjykatës së falimentimit për t'u kontrolluar prej palëve.

Neni 147

**Fondet e mbajtura për shlyerjen e kreditorëve të siguruar**

1. Kreditori i siguruar trajtohet si një kreditor i pasiguruar për çdo pjesë të pretendimit të tij të siguruar që nuk përmbushet nga të ardhurat që rezultojnë nga zbatimi i të drejtave të siguruara të tij. Nëse kreditori i siguruar heq dorë nga e drejta e siguruar e tij, ai trajtohet si një kreditor i pasiguruar.

2. Nëse në kohën e shpërndarjes së parë vetëm administratori i falimentimit ka të drejtë të disponojë një pasuri, objekt i një të drejte të siguruar, dhe administratori nuk e ka disponuar ende pasurinë, administratori i falimentimit vlerëson shkallën e humbjes së kreditorit të siguruar, nëse ka, dhe duhet të mbajë fonde të mjaftueshme për të mbuluar një pretendim të tillë.

Neni 148

**Fondet e mbajtura për të plotësuar pretendimet e kushtëzuara**

1. Pretendimet, objekt i një detyrimi me kusht ose objekt i një çështjeje në gjykim e sipër, vlerësohen për vlerën e plotë gjatë shpërndarjes së parë. Fondet që mbulojnë këtë pretendim nuk paguhen gjatë shpërndarjes dhe mbahen.

2. Pretendimet, objekt i një detyrimi me kusht, nuk llogariten gjatë shpërndarjes përfundimtare nëse mundësia e përmbushjes së kushtit ose zgjidhjes së çështjes gjyqësore është aq e largët ose e pamundur, saqë pretendimi është i pavlerë në datën e shpërndarjes. Në një rast të tillë, fondet mbahen në përputhje me pikën 1, të këtij neni, dhe, nëse kushti është realizuar, shpërndahen gjatë shpërndarjes përfundimtare.

Neni 149

**Kundërshtimet kundrejt listës së shpërndarjes**

1. Kreditorët e falimentimit mund të kundërshtojnë listën e shpërndarjes vetëm kur lista është në kundërshtim me ligjin.

2. Kreditorët e falimentimit paraqesin kundërshtimet ndaj listës së shpërndarjes në gjykatën e falimentimit të paktën 1 javë para se të fillojë shpërndarja e parë. Çdo vendim që refuzon një kundërshtim i bëhet me dije kreditorit dhe administratorit të falimentimit.

3. Çdo vendim që urdhëron një ndryshim në listën e shpërndarjes dërgohet te kreditori, administratori dhe depozitohet në regjistrin e gjykatës së falimentimit për t'u kontrolluar nga palët.

Neni 150

**Përcaktimi i pjesëve të pretendimit**

Administratori i falimentimit, në konsultim me komitetin e kreditorëve, përcakton pjesët e pretendimeve të kreditorëve për t'u paguar në shpërndarjen e parë dhe në ato vijuese.

Neni 151

**Shpërndarja përfundimtare**

1. Shpërndarja përfundimtare bëhet me miratimin e gjykatës së falimentimit pasi masa e falimentimit të jetë shitur.

2. Administratori i falimentimit paraqet llogaritë e tij pas shpërndarjes përfundimtare në mënyrën e përcaktuar në nenin 49 të këtij ligji.

Neni 152

**Teprica pas shpërndarjes përfundimtare**

1. Në qoftë se pretendimet e të gjithë kreditorëve të falimentimit janë paguar në mënyrë të plotë, si pasojë e shpërndarjes përfundimtare, administratori i falimentimit transferon çdo tepricë të mbetur te debitori.

2. Në qoftë se debitori nuk është person fizik, administratori i falimentimit ndan pjesën e mbetur mes çdo personi që është pjesëmarrës në kapitalin e debitorit, përveçse kur, në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi, aksionarët, ortakët ose anëtarët miratojnë një vendim për riaktivizimin e shoqërisë.

KREU IV

PËRFUNDIMI I PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

Neni 153

**Përfundimi i procedurës së falimentimit**

1. Pasi ka përfunduar shpërndarja përfundimtare, gjykata e falimentimit vendos përfundimin e procedurës së falimentimit.

2. Pagesa e plotë për të gjithë kreditorët e falimentimit në çdo fazë të procedurës është një shkak për përfundimin e procedurës.

3. Vendimi i gjykatës dhe arsyet e përfundimit shpallen publikisht.

4. Në rastin e personave juridikë, kur të gjithë kreditorët shlyhen plotësisht, atëherë shpërndarja e plotë e të ardhurave pas likuidimit të pasurisë sjell prishjen e personit juridik. Në këtë rast, administratori i falimentimit dërgon vendimin e gjykatës së falimentimit në regjistrat përkatës, në mënyrë që të fshijë debitorin nga këta regjistra.

5. Në rastin e personave fizikë, zbatohen dispozitat e pjesës së shtatë të këtij ligji.

Neni 154

**Rifillimi i procedurës së falimentimit**

1. Nëse në çdo kohë brenda një viti nga përfundimi i procedurës së falimentimit, zbulohen pasuri të reja që i përkasin debitorit ose pretendime të mundshme për shmangie veprimesh ose identifikohen përgjegjësi të organeve drejtuese, çdo kreditor mund të kërkojë rifillimin e çështjes së falimentimit.

2. Rifillimi bëhet pavarësisht nga fshirja dhe heqja e debitorit nga regjistrat e shoqërive tregtare. Shoqëria do të duhet të riaktivizohet, me qëllimin e vetëm që të rifillohen procedurat.

3. Gjykata e falimentimit vendos për rifillimin e çështjes vetëm kur pasuritë ose shkaqet e veprimit që janë identifikuar janë ose mund të jenë objektivisht të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e procedurës dhe për të siguruar të ardhura shtesë për të paktën 5 për qind për kreditorët e nivelit më të lartë.

4. Procedurat e rifilluara do të jenë vetëm procedura likuidimi. Qëllimi i tyre i vetëm është marrja e pasurive, kryerja e veprimeve juridike, ngritja e padive, likuidimi i pasurive dhe shpërndarja e të ardhurave mes kreditorëve.

5. Gjykata e falimentimit cakton të njëjtin administrator falimentimi, i cili harton një listë të re të shpërndarjes, bazuar në listën e fundit të shpërndarjes, përveç rasteve kur ka arsye objektive për të vendosur ndryshe.

PJESA E SHTATË

SHKARKIMI NGA DETYRIMET E MBETURA TË DEBITORËVE INDIVIDË

Neni 155

**Parimi**

Nëse debitori është person fizik, ai mund të shkarkohet nga detyrimet e mbetura ndaj kreditorëve të falimentimit, në përputhje me dispozitat e kësaj pjese.

Neni 156

**Kërkesa e debitorit për shkarkimin nga detyrimet e mbetura**

1. Shkarkimi nga detyrimet e mbetura fillohet përmes një kërkese me shkrim të debitorit, e cila paraqitet në gjykatën e falimentimit në çdo kohë gjatë procedurës së likuidimit. Kjo kërkesë mund t'i bashkëngjitet kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit.

2. Kërkesa për shkarkimin nga detyrimet e mbetura së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit nënkupton njëkohësisht kërkesën për likuidimin e pasurisë. Në këtë rast, administratori i falimentimit përpilon listën e kreditorëve, harton inventarin dhe raportin, siç përcaktohet në këtë ligj. Pasi të përfundojë ose në çdo kohë më herët, por me miratimin e gjykatës së falimentimit, në qoftë se është e përshtatshme për likuidim, likuidimi i pasurive dhe ndarja e procedurave kryhen në përputhje me përcaktimin e pikës 1 të këtij neni.

3. Kërkesa për shkarkimin nga detyrimet e mbetura shoqërohet me një deklaratë që vërteton vullnetin e debitorit për të kaluar çdo shumë përtej limiteve të kostos së jetesës te një kujdestar i emëruar nga gjykata e falimentimit, me propozim të debitorit. Nëse debitori ia ka ngarkuar këto të drejta një pale të tretë, ai e shpreh këtë në deklaratën e tij.

4. Çdo marrëveshje, që përjashton, kushtëzon ose ndalon debitorin nga marrja e pagesave të mësipërme, është e pavlefshme.

Neni 157

**Vendimi i gjykatës së falimentimit për shkarkimin nga detyrimet e mbetura**

1. Përpara marrjes së vendimit për shkarkimin nga detyrimet e mbetura, gjykata e falimentimit cakton një periudhë prej 20 ditësh që kreditorët të parashtrojnë ndonjë kërkesë ose kundërshtim për shkarkimin nga detyrimet e mbetura. Administratori i falimentimit duhet të paraqesë me shkrim mendimin e tij lidhur me kundërshtimin e shkarkimit nga detyrimet e mbetura, përfshirë edhe një propozim që shkarkimi të refuzohet nëse nuk janë përmbushur kriteret.

2. Nëse nuk ka arsye për refuzimin e një kërkese të tillë, gjykata e falimentimit miraton shkarkimin nga detyrimet e mbetura. Çdo kreditor ose administrator i falimentimit, i cili nuk e ka pranuar shkarkimin e detyrimeve të mbetura në mbledhjen e fundit, mund të paraqesë ankim të veçantë kundër këtij vendimi.

3. Në të njëjtën kohë, gjykata e falimentimit cakton një kujdestar, të cilit i transferohet teprica e të ardhurave të debitorit, sipas deklaratës së debitorit. Administratori i falimentimit mund të caktohet si kujdestar nëse kështu vendos gjykata e falimentimit.

4. Vendimi për shkarkimin nga detyrimet e mbetura shpallet publikisht në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Agjencinë Kombëtare të Falimentimit.

Neni 158

**Refuzimi i shkarkimit nga detyrimet e mbetura**

1. Gjykata e falimentimit refuzon shkarkimin nga detyrimet e mbetura kur:

a) debitori është dënuar për vepër penale me një vendim të formës së prerë, sipas dispozitave të Kodit Penal;

b) debitori, në 3 vitet e fundit nga data e dorëzimit të kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit ose pas kësaj kërkese, qëllimisht ose nga pakujdesia, ka dhënë një deklaratë të rreme ose të paplotë me shkrim në lidhje me gjendjen e tij financiare, në mënyrë që të përfitojë një kredi, grante nga fondet publike ose të shmangë pagesat në favor të fondeve publike;

c) debitori është shkarkuar nga detyrimet e mbetura në 10 vitet e fundit që nga data e dorëzimit të kërkesës dhe ky shkarkim nga detyrimet është revokuar;

ç) debitori, në vitin e fundit që nga data e kërkesës për shkarkimin nga detyrimet e mbetura ose pas kësaj kërkese, me dashje ose nga pakujdesia, ka dëmtuar shlyerjen e kreditorëve të falimentimit, duke krijuar detyrime të panevojshme përmes keqpërdorimit të pasurive ose duke vonuar fillimin e procedurës së falimentimit ose duke ulur mundësitë për të përmirësuar gjendjen e tij financiare;

d) debitori, me dashje ose nga pakujdesia, ka shkelur detyrimet e tij për të vënë në dispozicion informacionin ose për të bashkëpunuar gjatë procedurës së falimentimit; ose

dh) debitori ka bërë, me dashje ose nga pakujdesia, deklarata të rreme ose të paplota në përpilimin e listës që kërkohet për të paraqitur pasuritë dhe të ardhurat e tij, kreditorët e tij dhe pretendimet ndaj tij.

2. Kërkesa e një kreditori për refuzimin e shkarkimit të detyrimeve të mbetura pranohet vetëm nëse paraqitet një arsye bindëse në gjykatën e falimentimit për refuzimin e shkarkimit nga detyrimet e mbetura.

Neni 159

**Statusi ligjor i kujdestarit**

1. Kujdestari ka për detyrë të njoftojë statusin e tij te debitori i debitorit ose te ndonjë person tjetër që është i detyruar të bëjë pagesën ndaj debitorit. Kujdestari duhet të mbajë në një llogari të veçantë të gjitha shumat e marra gjatë kryerjes së detyrave të tij, së bashku me pagesat e tjera të kryera nga debitori ose palët e treta, dhe t'i shpërndajë këto fonde mbi baza vjetore te kreditorët e falimentimit, siç udhëzohet në listën përfundimtare.

2. Kujdestari caktohet për një periudhë prej 5 vitesh pasi merret vendimi nga gjykata e falimentimit për të shkarkuar nga detyrimet e mbetura të debitorit, përveçse nëse gjykata e falimentimit vendos ndryshe.

3. Gjykata e falimentimit mund të ngarkojë kujdestarin për të mbikëqyrur përmbushjen e detyrimeve të debitorit, me kërkesë të administratorit të falimentimit ose të kreditorëve të falimentimit. Në një rast të tillë, nëse kujdestari vihet në dijeni për ndonjë shkelje të këtyre detyrimeve, ai duhet të informojë menjëherë kreditorët dhe gjykatën e falimentimit. Kujdestari detyrohet të kryejë mbikëqyrjen vetëm nëse është marrë pagesa, lidhur me këtë çështje.

4. Kujdestari i raporton gjykatës së falimentimit, me përfundimin e detyrës së tij.

Neni 160

**Shpërblimi i kujdestarit**

1. Kujdestari ka të drejtë të shpërblehet për kryerjen e detyrave të tij dhe të rimbursohet për shpenzime të përshtatshme. Ky shpërblim përfshin kohën dhe qëllimin e veprimtarisë së kujdestarit.

2. Kriteret dhe përllogaritja e shpërblimit të kujdestarit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 161

## Trajtimi i barabartë i kreditorëve

1. Ekzekutimi mbi pasuritë e debitorit në favor të një kreditori të veçantë të falimentimit nuk mund të kryhet gjatë periudhës kur debitori ka caktuar kujdestarin.

2. Çdo marrëveshje ndërmjet debitorit dhe çdo personi tjetër, veçanërisht me kreditorët e falimentimit, që siguron përfitime disproporcionale për kreditorët e falimentimit, është e pavlefshme.

3. Kujdestari mund të ngrejë të njëjtin pretendim kundër debitorit për kompensimin e pagesave.

Neni 162

## Detyrimet e debitorit

1. Gjatë periudhës së caktimit të kujdestarit, debitori pranon të veprojë në përputhje me rregullat në vijim:

a) të kryejë veprimtari të përshtatshme me qëllime fitimi ose të kërkojë të punësohet dhe, nëse është i papunë, të mos refuzojë një punësim të arsyeshëm;

b) t'i transferojë kujdestarit gjysmën e vlerës të pasurisë së fituar nga ai me anë të trashëgimisë ose në lidhje me të drejtat e ardhshme që rrjedhin nga trashëgimia;

c) të njoftojë në kohë kujdestarin për çdo ndryshim të vendbanimit ose të vendit të punës, të mos fshehë të ardhurat ose pasuritë e tjera dhe të informojë gjykatën e falimentimit dhe kujdestarin, me kërkesën e tyre, për çdo të ardhur nga punësimi ose për përpjekjet e bëra për të gjetur punë, si dhe çdo të ardhur të realizuar nga pasuritë e tij;

ç) të bëjë pagesat për kreditorët e falimentimit vetëm nëpërmjet kujdestarit dhe jo duke i siguruar ndonjë avantazh ndonjë kreditori.

2. Nëse debitori është i vetëpunësuar, ai duhet t'i paguajë kreditorët e falimentimit përmes kujdestarit të tij sikur të ishte në një kontratë të rregullt shërbimi.

Neni 163

## Revokimi i shkarkimit nga detyrimet e mbetura për shkak të shkeljes së detyrimeve të debitorit

1. Kur debitori, gjatë caktimit të kujdestarit, shkel një prej detyrimeve të veta dhe për pasojë pengon përmbushjen e detyrimeve të kreditorëve të falimentimit, atëherë, me kërkesë të një kreditori falimentimi ose të kujdestarit, gjykata e falimentimit revokon vendimin për shkarkimin nga detyrimet e mbetura. Kërkesa e kreditorit mund të paraqitet brenda 1 viti nga koha kur kreditori vihet në dijeni të shkeljes, por, në çdo rast, jo më vonë se 6 vjet nga data e lëshimit të vendimit për shkarkimin nga detyrimet e mbetura.

2. Debitori duhet të japë informacion për detyrimet e tij në gjykatën e falimentimit dhe, kur kërkohet nga kreditori për të provuar vërtetësinë e informacionit, bën një deklaratë noteriale. Në qoftë se debitori nuk arrin të japë informacion ose deklaratën noteriale brenda kohës së dhënë, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, ose kur debitori nuk paraqitet në gjykatën e falimentimit pasi është thirrur nga ajo për dhënien e informacionit ose paraqitjen e deklaratës noteriale, edhe pse debitori është njoftuar në mënyrë të rregullt dhe nuk ka asnjë justifikim të arsyeshëm, gjykata e falimentimit revokon shkarkimin nga detyrimet e mbetura.

3. Nëse evidentohet se debitori ka shkelur qëllimisht ndonjë nga detyrimet e tij dhe, si pasojë, ka dëmtuar në mënyrë të konsiderueshme kreditorët e falimentimit, gjykata e falimentimit revokon shkarkimin nga detyrimet e mbetura.

4. Pala kërkuese dhe debitori kanë të drejtë për ankim të veçantë kundër vendimit.

5. Vendimi i revokimit të shkarkimit nga detyrimet e mbetura publikohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Agjencinë Kombëtare të Falimentimit.

Neni 164

**Revokimi për shkarkimin nga detyrimet e mbetura për shkak të dënimit penal ose mashtrimeve të debitorit**

1. Gjykata e falimentimit mund të revokojë vendimin për shkarkimin nga detyrimet e mbetura me kërkesë të një kreditori falimentimi ose të kujdestarit, kur debitori, në periudhën midis fillimit të procedurës së falimentimit dhe përfundimit të procedurës së falimentimit ose gjatë veprimtarisë së kujdestarisë, është dënuar për një vepër penale sipas Kodit Penal.

2. Gjykata e falimentimit mund të revokojë shkarkimin nëse ndonjë nga palët pjesëmarrëse vërteton se ky shkarkim është marrë me anë të mashtrimit dhe paraqet një kërkesë brenda 1 viti nga data kur është vënë në dijeni për mashtrimin.

3. Kërkesa e kreditorit pranohet kur dorëzohet brenda 1 viti nga shpallja e vendimit përfundimtar për shkarkimin nga detyrimi i mbetur dhe është vërtetuar se kushtet e pikës 1, të këtij neni, ekzistojnë dhe kreditori nuk ishte në dijeni për to deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

4. Debitori dhe kujdestari kanë të drejtë të dëgjohen para marrjes së vendimit. Kundër vendimit kanë të drejtë për një ankim të veçantë pala kërkuese dhe debitori. Vendimi për refuzimin e shkarkimit nga detyrimet e mbetura bëhet publik.

5. Dispozitat e pikës 1, të nenit 163, të këtij ligji, zbatohen njëlloj.

Neni 165

**Revokimi për shkak të mospagimit të shpërblimit të kujdestarit**

1. Me kërkesë të kujdestarit, gjykata e falimentimit mund të revokojë shkarkimin nga detyrimet e mbetura, nëse shumat e marra nga kujdestari për vitin paraardhës nuk mbulojnë shpërblimin e tij dhe kujdestari ka kërkuar me shkrim pagesën ndaj debitorit brenda një periudhe jo më të shkurtër se 2 javë dhe e ka paralajmëruar atë për mundësinë e revokimit të shkarkimit të tij nga detyrimet e mbetura.

2. Para se të merret vendimi, gjykata e falimentimit i krijon mundësinë debitorit të dëgjohet. Gjykata e falimentimit nuk duhet të revokojë shkarkimin nga detyrimet e mbetura në qoftë se debitori, me kërkesë të saj, paguan shumën e papaguar brenda 2 javëve ose në qoftë se ka arsye të tjera bindëse për të mos revokuar shkarkimin në rrethanat e ndonjë rasti të veçantë.

Neni 166

**Ndërprerja para kohe**

Nëse vendimi për të shkarkuar nga detyrimet e mbetura revokohet, caktimi i kujdestarit, detyrat e tij dhe kufizimi i të drejtave të kreditorëve ndërpriten pas shpalljes së vendimit të gjykatës së falimentimit.

Neni 167

**Vendimi për përfundimin e procedurës së falimentimit**

1. Në qoftë se periudha e caktimit të kujdestarit ka mbaruar në afat dhe jo me përfundim të parakohshëm për shkak të revokimit, gjykata e falimentimit mund të urdhërojë që procedura e falimentimit të përfundojë, pas dëgjimit të parashtrimeve të kreditorëve të falimentimit, kujdestarit dhe debitorit.

2. Me kërkesë të një kreditori falimentimi ose me kërkesë të kujdestarit, gjykata e falimentimit refuzon përfundimin e procedurës së falimentimit kur ekzistojnë kushte jo të mjaftueshme për shkarkimin nga detyrimet e mbetura.

3. Vendimi shpallet publikisht. Debitori dhe çdo kreditor i falimentimit, që ka kërkuar refuzimin e përfundimit të procedurës së falimentimit, ka të drejtë ankimi.

Neni 168

**Efekti i përfundimit të procedurës së falimentimit**

1. Nëse miratohet përfundimi i procedurës së falimentimit, shkarkimi është i vlefshëm dhe detyrues për të gjithë kreditorët e falimentimit, duke përfshirë edhe ata kreditorë, të cilët nuk kanë paraqitur pretendime.

2. Të drejtat e kreditorëve të falimentimit kundrejt debitorëve të debitorit dhe garantuesve, si dhe të drejtat e tyre që rrjedhin nga një njoftim i regjistruar me përparësi ose si kreditorë të siguruar do të mbeten të pandryshuara. Debitori, megjithatë, do të shkarkohet në lidhje me çdo kreditor, bashkëdebitor, garantues ose ndonjë person tjetër që ka pretendime ndaj tij në të njëjtën mënyrë si është shkarkuar në lidhje me pretendimet e kreditorëve të falimentimit.

Neni 169

**Detyrimet që nuk mund të shkarkohen**

Dhënia e shkarkimit nga detyrimet e mbetura nuk zbatohet për:

a) huat që i janë dhënë debitorit për të paguar shpenzimet e procedurës së falimentimit;

b) detyrimet që kanë lindur si rezultat i mashtrimit, dëshmive të rreme ose të veprimeve të tjera në keqbesim ose veprimeve jokorrekte, të kryera me dashje nga debitori;

c) detyrimet në lidhje me mbështetjen financiare të fëmijëve;

ç) gjobat dhe sanksionet administrative;

d) huat e studentit;

dh) detyrimet që rrjedhin nga veprimet që kanë shkaktuar dëmtimin ose vdekjen e një personi tjetër;

e) detyrimet që mbeten të pashkarkueshme nga procedura e mëparshme e falimentimit;

ë) detyrimet në lidhje me pronat e transferuara te personat e lidhur me debitorin.

PJESA E TETË

PROCEDURA E FALIMENTIMIT NË LIDHJE ME SHTETET E HUAJA KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 170

**Qëllimi i procedurës ndërkombëtare të falimentimit**

Qëllimi i kësaj pjese të ligjit është sigurimi i mekanizmave efektivë në rastet e falimentimit ndërkombëtar për të promovuar objektivat në lidhje me:

a) bashkëpunimin ndërmjet gjykatave dhe autoriteteve të tjera të Shqipërisë me shtetet e tjera të përfshira në falimentim ndërkombëtar;

b) sigurinë më të lartë për tregti dhe investime;

c) administrimin e drejtë dhe efiçent të rasteve të falimentimit ndërkombëtar në mbrojtje të interesave të të gjithë kreditorëve e të personave të tjerë të interesuar, përfshirë edhe debitorin;

ç) mbrojtjen dhe maksimizimin e vlerës së pasurisë së debitorit dhe lehtësimin e shpëtimit të shoqërive me probleme financiare, duke mbrojtur kështu investimet, si dhe tregun e punës.

Neni 171

**Zbatimi i procedurës ndërkombëtare të falimentimit**

1. Rregullat e parashikuara në këtë pjesë zbatohen kur:

a) kërkohet ndihmë në Shqipëri nga një gjykatë e huaj ose nga një përfaqësues i huaj në lidhje me një procedurë të huaj falimentimi; ose

b) kërkohet ndihmë në një shtet të huaj, në lidhje me një procedurë në bazë të ligjit të falimentimit shqiptar; ose

c) janë duke u zhvilluar njëkohësisht një procedurë e huaj dhe një procedurë sipas ligjit të falimentimit shqiptar në lidhje me të njëjtin debitor; ose

ç) kreditorët ose persona të tjerë të interesuar në një shtet të huaj kanë interes për të kërkuar fillimin ose pjesëmarrjen në një procedurë sipas ligjit shqiptar të falimentimit.

2. Këto dispozita zbatohen për një procedurë në lidhje me debitorët që veprojnë në sektorët publikë ose strategjikë, siç referohet në nenin 7, të këtij ligji, përveçse kur me ligj përcaktohet ndryshe.

Neni 172

**Detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë sipas ligjit të falimentimit**

Për aq kohë sa kjo pjesë bie ndesh me një detyrim të Shqipërisë që rrjedh nga marrëveshjet e ratifikuara, në të cilat ajo është palë me një ose më shumë shtete të tjera, mbizotërojnë kërkesat e marrëveshjes.

Neni 173

**Juridiksioni i falimentimit ndërkombëtar**

Njohja e procedurave të huaja dhe bashkëpunimi me gjykatat e huaja dhe organet e tjera kompetente është në kompetencë të gjykatës shqiptare të falimentimit.

Neni 174

**Autorizimi i administratorit shqiptar të falimentimit për të vepruar jashtë Shqipërisë**

Administratori i falimentimit është i autorizuar për të vepruar jashtë shtetit të Shqipërisë, në emër të një procedure, sipas ligjit të falimentimit shqiptar, siç lejohet nga ligji i huaj i zbatueshëm.

Neni 175

**Refuzimi për papajtueshmëri me rendin publik**

Ky ligj nuk e ndalon gjykatën e falimentimit që të refuzojë kryerjen e një veprimi të rregulluar nga kjo pjesë, nëse nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.

Neni 176

**Ndihma për përfaqësuesin e huaj**

Kjo pjesë nuk kufizon pushtetin e gjykatës së falimentimit ose të administratorit të falimentimit ose atij mbikëqyrës shqiptar, sipas legjislacionit shqiptar, t'i ofrojnë ndihmë përfaqësuesit të huaj.

Neni 177

**Interpretimi**

Gjatë zbatimit të dispozitave mbi falimentimin ndërkombëtar, gjykata e falimentimit zbaton parimin e mirëbesimit në mënyrë të njëjtë në rastin kur ka nevojë për interpretimin e normave me karakter ndërkombëtar.

KREU II

AKSESI I PËRFAQËSUESVE DHE KREDITORËVE TË HUAJ
NË GJYKATËN E FALIMENTIMIT

Neni 178

**E drejta për akses të drejtpërdrejtë**

Një përfaqësues i huaj ka të drejtë të aplikojë drejtpërdrejt në gjykatën shqiptare të falimentimit.

Neni 179

**Juridiksioni i kufizuar**

Legjitimimi i përfaqësuesit për t'iu drejtuar gjykatës shqiptare të falimentimit nuk mund të interpretohet si zgjerim i juridiksionit të gjykatave shqiptare mbi përfaqësuesin e huaj ose pasuritë e huaja dhe biznesin e debitorit, për qëllime të tjera nga ai i aplikimit.

Neni 180

**E drejta e një përfaqësuesi të huaj për të filluar procedurën e falimentimit**

Një përfaqësues i huaj ka të drejtë të aplikojë për të filluar procedurën e falimentimit vetëm nëse përmbushen kushtet sipas kësaj pjese.

Neni 181

**Pjesëmarrja e një përfaqësuesi të huaj në procedurën shqiptare të falimentimit**

Me njohjen e një procedure të huaj, përfaqësuesi i huaj ka të drejtë të marrë pjesë në procedurën e falimentimit të kryer në Shqipëri, në lidhje me detyrimet ose pasuritë, në përputhje me këtë pjesë.

Neni 182

**Aksesi i kreditorëve të huaj në një procedurë sipas ligjit shqiptar të falimentimit**

1. Kreditorët e huaj kanë të njëjtat të drejta si kreditorët shqiptarë, në lidhje me fillimin dhe pjesëmarrjen në një procedurë falimentimi në Shqipëri, sipas kësaj pjese.

2. Përcaktimi i pikës 1, të këtij neni, nuk ndikon në renditjen e pretendimeve në një procedurë falimentimi, sipas kësaj pjese, përveçse pretendimet e kreditorëve të huaj nuk duhet të renditen më poshtë se ato të pretendimeve të pasiguruara vetëm për shkak se mbajtësi i një pretendimi të tillë është një kreditor i huaj.

Neni 183

**Njoftimi i kreditorëve të huaj për procedurën e falimentimit sipas ligjit shqiptar**

1. Sa herë që sipas ligjit shqiptar të falimentimit duhet bërë njoftimi ndaj kreditorëve në

Shqipëri, një njoftim i tillë duhet t'u bëhet edhe kreditorëve të njohur që nuk kanë adresat në Shqipëri. Gjykata e falimentimit mund të urdhërojë që të ndërmerren masat e duhura për njoftimin e kreditorëve, adresa e të cilëve nuk dihet ende.

2. Njoftimi i kreditorëve të huaj duhet të bëhet në mënyrë individuale, përveçse nëse gjykata e falimentimit konsideron se, sipas rastit, një formë tjetër e njoftimit është më e përshtatshme. Njoftimi ndaj kreditorëve të njohur të huaj mund të bëhet përmes shpalljes në gazeta të huaja, siç i gjykon më të përshtatshme administratori shqiptar i falimentimit, për të siguruar që përmbajtja e njoftimit vendos në dijeni kreditorët e njohur të huaj. Në këtë rast nuk kërkohet njoftim me dokument zyrtar.

3. Njoftimi i fillimit të procedurës së falimentimit që u jepet kreditorëve të huaj duhet:

a) të tregojë një periudhë të arsyeshme për paraqitjen e pretendimeve dhe të përcaktojë vendin për depozitimin e tyre;

b) të tregojë nëse kreditorët e siguruar duhet të paraqesin pretendimet e tyre të siguruara;

c) të përmbajë ndonjë informacion tjetër që kërkohet të përfshihet në një njoftim të tillë të kreditorëve në përputhje me ligjin shqiptar dhe urdhrat e gjykatës së falimentimit.

## KREU III

## NJOHJA E NJË PROCEDURE TË HUAJ FALIMENTIMI DHE NDIHMAT

### Neni 184

### **Aplikimi për njohjen e një procedure të huaj**

1. Një përfaqësues i huaj mund të aplikojë në gjykatën e falimentimit për njohjen e procedurës së huaj, në të cilën është emëruar përfaqësuesi i huaj.

2. Një aplikim për njohje shoqërohet nga:

a) një kopje vërtetimi për vendimin e fillimit të procedurës së huaj dhe emërimit të përfaqësuesit të huaj; ose

b) një vërtetim nga gjykata e huaj që konfirmon ekzistencën e procedurës së huaj dhe të emërimit të përfaqësuesit të huaj; ose

c) në mungesë të provave të përmendura në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, çdo provë tjetër e pranueshme në gjykatën e falimentimit për ekzistencën e procedurës së huaj dhe të emërimit të përfaqësuesit të huaj.

3. Një aplikim për njohje shoqërohet me një deklaratë që identifikon të gjitha procedurat e huaja dhe çdo procedurë, sipas ligjit të falimentimit shqiptar, në lidhje me detyrimin ose që përfaqësuesi i huaj është në dijeni.

4. Gjykata e falimentimit mund të kërkojë përkthimin në gjuhën shqipe të dokumenteve të ofruara në mbështetje të aplikimit për njohjen.

### Neni 185

### **Prezumime në lidhje me njohjen**

1. Nëse vendimi ose vërtetimi i përmendur në pikën 2, të nenit 192, të këtij ligji, tregon se procedura e huaj është një procedurë kryesore falimentimi dhe se përfaqësuesi i huaj është një person ose organ brenda kuptimit të pikës 24, të nenit 3, të këtij ligji, gjykata e falimentimit ka të drejtë t'i prezumojë faktet si të vërtetuara.

2. Dokumentet e dorëzuara bashkëlidhur kërkesës për njohje mund të konsiderohen autentike nga gjykata e falimentimit, pa marrë parasysh nëse janë legalizuar.

3. Në mungesë të provave që tregojnë të kundërtën, zyra e regjistruar e debitorit ose vendbanimi i zakonshëm, në rastin e një individi, prezumohet të jetë qendra kryesore e interesit e debitorit.

Neni 186

**Vendimi mbi njohjen e një procedure të huaj**

1. Sipas nenit 175, të këtij ligji, procedura e huaj njihet nëse:

a) procedura e huaj është një procedurë brenda kuptimit të kësaj pjese;

b) përfaqësuesi i huaj, që aplikon për njohje, është një person ose organ, sipas kuptimit të pikës 24, të nenit 3, të këtij ligji;

c) aplikimi i plotëson kërkesat e pikës 2, të nenit 184, të këtij ligji;

ç) kërkesa është dorëzuar në gjykatën e falimentimit, sipas nenit 173 të këtij ligji.

2. Procedura e huaj duhet të njihet:

a) si një procedurë e huaj kryesore, në qoftë se ajo është duke u zhvilluar në shtetin ku debitori ka qendrën e tij kryesore të interesit; ose

b) si një procedurë e huaj dytësore, në qoftë se debitori ka vendndodhjen, sipas kuptimit të pikës 29, të nenit 3, të këtij ligji, në shtetin e huaj.

3. Një aplikim për njohjen e një procedure të huaj vendoset në kohën më të hershme të mundshme dhe, në çdo rast, para 15 ditëve nga momenti i kërkesës.

4. Parashikimet e neneve 184, 185, 186 dhe 187, të këtij ligji, nuk parandalojnë ndryshimin ose ndërprerjen e njohjes nëse provohet që kushtet e njohjes nuk janë të plota ose kanë pushuar së ekzistuari.

Neni 187

**Informacioni i mëvonshëm**

Nga momenti i dorëzimit të aplikimit për njohjen e procedurës së huaj, përfaqësuesi i huaj njofton gjykatën e falimentimit menjëherë për:

a) çdo ndryshim thelbësor në statusin e procedurës së huaj të njohur ose në statusin e emërimit të përfaqësuesit të huaj;

b) çdo procedurë tjetër të huaj ose procedurë në lidhje me të njëjtin detyrim ose që bëhet e njohur për përfaqësuesit e huaj.

Neni 188

**Ndihma që mund të ofrohet gjatë aplikimit për njohjen e një procedure të huaj**

1. Nga koha e dorëzimit të aplikimit për njohjen derisa të merret vendimi, me kërkesën e përfaqësuesit të huaj, kur nevojitet ndihmë urgjente për të mbrojtur pasurinë e debitorit ose interesat e kreditorëve, gjykata e falimentimit mund të garantojë një ndihmë të përkohshme, duke përfshirë:

a) ndalimin e ekzekutimit të pasurive të debitorit;

b) vendosjen e administrimit ose realizimin e të gjitha ose të një pjese të pasurisë së debitorit që ndodhet në Shqipëri një përfaqësuesi të huaj ose ndonjë administratori të përkohshëm të falimentimit, për të mbrojtur dhe ruajtur vlerën e pasurive për nga natyra e tyre ose për shkak të rrethanave të tjera;

c) çdo ndihmë e përmendur në shkronjat “b” dhe “d”, të pikës 1, të nenit 190, të këtij ligji.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në nenin 190, të këtij ligji, ndihma e dhënë, sipas këtij neni, mbaron kur vendoset aplikimi për njohjen e procedurës.

3. Gjykata e falimentimit mund të refuzojë të japë ndihmë, sipas këtij neni, nëse kjo ndihmë do të ndërhynte me administrimin procedurës kryesore të huaj.

Neni 189

**Efektet e njohjes së një procedure kryesore të huaj**

1. Pas njohjes së një procedure të huaj, që është një procedurë kryesore e huaj:

a) pezullohet fillimi ose vazhdimi i veprimeve individuale apo i procedurave individuale lidhur me pasurinë, të drejtat, borxhet ose detyrimet e debitorit;

b) pezullohet ekzekutimi kundër pasurisë së debitorit;

c) pezullohet e drejta për të transferuar, penguar ose disponuar ndonjë prej pasurive të debitorit jashtë aktivitetit të zakonshëm të biznesit.

2. Objekti, ndryshimi ose ndërprerja e ndalimit dhe pezullimit, të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, janë objekt i vendimit të gjykatës së falimentimit, siç parashikohet në këtë ligj ose kur procedura e huaj kryesore nuk garanton siç duhet interesat e subjekteve shqiptare.

3. Përcaktimi i shkronjës "a", të pikës 1, të këtij neni, nuk ndikon të drejtën për fillimin e veprimeve individuale ose procedurave në masën e nevojshme për të ruajtur një pretendim kundër debitorit.

4. Përcaktimi i pikës 1, të këtij neni, nuk ndikon të drejtën për të kërkuar fillimin e procedurës ose të drejtën për të paraqitur pretendim në këtë procedurë.

Neni 190

**Ndihma që mund të garantohet pas njohjes së një procedure të huaj**

1. Pas njohjes së një procedure të huaj, qoftë kryesore ose dytësore, kur është e nevojshme për të mbrojtur pasurinë e debitorit ose interesat e kreditorëve, gjykata e falimentimit, me kërkesë të përfaqësuesit të huaj, mund të japë çdo ndihmë të përshtatshme, duke përfshirë:

a) ndalimin e fillimit ose vazhdimit të veprimeve individuale ose procedurave të individuale lidhur me pasurinë, të drejtat, borxhet ose detyrimet e debitorit, nëse këto nuk janë pezulluar sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 189, të këtij ligji;

b) ndalimin e ekzekutimit ndaj pasurive të debitorit, nëse nuk janë pezulluar sipas shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 189, të këtij ligji;

c) pezullimin e së drejtës për të transferuar, penguar ose disponuar ndonjë pasuri të debitorit, nëse kjo e drejtë nuk është pezulluar sipas shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 189, të këtij ligji;

ç) sigurimin e dëgjimit të dëshmitarëve, marrjen e provave ose dërgimin e informacionit në lidhje me pasuritë, punët, të drejtat, borxhet ose detyrimet e debitorit;

d) vendosjen e administrimit ose realizimin e të gjitha ose të një pjese të pasurisë së debitorit që ndodhet në këtë shtet përfaqësuesit të huaj ose një personi tjetër të caktuar nga gjykata e falimentimit;

dh) zgjatjen e ndihmës së dhënë, në bazë të pikës 1, të nenit 188, të këtij ligji;

e) dhënien e ndonjë ndihme shtesë që mund të jetë në dispozicion të një administratori shqiptar të falimentimit dhe vendosjen e ndalimeve të tjera, sipas këtij ligji.

2. Me njohjen e një procedure të huaj, qoftë kryesore ose dytësore, gjykata e falimentimit, me kërkesën e përfaqësuesit të huaj, mund t'ia besojë shpërndarjen e të gjithë ose të një pjese të pasurive të debitorit që ndodhen në Shqipëri përfaqësuesit të huaj ose një personi tjetër të caktuar nga gjykata e falimentimit, me kusht që gjykata e falimentimit të përcaktojë se interesat e kreditorëve shqiptarë janë të mbrojtur në mënyrë të përshtatshme.

3. Në dhënien e ndihmës, sipas këtij neni, për një përfaqësues të një procedure të huaj dytësore, gjykata e falimentimit duhet të përcaktojë se ndihma lidhet me pasurinë që, sipas këtij ligji, duhet të administrohet në procedurën e huaj dytësore ose që lidhet me informacionin e kërkuar në këtë procedurë.

**Neni 191**
**Mbrojtja e kreditorëve dhe personave të tjerë të interesuar**

1. Në dhënien ose refuzimin e ndihmës, sipas nenit 188 ose nenit 190, të këtij ligji, ose në ndryshimin ose ndërprerjen e ndihmës, sipas pikës 3, të këtij neni, gjykata e falimentimit përcakton se interesat e kreditorëve e të personave të tjerë të interesuar, përfshirë edhe debitorin, janë të mbrojtur në mënyrë të përshtatshme.

2. Gjykata e falimentimit mund të kushtëzojë ndihmën e dhënë, në bazë të neneve 188 dhe 190, të këtij ligji, në kushtet që e konsideron të përshtatshme.

3. Gjykata e falimentimit, me kërkesën e përfaqësuesit të huaj ose të një personi të prekur nga ndihma e dhënë, në bazë të neneve 188 dhe 190, të këtij ligji, sipas detyrës së saj, mund të ndryshojë ose të ndërpresë këtë ndihmë.

Neni 192

**Veprimet për të shmangur dëmtimin e kreditorëve**

1. Pas njohjes së procedurës së huaj, përfaqësuesi i huaj mund të marrë masa për të shmangur ose anuluar aktet që dëmtojnë kreditorët.

2. Kur procedura e huaj është një procedurë dytësore, gjykata e falimentimit përcakton se veprimi lidhet me pasuritë që, sipas ligjit shqiptar, administrohet në kuadër të procedurës së huaj dytësore.

Neni 193

**Ndërhyrja e një përfaqësuesi të huaj në procedurën e falimentimit në Shqipëri**

Pas njohjes së procedurës së huaj, sipas ligjit shqiptar, përfaqësuesi i huaj mund të ndërhyjë në çdo procedurë në të cilën debitori është palë.

KREU IV

BASHKËPUNIMI ME GJYKATAT E HUAJA DHE PËRFAQËSUESIT E HUAJ

Neni 194

**Bashkëpunimi dhe komunikimi i drejtpërdrejtë midis gjykatës së falimentimit dhe gjykatave të huaja ose përfaqësuesve të huaj**

1. Në çështjet e parashikuara në nenin 170, të këtij ligji, gjykata e falimentimit bashkëpunon sa më ngushtë me gjykatat e huaja ose përfaqësuesit e huaj, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një administratori të falimentimit.

2. Gjykata e falimentimit ka të drejtë të komunikojë ose të kërkojë informacion apo ndihmë të drejtpërdrejtë nga gjykatat e huaja ose përfaqësuesit e huaj.

Neni 195

**Bashkëpunimi dhe komunikimi i drejtpërdrejtë midis administratorit të falimentimit ose atij mbikëqyrës dhe gjykatave të huaja ose përfaqësuesve të huaj**

1. Në çështjet e parashikuara në nenin 170, të këtij ligji, administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës, në ushtrimin e funksioneve të tij dhe nën mbikëqyrjen e gjykatës së falimentimit, bashkëpunon në masën maksimale të mundshme me gjykatat e huaja ose përfaqësuesit e huaj.

2. Administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës, në ushtrimin e funksioneve të tij dhe nën mbikëqyrjen e gjykatës së falimentimit, ka të drejtë të komunikojë drejtpërdrejt me gjykatat e huaja ose përfaqësuesit e huaj.

Neni 196

**Format e bashkëpunimit**

Bashkëpunimi i përmendur në nenet 194 dhe 195, të këtij ligji, mund të zbatohet në çdo mënyrë të përshtatshme, duke përfshirë:

a) emërimin e një personi ose organi për të vepruar sipas drejtimit të gjykatës së falimentimit;

b) komunikimin e informacionit me çdo mënyrë, kur shihet e arsyeshme nga gjykata e falimentimit;

c) koordinimin e administrimit dhe mbikëqyrjen e pasurive të debitorit e të punëve të tij;

ç) miratimin ose zbatimin nga ana e gjykatave të marrëveshjeve në lidhje me koordinimin e procedurave;

d) koordinimin e procedurave të njëkohshme të lidhura me të njëjtin debitor.

KREU V PROCEDURAT E NJËKOHSHME

Neni 197

**Fillimi i procedurës së falimentimit pas njohjes së një procedure të huaj kryesore**

1. Pas njohjes së një procedure të huaj kryesore, një procedurë, sipas ligjit të falimentimit shqiptar, mund të fillohet vetëm nëse debitori ka pasuri në Shqipëri.

2. Efektet e kësaj procedure kufizohen te pasuritë e debitorit që ndodhen në Shqipëri dhe në masën e nevojshme për të bashkëpunuar dhe koordinuar, në bazë të neneve 194, 195 dhe 196, të këtij ligji, te pasuritë e tjera të debitorit që duhet të administrohen në procedurën e falimentimit.

Neni 198

**Koordinimi i procedurës së falimentimit dhe një procedure të huaj**

Kur procedura e huaj dhe procedura e falimentimit janë duke u zhvilluar njëkohësisht në lidhje me të njëjtin debitor, gjykata e falimentimit kërkon bashkëpunimin dhe koordinimin, në bazë të neneve 194, 195 dhe 196, të këtij ligji, dhe sipas parashikimeve në vijim:

a) Kur procedura e falimentimit ndodh në kohën kur është paraqitur aplikimi për njohjen e procedurës së huaj:

i) çdo ndihmë e dhënë, në bazë të neneve 188 dhe 190, të këtij ligji, duhet të jetë në përputhje me procedurën e falimentimit në Shqipëri;

ii) nëse procedura e huaj njihet në Shqipëri si një procedurë kryesore e huaj e falimentimit, neni 189, të këtij ligji, nuk zbatohet.

b) Kur procedura falimentimit në Shqipëri fillon pas njohjes ose pas dorëzimit të kërkesës për njohjen e procedurës së huaj:

i) çdo ndihmë në fuqi, sipas neneve 188 dhe 190, të këtij ligji, shqyrtohet nga gjykata e falimentimit dhe ndryshohet ose ndërpritet nëse është në kundërshtim me procedurën e falimentimit në Shqipëri;

ii) nëse procedura e huaj është një procedurë e huaj kryesore, ndalimi dhe pezullimi i përmendur në pikën 1, të nenit 189, të këtij ligji, do të ndryshohet ose do të ndërpritet, në përputhje me pikën 2, të nenit 189, të këtij ligji, nëse është në kundërshtim me procedurën e falimentimit në Shqipëri.

c) Në dhënien, zgjerimin ose ndryshimin e ndihmës së dhënë një përfaqësuesi të një procedure dytësore të huaj, gjykata e falimentimit përcakton se kjo ndihmë lidhet me pasuritë që, sipas ligjit shqiptar, duhet të administrohen në procedurën e huaj dytësore, ose që lidhet me informacionin e kërkuar në atë procedurë.

Neni 199

**Koordinimi i disa procedurave të huaja**

Në çështjet e përmendura në nenin 170, të këtij ligji, kur ndaj të njëjtit debitor ka më shumë se një procedurë të huaj, gjykata do të kërkojë bashkëpunimin dhe koordinimin në bazë të neneve 194, 195 dhe 196, të këtij ligji, dhe zbatohen, si më poshtë:

a) çdo ndihmë që i jepet, sipas neneve 188 dhe 190, të këtij ligji, një përfaqësuesi të huaj pas njohjes së një procedure të huaj kryesore, duhet të jetë në përputhje me procedurën e huaj kryesore;

b) nëse vendimi për njohjen e procedurës kryesore të huaj është marrë pas njohjes së procedurës dytësore të huaj ose pas paraqitjes së kërkesës për njohjen e procedurës dytësore të huaj, gjykata e falimentimit rishqyrton çdo ndihmë që është ofruar, sipas neneve 188 ose 190, të këtij ligji, dhe ndryshon ose shfuqizon të gjitha masat që janë në kundërshtim me procedurën e huaj kryesore;

c) në qoftë se, pas njohjes së një procedure të huaj dytësore, njihet një tjetër procedurë e huaj dytësore, gjykata e falimentimit do të japë, do të ndryshojë ose do të ndërpresë ndihmën, me qëllim lehtësimin e koordinimit të procedurave.

Neni 200

**Prezumimi i paaftësisë paguese bazuar në njohjen e një procedure të huaj kryesore**

Nëse nuk provohet e kundërta për qëllimin e fillimit të procedurës së falimentimit, njohja e procedurave të huaja është provë e paaftësisë paguese të debitorit.

Neni 201

**Shlyerja e pagesës në procedurat e njëkohshme**

Kreditorit, të cilit i është shlyer pjesërisht pretendimi i tij në një procedurë të zbatuar, në përputhje me një ligj që rregullon falimentimin në një shtet të huaj, nuk mund të shlyhet për të njëjtin pretendim në një procedurë falimentimi në Republikën e Shqipërisë, lidhur me të njëjtin debitor, për aq kohë sa shumat e shlyerjes ndaj kreditorëve të tjerë të së njëjtës klasë janë proporcionalisht më të ulëta se shumat që kreditori tashmë ka marrë, pa ndikuar në këtë mënyrë në pretendimet e kreditorëve të siguruar.

PJESA NËNTË

AGJENCIA KOMBËTARE E FALIMENTIMIT

Neni 202

**Statusi i Agjencisë Kombëtare të Falimentimit**

1. Agjencia Kombëtare e Falimentimit (më poshtë “Agjencia”) është një person juridik, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e së cilës përcaktohen me akt nënligjor.
2. Agjencia e ka selinë në Tiranë.
3. Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 203

**Detyrat e Agjencisë**

Agjencia ka të drejtat dhe kompetencat e mëposhtme:

a) të japë, të anulojë ose të rinovojë licencat për administratorët e falimentimit dhe atij mbikëqyrës, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

b) të hartojë dhe të administrojë provimet për administratorët e falimentimit dhe atë mbikëqyrës;

c) të mbajë regjistrin e administratorëve të certifikuar të falimentimit;

ç) të kontrollojë dhe të mbikëqyrë standardet e sjelljes profesionale të administratorëve të falimentimit dhe atij mbikëqyrës gjatë procedurës së falimentimit;

d) të mbledhë dhe të përpunojë të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera në lidhje me procedurat e falimentimit;

dh) të propozojë standardet e sjelljes dhe të kompetencave në administrimin e falimentimeve, si edhe Kodin e Etikës, e të kërkojë zbatimin e tyre nëpërmjet ndërmarrjes të sanksioneve dhe masave disiplinore, si dhe të kërkojë nga administratorët e falimentimit dhe ai mbikëqyrës një raport çdo 3 muaj për zbatimin e detyrave të tyre;

e) të zbatojë çdo detyrë tjetër të caktuar nga ky ligj.

Neni 204

**Veprimtaria mbikëqyrëse e Agjencisë**

1. Agjencia, gjatë ushtrimit të veprimtarisë mbikëqyrëse, kontrollon punën e administratorëve të falimentimit dhe atij mbikëqyrës për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre, sipas këtij ligji, sipas standardeve kombëtare të administrimit të masës së falimentimit dhe Kodit të Etikës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Agjencia kryen veprimtari mbikëqyrëse, siç është përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, nëpërmjet vlerësimit të raporteve të shkruara dhe të paraqitura nga administratorët e falimentimit dhe ai mbikëqyrës dhe gjykata e falimentimit, si dhe në bazë të dokumenteve të tjera, të mbajtura në kuadër të veprimtarive të administratorëve të falimentimit dhe atij mbikëqyrës gjatë procedurave të falimentimit.

**Neni 205**
**Bashkëpunimi**

Gjatë ushtrimit të detyrave të saj, Agjencia mund të kontraktojë dhe të bashkëpunojë me persona juridikë ose fizikë, shqiptarë ose të huaj.

**Neni 206**
**Burimet e financimit të Agjencisë**

Agjencia financohet nga:

a) Buxheti i Shtetit, si pjesë e buxhetit të ministrisë përgjegjëse për Agjencinë;

b) të ardhurat nga tarifat, sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të nenit 203, të këtij ligji;

c) të ardhurat nga donacionet dhe burime të tjera të ligjshme.

PJESA E DHJETË KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

**Neni 207**
**Kundërvajtjet administrative**

1. Depozitimi i deklaratave me të dhëna të rreme nga debitori, anëtarët e organeve drejtuese, aksionarët dhe ortakët ose çdo individ tjetër që vepron në emër të debitorit konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet me gjobë nga gjykata e falimentimit, në masën nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë. Lidhur me administratorët e debitorit, në vend të dënimit të mësipërm, në çdo kohë që gjykata e falimentimit gjykon rastin e një shkeljeje shumë të rëndë në detyrat e tyre në rastet e parashikuara në këtë ligj, ajo mund të vendosë një masë administrative parandaluese për të parandaluar këta administratorë që të drejtojnë drejtpërdrejt ose indirekt aktivitete ose veprimtari profesionale të tjera deri në një maksimum prej 5 vitesh.

2. Depozitimi i deklaratave me të dhëna të rreme nga një debitor individ konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet nga gjykata e falimentimit me gjobë në masën nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

3. Fshehja, transferimi ose tjetërsimi i pasurive ose dokumenteve ndaj administratorit të falimentimit ose atij mbikëqyrës, kujdestarit ose gjykatës së falimentimit, me qëllimin e pengimit të procedurës së falimentimit, konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet nga gjykata e falimentimit me gjobë, në masën nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë.

4. Mospërmbushja e detyrimeve, sipas neneve 21, 65 dhe 66, të këtij ligji, konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga gjykata e falimentimit, duke nisur nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë, ose me përjashtimin e mundësisë për të ushtruar veprimtari tregtare nga 1-5 vjet.

5. Identifikimi, shqyrtimi dhe ankimi i kundërvajtjeve administrative, të përcaktuara në këtë nen, rregullohen nga ligji për kundërvajtjet administrative.

6. Vendimi i gjykatës së falimentimit mund të ankimohet në gjykatën e apelit.

**Neni 208**
**Kundërvajtjet administrative të administratorit**

1. Pa u kufizuar në mjete të tjera juridike, të cilat mund të zbatohen, moszbatimi i vendimeve ose urdhrave të gjykatës së falimentimit nga ana e administratorit të falimentimit ose atij mbikëqyrës, si dhe mosrespektimi i afateve, sipas këtij ligji, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga gjykata e falimentimit duke nisur nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë.

2. Refuzimi i administratorit të falimentimit për të dorëzuar pasuritë dhe dokumentacionin e procedurës, në qoftë se shkarkohet nga detyra, konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga gjykata e falimentimit duke nisur nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë.

3. Identifikimi, shqyrtimi dhe ankimi i kundërvajtjeve administrative, të përcaktuara në këtë nen, rregullohen nga ligji për kundërvajtjet administrative.

4. Vendimi i gjykatës së falimentimit mund të ankimohet në gjykatën e apelit.

PJESA E NJËMBËDHJETË DISPOZITA KALIMTARE

## Neni 209
## Dispozita kalimtare

1. Ligji nr.,8901, datë 23.5.2002, "Për falimentimin", shfuqizohet.

2. Neni 104, i ligjit nr.,9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, shfuqizohet.

3. Të gjitha aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, "Për falimentimin", mbeten në fuqi dhe do të zbatohen për sa kohë nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

4. Këshilli i Ministrave miraton, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet nënligjore për zbatimin e tij.

**Neni 210**
**Procedurat në vazhdim**

Ky ligj nuk ka fuqi prapavepruese dhe rregullon vetëm procedurat e nisura pas hyrjes së tij në fuqi.

**Neni 211**
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I
**Ilir META**

Miratuar në datën 27.10.2016

Botuar ne F.Zyrtare 226 / 2016
Dale nga shtypi me 22.11.2016